

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT



Lirika Bërdynaj Syla

**FAKTORËT QË NDIKOJNË NË EFEKTIVITETIN
E DETYRAVE TË SHTËPISË NË ARSIMIN
FILLOR**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2022

UNIVERSITY OF PRISHTINA
FACULTY OF EDUCATION



Lirika Bërdynaj Syla

**FACTORS THAT INFLUENCE THE
EFFECTIVENESS OF HOMEWORK IN THE
PRIMARY SCHOOL**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKIMIT



Lirika Bërdynaj Syla

PUNIMI I DOKTORATËS

**FAKTORËT QË NDIKOJNË NË EFEKTIVITETIN
E DETYRAVE TË SHTËPISË NË ARSIMIN
FILLOR**

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Blerim Saqipi

Prishtinë, 2022

Këtë punim ia dedikoj mësuesve të jetës e të shkrimit, prindërve të mi, naltmadhërisë së saj, Nënës, e cila i takon përjetësisë dhe babait tim, Qerimit. Me Nënëen na ndau vdekja, por që na bashkoi vepra, misioni e profesioni!

*Me shpirt,
bija juaj!*

DEKLARATË

Me përgjegjësi të plotë, deklaroj se ky punim është shkruar në mënyrë të pavarur dhe është tërësisht punim origjinal. Punimi respekton të gjitha kërkesat për të drejtat e autorit, duke saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burimet e tjera. Gjithashtu deklaroj, se pjesë të veçanta nga ky punim janë shfrytëzuar dhe përdorur për artikuj e konferenca shkencore, si pjesë e obligimeve të studimeve të doktoratës.

Lirika Bërdynaj Syla

© Copyright, Lirika Bërdynaj Syla

Të gjitha të drejtat të rezervuara

2022

FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Gjatë këtij udhëtimi sprovues, por edhe të këndshëm jam përballë me shumë obligime shkollore dhe joshkollore, por sistematikisht jam marrë me temën e doktoratës, e cila ka dashur mund dhe përkushtim.

Duke qenë se punimi i një disertacioni, nuk është vetëm punë e kërkim sistematik, por edhe ngritje profesionale, përherë kam pasur mbështetje të fuqishme nga mentori im Prof. Asoc. Dr. Blerim Saqipi, i cili me këshillat, sugjerimet, komentet ka bërë që unë të ndjehem e sigurt në tezat që shtroja, njëkohësisht dhe e motivuar nga rezultatet e secilës pjesë të doktoratës. Prandaj, fjalët janë të pakta për përkushtimin e tij gjatë këtij procesi, kështu që përherë do të jem falënderuese dhe mirënjohëse për çdo detaj të diskutuar dhe sugjeruar.

Ky punim, nuk do të ishte kështu, i finalizuar, me sens shkencor dhe pse jo edhe me diskurs të zgjedhur eseistik e kërkues, pa përkrahjen, diskutimet dhe vlerësimet e anëtarëve të komisionit, Prof. Asoc. Dr. Hatixhe Ismaili, Prof. Dr. Bardhyl Musai dhe Prof. Asoc. Dr. Vlora Sylaj për të cilët jam mirënjohës pa fund. Doktorata do mund e përkushtim e ky rrugëtim do të ishte vërtetë më i vështirë pa intuitën, besimin, dashamirësinë e mikes dhe koleges së studimeve Elmedina Nikoçeviq Kurti, për gatishmërinë e bashkëpunimit dhe ndihmën e madhe profesionale kur unë kisha nevojë.

Po ashtu, ky punim nuk do të ishte i tillë as sipas strukturës, por edhe i varfër edhe për nga metoda e hulumtimit, pa anën empirike të kërkimit, pjesë e të cilit ishin mësimdhënësit, nxënësit, prindërit në të katër komunat e Kosovës që morëm pjesë në hulumtim (Prishtinë, Istog, Pejë, Lipjan).

Në fund si në fillim të studimeve të mia shkollore, unë nuk do të isha këtu si autore e këtyre radhëve pa mbështetjen e fortë dhe të pazëvendësueshme të familjes sime, babait, vëllait dhe motrave të mia për mbështetje morale dhe materiale. Ata janë gjysma e punës dhe e jetës sime për të cilët fjalët e zgjedhura kurrë nuk do të reshtin së shkruari.

Ky proces sigurisht se nuk do të ishte i mundur pa përkrahjen e pakusht, dashurinë dhe mirësinë e bashkëshortin tim, Liridonit, po ashtu edhe vjehrrës sime, e cila gjithnjë ishte e gatshme që të kujdesej ndaj fëmijëve të mi.

Mbi të gjitha, i gjithë ky kurorëzim i punës është një dedikim për dy kryeveprat e mia, Annën dhe Enion, që përgjatë këtij kërkimi, jo pak iu ka munguar përkushtimi amnor, por besoj se me rritën e tyre do të kenë një përgjigje brenda këtyre rreshtave. Ata janë motivi kryesor që unë, nëna e tyre, të arrija deri këtu, në mënyrë që të bashkudhëtojmë me tutje.

Lavdi atij që duron dhe mbështetë në punë të mira dhe të vështira, thotë një fjalë e urtë e stoikëve të vjetër.

Lirika Bërdynaj Syla

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATË	v
FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE	vi
LISTA E TABELAVE	xi
LISTA E FIGURAVE.....	xiii
LISTA E SHKURTIMEVE.....	xiv
Abstrakti	xv
Abstract	xvi
KAPITULLI I: HYRJE	17
1.1. Hyrje	17
1.2. Korniza teorike e studimit.....	18
1.2.1. Teoria e Konstruktivizmit	18
1.2.2. Teoria e Aktivitetit të Sistemeve	23
1.3. Arsytimi i hulumtimit	25
1.4. Konteksti i hulumtimit	26
1.5. Qëllimi dhe pyetjet e hulumtimit.....	32
1.6. Struktura e kapitujve.....	33
KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS	34
2.1. Historiku i detyrave të shtëpisë	34
2.2. Diskutime për detyra të shtëpisë dhe kundër detyrave të shtëpisë	35
2.3. Qëllimi i detyrave të shtëpisë	39
2.4. Efektiviteti i detyrave të shtëpisë	42
2.5. Dhënia e udhëzimeve.....	44
2.6. Informata kthyesë për detyrat e shtëpisë.....	46
2.7. Koha që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë.....	48
2.8. Mbingarkesa e nxënësve në detyra të shtëpisë.....	50
2.9. Llojet e detyrave të shtëpisë	51
2.10. Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë	52
2.11. Përmbledhje.....	56
KAPITULLI III METODOLOGJIA E STUDIMIT	57
3.1. Dizajni i hulumtimit.....	58
3.2. Pjesëmarrësit dhe mostra	58

3.2.1. Pjesëmarrësit	59
3.3. Procesi i pilotimit	62
3.4. Mbledhja e të dhënave	63
3.5. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave	64
3.6. Besueshmëria e instrumenteve të studimit	65
3.7. Procedurat e analizës së të dhënave	66
3.7.1. Analiza kuantitative	66
3.7.2. Analiza kualitative	67
3.8. Aspekti etik	68
KAPITULLI 4	69
4. REZULTATET E HULUMTIMIT	69
4.1. Paraqitja demografike e karakteristikave të mostrës	69
4.2. Perceptimet e mësimeve për qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë	72
4.3. Rezultatet lidhur me efektivitetin e detyrave të shtëpisë dhe qëllimin e tyre	74
4.4. Perceptimet e mësimeve rreth sfidave për implementimin e detyrave të shtëpisë	74
4.5. Perceptimet e mësimeve rreth përdorimit të informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë ...	76
4.6. Perceptimet e mësimeve rreth kohës që kalojnë nxënësit në detyra të shtëpisë	79
4.7. Rezultatet e Testit të Normalitetit për variablat e studimit	80
4.8. Analiza kualitative	88
4.9. Gjetjet nga intervistat me mësues	88
4.9.1. Mungesë e një standardi në shkolla për planifikimin e detyrave të shtëpisë	92
4.9.2. Mungesë e zhvillimit profesional për detyra të shtëpisë	93
4.9.3. Ngarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë	95
4.9.4. Krijimi i shprehjes së punës dhe zhvillimi i njohurive	96
4.9.5. Informata kthyesë si ndihmë për të përforcuar njohuritë	97
4.9.6. Llojet e detyrave të shtëpisë	98
4.9.7. Nevoja e përshtatjes së detyrave të shtëpisë sipas nivelit të nxënësve	99
4.9.8. Pikëpamje kundërthënëse të mësimeve për bashkëpunimin me prindër	100
4.10. Përmbledhje nga intervistat me mësime	101
4.11. Gjetjet nga intervistat me prindër	102
4.11.1. Pro detyrave të shtëpisë	103
4.11.2. Ngarkesa me detyra të shtëpisë	104
4.11.3. Nevoja e bashkëpunimit mësues – prind – nxënës	104
4.11.4. Mungesë e informatës kthyesë me shkrim	105

4.12. Përmbledhje nga intervistat me prindër	105
4.13. Gjetjet nga intervista me nxënës	106
4.13.1. Detyrat e shtëpisë si nevojë për nxënësit	107
4.13.2. Informata kthye si nxitje për përfundim të njohurive	107
4.13.3. Mungesë e informatës kthye me shkrim	107
4.14. Përmbledhje nga intervistat me nxënës	108
KAPITULLI 5	109
DISKUTIME DHE PËRFUNDIME.....	109
5.1. Përfundime	119
KAPITULLI 6	123
KUFIZIMET E STUDIMIT DHE MUNDËSITË E SË ARDHMES	123
6.1. Kufizimet e studimit	123
6.2. Mundësitë e së ardhmes	123
REFERENCAT	124
SHTOJCA	133

SHTOJCA

SHTOJCA A - Fletëpëlqimi për lejimin e hulumtimit në Komunën e Prishtinës

SHTOJCA B - Fletëpëlqimi për lejimin e hulumtimit në Komunën e Pejës

SHTOJCA C - Fletëpëlqimi për lejimin e hulumtimit në Komunën e Istogut

SHTOJCA Ç – Fletëpëlqim prindëror

Shtojca D – Fletëpëlqim i të intervistuarit për incizimin e zërit

SHTOJCA DH - Pyetësori për mësimdhënës

SHTOJCA E – Intervista me mësimdhënës

SHTOJCA F – Intervista për prindër

SHTOJA G – Intervista për nxënës

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Efektet e detyrave të shtëpisë (Cooper 2001, 2006).....	36
Tabela 2. Karakteristikat e detyrave efektive (AFT)	43
Tabela 3. Udhëzime për ngarkesën e detyrave të shtëpisë sipas nivelit të klasës – “ Rregulla 10 minutash	49
Tabela 4. Numri i të anketuarve (mësimdhënësve) sipas gjinisë dhe përvojës së punës.	59
Tabela 5. Të dhënat e mësimdhënësve pjesëmarrës në intervista	60
Tabela 6. Të dhënat e nxënësve pjesëmarrës në intervista.....	61
Tabela 7. Të dhënat e prindërve pjesëmarrës në intervista	62
Tabela 8. Cronbach Alfa Reliability Test	65
Tabela 9. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas gjinisë.....	69
Tabela 10. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas përvojës së punës	69
Tabela 11. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas zhvillimit profesional që i ka ndihmuar në detyrat e shtëpisë	70
Tabela 12. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas shkollës që pret mësuesit të caktojnë detyra të shtëpisë.....	70
Tabela 13. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas përgatitjes së tyre me detyrat e shtëpisë.....	71
Tabela 14. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas përgatitjes së fakultetit për detyrat e shtëpisë.....	71
Tabela 15. Shpërndarja e opinionëve të mësimdhënësve për qasjen e tyre lidhur me qëllimin e detyrave të shtëpisë	73
Tabela 16. Perceptimet e mësimdhënësve rreth sfidave për implementimin e detyrave të shtëpisë ...	75
Tabela 17. Perceptimet e mësimdhënësve rreth dhënies së informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë	76
Tabela 18. Perceptimet e mësimdhënësve rreth çështjes ku fokusohen më së shumti gjatë përdorimit të informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë	77
Tabela 19. Perceptimet e mësimdhënësve rreth mënyrës së përdorimit të informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë.....	77
Tabela 20. Perceptimet e mësimdhënësve për lëndët që japin më shumë detyra të shtëpisë	78
Tabela 21. Perceptimet e mësimdhënësve për llojet e detyrave që përfshihen në detyrat e shtëpisë ..	78
Tabela 22. Perceptimet e mësimdhënësve për caktimin e detyrave të shtëpisë gjatë një jave shkollore	79
Tabela 23. Perceptimet e mësimdhënësve për kohën që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë	79
Tabela 24. Rezultatet e Testit të Normalitetit për variablat e studimit	80
Tabela 25. Rezultatet e testit KMO dhe Barlett për pyetësin e sfidave	81
Tabela 26. Analiza faktoriale e shkallës për pyetësin lidhur me sfidat e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë	81
Tabela 27. Rezultatet e testit KMO dhe Barlett për pyetësin e qasjes së mësimdhënësve	83
Tabela 28. Analiza faktoriale e shkallës për pyetësin lidhur me qasjen e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë	84
Tabela 29. Dallimet e mesatareve lidhur me opinionet dhe sfidat gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë në raport me përvojën e mësimdhënësve	86
Tabela 30. Rezultatet e testit Kruskal Wallis: Dallimet në përvojën e mësimdhënësve dhe opinionin e sfidat e mësimdhënësve për detyrat e shtëpisë	87

Tabela 31. Dallimi i mesatareve lidhur me opinionin dhe sfidat e mësimeve për detyrat e shtëpisë në raport me zhvillimin profesional të tyre.....	87
Tabela 32. Rezultatet e testit Mann – Whitney U: Dallimet lidhur me zhvillimin profesional të mësimeve dhe opinionin e sfidat e mësimeve për detyrat e shtëpisë.....	88
Tabela 33. Kodet dhe temat që rrjedhin nga analiza tematike e të dhënave të intervistës me mësuesit	89
Tabela 34. Kodet dhe temat që rrjedhin nga analiza tematike e të dhënave të intervistës me prindër	102
Tabela 35. Kodet dhe temat që rrjedhin nga analiza tematike e të dhënave të intervistës me nxënës	106

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Parimet e Konstruktivizmit (e përshtatur nga Pritchard, 2009, fq. 32).....	21
Figura 2. Modeli i sistemit të aktivitetit (Engeström, 1987)	24
Figura 3. Faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë	39
Figura 4. Procedura e metodologjisë së hulumtimit	57
Figura 5. Grupimi i pyetjeve të pyetësorit në tri kategori kryesore.....	80
Figura 6. Të kuptuarit e zhvillimit të veprimtarisë së faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë	110

LISTA E SHKURTIMEVE

AFT	Federata Amerikane e Mësuesve
CHAT	Teoria e aktivitetit të sistemeve
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit
SPSS 20	Paketë statistikore për shkencat sociale/ Versioni 20
SZhAPU	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
ZHPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve
KEEN	Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
ZhP	Zhvillimi Profesional

Abstrakti

Përmes qëllimit të këtij hulumtimi janë identifikuar faktorët që ndikojnë te mësimitdhënësist për të caktuar detyra të shtëpisë, të cilat janë efektive dhe praktike. Për më tepër, hulumtimi ka nxjerr në pah qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë nga mësimitdhënësist si dhe sfidat me të cilat përballen mësimitdhënësist gjatë menaxhimit të detyrave të shtëpisë. Po ashtu, studimi ka arritur të zbulojë se si ndikojnë veçoritë personale e profesionale të mësimitdhënësist për të caktuar detyra të shtëpisë efektive dhe praktike. Hulumtimi është bazuar në teorinë e konstruktivizmit dhe teorinë e aktivitetit të sistemeve.

Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur metoda sasiore dhe ajo cilësore. Pjesëmarrësit e këtij studimi kanë qenë mësuesit e ciklit fillor, prindërit dhe nxënësist. Gjithsej 366 mësimitdhënës të ciklit fillor ndërsa për të kuptuar më thellë faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë janë organizuar 5 intervista me mësimitdhënës, 5 intervista me nxënës dhe 5 intervista me prindër në katër komuna, në të cilat është realizuar studimi.

Rezultatet e këtij hulumtimi kanë treguar për përcaktimin e qartë të qëllimit për dhënien e detyrave të shtëpisë dhe për menaxhimin e procesit të detyrave. Hulumtimi ofron njohuri të reja për sfidat me të cilat përballen mësimitdhënësist, prindërit dhe nxënësist gjatë përcaktimit të detyrave të shtëpisë si dhe rëndësinë e zgjedhjeve që bëjnë mësimitdhënësist ndaj trajtimit të detyrave të shtëpisë për të rritur nivelin e të nxënësist të nxënësve. Për më tepër, hulumtimi kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit të mësuesve për përdorimin e informatës kthyese pavarësisht faktorëve që e ndërlikojnë këtë proces. Rezultatet kanë treguar se përvoja e punës dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve nuk paraqet ndonjë dallim të rëndësishëm lidhur me efektivitetin e detyrave të shtëpisë. Prandaj, hulumtimi sugjeron zhvillimin profesional të mësimitdhënësve duke ofruar trajnime specifike për detyrat e shtëpisë. Studimi propozon edhe mbështetjen e prindërve me anë të trajnimeve për të bërë më të lehtë qasjen e tyre në detyrat e shtëpisë.

Studimi konkludon që politikëbërësit arsimorë në bashkëpunim me shkollat të vendosin një standard për detyrat e shtëpisë që është në funksion të lëvizjes nga realiteti ekzistues drejt realitetit të dëshiruar duke inkorporuar edhe elementet e sfondit personal dhe profesional të mësimitdhënësve si dhe kontekstin e punës. Kjo shihet vetëm si tranzicion drejt fuqizimit të qasjes së re të mësimitdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë dhe integritit të praktikave efektive si pjesë e identitetit profesional të mësimitdhënësve dhe realitetit rutinor.

Fjalët kyçe: detyra të shtëpisë, faktorët, informata kthyese, mësimitdhënësist, prindërit, nxënësist

Abstract

The purpose of this research has been to identify the factors affecting teachers when assigning effective and practical homework. Furthermore, the research has highlighted the purpose of homework assignment by teachers as well as the challenges that teachers face when managing homework. Also, the study has managed to discover the influence that the teachers' personal and professional characteristics have when assigning effective and practical homework. The research is based on constructivism theory and the theory of systems activity.

Quantitative and qualitative methods were used for data collection. Participants in this study were primary school teachers, parents and students. A total of 366 primary school teachers. In order to better understand the factors affecting the effectiveness of homework, 5 interviews with teachers, 5 interviews with students and 5 interviews with parents were organized in four municipalities, in which the study was conducted.

The results of this research have indicated to clearly define the purpose of assigning homework and managing the homework process.

The research provides new insights into the challenges faced by teachers, parents and students in assigning homework as well as the importance of choices that teachers make towards using homework to enhance the learning level of students. Furthermore, the research contributes to raising teachers' awareness of the use of feedback despite the factors that complicate this process. The results showed that the teachers' work experience and professional development does not represent any significant difference in terms of the effectiveness of homework. Therefore, the research suggests the teachers' professional development by providing specific homework training. The study also proposes to support parents by training them to make their homework easier.

In the study it is concluded that educational policy makers in cooperation with schools, set a standard for homework that is in function of moving from existing reality to the desired reality by incorporating elements of teachers' personal and professional background as well as work context. This is seen only as a transition towards strengthening teachers' new approach to homework and integrating effective practices as part of teachers' professional identity and routine reality.

Keywords: constructivism, effective homework, factors, feedback, teachers, parents, students

KAPITULLI I: HYRJE

“Nëse fëmija mëson se si të studiojë, mendja e tij nuk ka më asnjë lloj kufizimi. Thelbi i mësimdhënies synon që një ide të sjellë lindjen e një tjetre.”

Marva Kollins

1.1. Hyrje

Çështja e detyrave të shtëpisë ka një histori të gjatë. Detyrat e shtëpisë janë pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënies dhe të nxënës, gjë të cilën mësuesit shumë shpesh e praktikojnë atë në procesin e mësimdhënies (Ilgar & Ilgar, 2012). Hulumtimi në fushën e detyrave të shtëpisë historikisht ka qenë shqetësues për mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit. Detyrat e shtëpisë u konsideruan pjesë integrale e procesit arsimor, por kohët e fundit, ndoshta për shkak të ndryshimeve të mënyrës së jetesës, kjo temë ka ngritur dyshime, prandaj ende vazhdon debati për caktimin e detyrave të shtëpisë.

Detyrat e shtëpisë janë pjesë e rutinës së përditshme të nxënësve, megjithëse vazhdimisht ka debate nga mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit për mënyrën e zbatimit të tyre. Koha që nxënësit e shkollave fillore e kalojnë në shkollë nuk është e mjaftueshme që ata të forcojnë dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre, prandaj është e nevojshme që nxënësve t'u jepen detyra të shtëpisë pasi detyrat sigurojnë një mësim domethënës përtej klasës. Përveç kësaj, ka mungesë studimesh lidhur me cilësinë e detyrave të shtëpisë që mësimdhënësi i cakton për nxënësit e tyre, andaj gjetjet e këtij studimi treguan më së miri për avancimin e zbatimit të detyrave të shtëpisë në teorinë dhe në praktikën e mësimdhënies, në këtë kontekst me tendencë gjeneralizimi duke marrë parasysh variablat personale dhe profesionale të mësimdhënësve.

Hulumtimet (Cooper et al., 2006; Epstein & Voorhis, 2001; Fawzy, 2012; Hoeke, 2017; Minke, 2017; Stogner, 2014; Voorhis, 2004) thonë se kur planifikohen detyrat e shtëpisë, duhet të kihet parasysh: qëllimi i detyrave të shtëpisë; zbatimi efektiv i detyrave të shtëpisë; ofrimi i informatave kthyesë për nxënës; koha që shpenzojnë nxënësit në detyra dhe përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë. Mësimdhënësit duhet t'iu japin nxënësve detyra që janë të qëllimshme për ta dhe të jenë të përshtatshme për stilet e tyre të të mësuarit. Mësimdhënësit nuk duhet t'iu japin nxënësve detyra sa për t'iu dhënë, por vetëm kur ka një qëllim specifik (Carr, 2013). Pra, është shumë e rëndësishme që detyrat e shtëpisë të përcaktohen qartë. Detyrat e shtëpisë nuk janë detyra të papërfunduara në klasë që nxënësi duhet t'i marrë në shtëpi dhe t'i përfundojë. Detyrat e shtëpisë duhet të inkurajojnë nxënësin që të reflektojë, të mendojë në mënyrë të pavarur, të sfidohet duke zgjidhur probleme të ndryshme nga jeta e përditshme dhe në të njëjtën kohë të nxisë kureshtjen për dije.

Është përgjegjësi e mësimitdhënësve të jenë të vetëdijshëm për literaturën që kanë në dispozicion kur caktojnë detyrat e shtëpisë duke u bazuar në kurrikulën dhe nivelin e nxënësve të klasës.

Duke i kuptuar më mirë faktorët që ndikojnë te mësuesit për caktimin efektiv të detyrave të shtëpisë, gjasat për të zhvilluar mekanizma dhe procese në nivel shkolle janë më reale. Rezultatet e këtij hulumtimi do të ofrojnë zgjidhje në mënyrë që mësimitdhënësit të mund t'i caktojnë qartë qëllimet për dhënien e detyrave të shtëpisë dhe mënyrën se si të menaxhojnë procesin e detyrave. Hulumtimi po ashtu ofron njohuri të reja teorike për rëndësinë e kontekstit të shkollës dhe profesionit të mësimitdhënësit në raport me trajtimin e detyrave të shtëpisë si një element esencial i punës së mësimitdhënësve.

1.2. Korniza teorike e studimit

Ky studim është mbështetur në teorinë e konstruktivizmit dhe teorinë e aktivitetit të sistemeve të cilat do të shërbejnë si kornizë teorike e studimit. Përdorimi i këtyre dy teorive bëhet me qëllim që të ofrohet një kornizë e cila do të shërbejë për zhvillimin e hulumtimit si dhe interpretimit të rezultateve të hulumtimit në një mënyrë që do të mund të elaborohen dhe kuptohen rezultatet e hulumtimit.

1.2.1. Teoria e Konstruktivizmit

Konstruktivizmi është term i gjerë, i përdorur nga filozofë, psikologë, mësues dhe hulumtues të fushave të ndryshme. Konstruktivizmi është një teori që mbështet ndërtimin e njohurive të nxënësve. Sipas Miller (2002), pavarësisht që kemi shumë filozofi të mësimitdhënies, teoria e Konstruktivizmit është një nga filozofitë më të mira të mësimitdhënies e cila mbështet ndërtimin e njohurive nga nxënësit. Kjo teori paraqitet si kornizë e cila bazohet në vëzhgimin dhe studimin shkencor, për mënyrën se si njerëzit mësojnë. Kjo teori ka marrë vëmendje të madhe në vitet e fundit, për shkak të ndikimit të saj në edukimin shkencor. Në shumë shkolla, konstruktivizmi po diskutohet si metoda më e mirë për mësimitdhënie dhe mësimitnxënie (Kalina & Powell 2009).

Konstruktivizmi i ka rrënjët në filozofi, psikologji, sociologji dhe arsim. Kjo teori paraqet një nga idetë e mëdha në arsim. Konstruktivizmi kërkon që mësuesi/ja të veprojnë si lehtësues/e, funksioni kryesor i të cilit/cilës është të ndihmojë nxënësit të bëhen pjesëmarrës aktiv në mësimin e tyre dhe të bëjnë lidhje kuptimplotë ndërmjet njohurive paraprake, njohurive të reja dhe proceseve të përfshira në mësim (Bada & Olusegun, 2015).

Ndryshe nga teoritë e mëparshme, konstruktivizmi, si teori arsimore, e parashihet rolin e mësimitdhënësit dhe të nxënësit. Mësimitdhënësi më nuk është transmetuesi dhe bartësi i dijes, pasi të nxënësit nuk ndodh në segmentin ndërmjet nxënësit, në njërin anë, e librit të mësimitdhënësit në anën

tjetër, por paraqitet si proces zhvillimor në kokën e subjektit njohës, domethënë të nxënësit (Rexhaj, 2016, fq. 46). Pikëpamjet konstruktiviste mbështeten në idetë se nxënësit i zhvillojnë aktivisht njohuritë e tyre dhe se nuk i marrin ato pasivisht, si pako të ambalazuara, nga mësimdhënësit apo burimet e jashtme (Woolfolk, 2011).

Në një model konstruktivist, çelësi i të mësuarit është që nxënësi të gjejë mënyra të shumta për të lidhur njohuri ose kuptim të ri me përvojat e mëparshme njohëse. Sipas autorëve (Liu & Chen, 2010; Nayir et al., 2009), një mësues konstruktivist duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojat dhe interesat e nxënësve, dallimet sociale, emocionale dhe socio-ekonomike. Roli i mësuesit është një lehtësues që ofron informacion dhe organizon aktivitete për nxënësit të zbulojnë të mësuarit e tyre. Në klasat konstruktiviste, nxënësit nuk e përsërisin në mënyrë pasive informacionin e dhënë nga mësuesi. Ata demonstrojnë të mësuarit dhe të kuptuarit e tyre përmes mjeteve të ndryshme si zhvillimi i pyetjeve kritike dhe duke përmbledhur idetë me fjalët e tyre.

Ariasian dhe Walsh (1997) identifikuan tri arsye për popullaritetin e konstruktivizmit në mësimdhënie: Së pari, konstruktivizmi u mundëson shkollave që të promovojnë rezultate të të nxënësve të niveleve më të larta duke inkurajuar nxënësit e tyre të ndërtojnë kuptimet dhe interpretimet e tyre.

Së dyti, konstruktivizmi supozon se të gjithë nxënësit mund dhe do të mësojnë, ndërsa fitojnë dhe ndërtojnë njohuritë e tyre personale.

Së treti, konstruktivizmi u jep mësuesve më shumë diskrecion të ndërtojnë kuptimet dhe interpretimet e tyre në mënyrë që të përmirësojnë mësimdhënien dhe të nxënësve në klasë (siç është cituar Alsharif, 2013).

Në anën tjetër, Bada dhe Olusegun (2015) potencuan disa nga përfitimet e konstruktivizmit:

- Fëmijët mësojnë dhe kënaqen më shumë kur janë të përfshirë në mënyrë aktive, në vend të dëgjuesve pasivë.
- Arsimi funksionon më mirë kur përqendrohet në të menduarit dhe të kuptuarit, sesa në memorizimin përmendësh. Konstruktivizmi përqendrohet në të mësuarit se si të mendosh dhe të kuptosh.
- Të mësuarit konstruktivist është i transferueshëm. Në klasat konstruktiviste, nxënësit krijojnë parime organizimi që mund t'i marrin me vete në mjedise të tjera mësimore.
- Konstruktivizmi u jep nxënësve pronësinë e asaj që ata mësojnë, pasi të nxënësve bazohet në pyetjet dhe eksplorimet e nxënësve, dhe shpesh nxënësit kanë një dorë edhe në hartimin e vlerësimeve. Angazhimi i instinkteve krijuese zhvillon aftësitë e nxënësve për të shprehur njohuritë në mënyra të ndryshme.

- Duke i bazuar aktivitetet mësimore në një kontekst autentik, të botës reale, konstruktivizmi stimulon dhe angazhon nxënësit. Nxënësit në klasat konstruktiviste mësojnë të vënë në dyshim gjërat dhe të zbatojnë kureshtjen e tyre natyrore në botë.
- Konstruktivizmi promovon aftësitë sociale dhe komunikuese duke krijuar një mjedis në klasë që thekson bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ideve. Nxënësit duhet të mësojnë se si t'i artikulojnë qartë idetë e tyre si dhe të bashkëpunojnë në detyrat në mënyrë efektive duke ndarë në projekte grupore. Prandaj, nxënësit duhet të shkëmbejnë ide dhe kështu duhet të mësojnë të "negociojnë" me të tjerët dhe të vlerësojnë kontributet e tyre në një mënyrë të pranueshme shoqërore. Kjo është thelbësore për suksesin në botën reale, pasi ata gjithmonë do të ekspozohen ndaj një sërë përvojash në të cilat ata do të duhet të bashkëpunojnë dhe të lundrojnë midis ideve të të tjerëve.

Konstruktivizmi është mënyrë për të kërkuar mënyra efektive të mësimdhënies dhe të mësuarit, ku mësimdhënësi përkrah, lehtëson dhe drejton punën e nxënësve. Kjo teori parasheh që nxënësit të ndërtojnë realitetin e tyre bazuar në perceptimet e tyre individuale të përvojave të mëparshme. Kështu, njohuria e çdo personi është një funksion i përvojave të tij të mëparshme, si ato perceptohen dhe si janë organizuar. Megjithatë, konstruktivizmi nxit individin (Dale, 2012; Larochelle et al., 1998). Kjo teori hipotezon që individët do të përpiqen të kuptojnë të gjitha informacionet që ata perceptojnë dhe se secili individ, pra, do të "ndërtojë" kuptimin e vet nga ai informacion (Miller, 2002). Kjo kornizë shpjegon se si njerëzit mund të fitojnë njohuri dhe të mësojnë, prandaj ka aplikim të drejtpërdrejtë në arsim. Po ashtu edhe lidhje me detyrat e shtëpisë derisa paraqet mënyrën se si njerëzit mësojnë dhe kërkon që mësuesit të përdorin metoda e strategji të ndryshme duke vepruar si një lehtësues apo ndihmës i nxënësve derisa ata mësojnë. Një mësues konstruktivist kontrollon detyrat e shtëpisë dhe projektet dhe gjithmonë u jep përgjigje nxënësve (Nayir et al., 2009).

Rexhaj (2019) pohon se kontributi më i madh i konstruktivizmit është se shënon një kalim thelbësor nga qasja *instruktive* (transferimit të dijes përmes mësimdhënies) në qasjen *konstruktive* (ndërtimit të dijes në mendjen e nxënësit përmes përvojave të të nxënit dhe ndërveprimit me mjedisin). Konstruktivizmi për nga natyra e vet përmbledh shumicën e qasjeve, strategjive dhe praktikave moderne të mësimdhënies në vendet më të përparuara të botës. Përmes kësaj teorie, mësimdhënësi është më afër praktikave më të mira të mësimdhënies në botën e përparuar. Përmes të mësuarit konstruktivist janë eksploruar edhe faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë si njëra ndër praktikat e kontekstit mësimor kosovar të pa trajtuar deri më tani. Parimet e konstruktivizmit janë të lidhura ngushtë me mënyrën se si mësimdhënësit iu qasen nxënësve në raport me detyrat dhe angazhimet që

posedojnë ata, pasi kjo teori ndihmon mësime të praktikojnë strategji, metoda dhe teknika më të mira të mësimit në përgatitjen e gjeneratave të reja.

Autorë të shumtë kanë listuar parime të ndryshme të teorisë së konstruktivizmit. Për studimin tonë fokusi ka qenë te lista e autorit, Allan Pritchard. Sipas tij, konstruktivizmi ngërthen në vete 6 parime, si: ndërtimi i dijes mbi dijen paraprake; të nxënimit autentik dhe në kontekste të kuptimshme; metakognicioni – vetëdijesimi për procesin e të nxënimit; pjesëmarrja aktive e nxënimit; autonomia dhe përgjegjësia për të nxënë; të nxënimit në ndërveprim (Pritchard, 2009, fq.32).




Figura 1. Parimet e Konstruktivizmit (e përshtatur nga Pritchard, 2009, fq. 32).

Ndërtimi i dijes mbi dijen paraprake mund të shërbejë për të parë se si mësime të përshtatin detyrat e shtëpisë duke u bazuar në dijen paraprake dhe dijen praktike të nxënimit. Është shumë e rëndësishme kur mësime të nisur nga dija paraprake e nxënimit pasi në këtë mënyrë e ka më të lehtë të caktojë detyra që janë të përshtatshme dhe praktike për nxënimit. Sipas Rexhaj (2016), secili nxënës ka dijen dhe përvojat paraprake, dijen praktike që e bën të mjaftueshëm e funksional në jetë dhe shërben për përshtatje në jetë dhe për realizimin e qëllimeve të veta.

Parimi i të nxënimit autentik është i lidhur ngushtë me mënyrën se si mësime të integrojnë detyrat e shtëpisë si pjesë të praktikës së zakonshme. Sipas Pritchard (2009), nuk mund të ketë të nxënë efektiv dhe motivim të duhur të nxënimit për të mësuar, në qoftë se përmbajtja dhe konteksti i të nxënimit nuk janë të tilla që pikërisht të ndërlidhen me dijen ekzistuese, me përvojat e deritanishme të të nxënimit dhe me kontekstin e nxënimit. **Parimi i metakognicionit** na shërben për të parë se si mësime të përshtatin detyrat e shtëpisë varësisht nga personaliteti dhe nga të nxënimit individual, si edhe si e

ndërlidhin të nxënit e ri me të nxënit ekzistues. Në thelbin e teorisë konstruktiviste është *pjesëmarrja aktive e nxënësit* dhe *qasja me në qendër nxënësin*. Bazuar në këtë parim, mësimitdhënësi ka rol shumë të rëndësishëm në këtë proces si facilitues, si mundësues dhe si lehtësuesit i të nxënit; ai i orienton dhe i ndihmon nxënësit në aktualizimin e të nxënit paraprak dhe në ndërlidhjen e tij me të nxënit e ri (Pritchard & Woollard, 2010).

Kur nxënësit i marrin detyrat e shtëpisë nga mësimitdhënësi, sigurisht që ata janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë për t'i përfunduar detyrat, prandaj parimi "*autonomia dhe përgjegjësia për të nxënë*" ndihmon në realizimin e detyrave të shtëpisë. *Të nxënit në ndërveprim* ka ndihmuar në rezultatet e hulumtimit për të identifikuar nëse mësimitdhënësit caktojnë detyra të shtëpisë në të cilat nxënësit ndërveprojnë me njëri – tjetrin, p.sh. duke punuar në një projekt të përbashkët, ose nëse ata ndërveprojnë edhe me ndonjë anëtar të familjes.

Sipas Forster (2011), Piazhë dhe Vigotsky, nuk kishin në mendje detyrat e shtëpisë kur formuluan teoritë e tyre, por që të dy zbulojnë parime të përgjithshme për mësimitdhënien dhe të mësuarit që të kenë një zbatueshmëri të qartë në kontekstin e të mësuarit. Një qasje Piazhiste ndaj detyrave të shtëpisë do të përqendrohej në përshtatshmërinë e detyrës deri në fazën e zhvillimit, ndërsa qasja Vigotskiane do të përqendrohej në punën bashkëpunuese duke ndërvepruar me të rriturit. Ndërveprimet të mos përqendrohen vetëm në njohuri dhe kuptim, por edhe në operacione më të larta mendore që do të zhvillojnë aftësinë e fëmijës për të mësuar.

1.2.2. Teoria e Aktivitetit të Sistemeve

Teoria e aktivitetit të sistemeve (CHAT), konsiderohet si një teori e re që lidhet me praktikën pedagogjike. Kjo kornizë është quajtur si “një nga sekretet më të ruajtura të akademisë” (Roth & Lees, 2007, fq. 50). Si teori mjaft aktuale përfshin zhvillimin e të mësuarit njerëzor, zhvillimin organizativ dhe përdorimin e zbatimit të ndryshimeve arsimore (Saqipi, 2020).

Sipas Engeström (2012), teoria e aktivitetit u inicua nga Lev Vygotski (1978) diku në mes të viteve 1920 dhe 1930. Më pas, u zhvillua nga kolegu Alexei Leont’ev (1978, 1981). Tutje, teoria e aktivitetit si kornizë u zhvillua nga Engestrom (1987) duke u bazuar në konceptin e Vygotskit (Saqipi, 2020).

Teoria e aktivitetit të sistemeve në kërkimin arsimor, ofron një perspektivë unike për studiuesit që trajtojnë ndërveprimet ndërmjet aspekteve individuale dhe kontekstuale të një aktiviteti. Kjo teori synon veprimin, praktikën njerëzore, të mësuarit dhe zhvillimi mund të konsiderohet si një teori e re lidhur me praktikën pedagogjike (Saka et al., 2009; Yamazumi, 2006). Roth dhe Lees (2007, fq. 32) : ‘Me rëndësi të drejtpërdrejtë për mësimdhënësit, teoria e aktivitetit të sistemeve ka qenë gjithmonë një teori e bazuar në praktikën dhe e dalë nga praktika, kështu që aspiron të jetë një teori për praktikën’.

Foot (2014) thekson se teoria e aktivitetit të sistemeve përqëndrohet në tre ide thelbësore:

- Njerëzit veprojnë kolektivisht, mësojnë duke bërë dhe komunikojnë përmes veprimeve të tyre.
- Njerëzit bëjnë, përdorin dhe përshtatin mjete të të gjitha llojeve për të mësuar dhe komunikuar.
- Komuniteti është qendror në procesin e krijimit dhe interpretimit të kuptimit dhe kështu për të gjitha format e të mësuarit, komunikimit dhe veprimit.

Kjo teori evoluon vazhdimisht nëpërmjet veprimeve të të nxënit dhe mundëson analiza shumëplanëshe të praktikave komplekse profesionale.

Siç mund të shihet në figurën 2, elementet bazë që e formojnë sistemin e aktivitetit janë: subjektet, objekti, mjetet dhe instrumentet (artefaktet ndërmjetësuese), rregullat, komuniteti dhe ndarja e punës. Subjekti paraqet pjesëmarrësit në aktivitet të cilët punojnë në arritjen e objektit që përfaqëson qëllimin e përgjithshëm të veprimtarisë. Objekti është qëllimi kryesor që subjekti vepron dhe transformohet. Mjetet janë proceset që subjekti mund t’i përdorë për të arritur objektin. Rregullat paraqesin standardet të cilat ndihmojnë subjektin në arritjen e qëllimit të përgjithshëm. Komuniteti përfshin bashkëpunimin me të gjithë akterët për të arritur qëllimin e përgjithshëm. Si element i fundit që formon sistemin e aktivitetit është ndarja e punës që paraqet përgjegjësitë e të gjithë pjesëmarrësve në këtë sistem të veprimtarisë duke përfshirë edhe komunitetin.




Figura 2. Modeli i sistemit të aktivitetit (Engeström, 1987)

Të gjitha këto elemente të këtij sistemi të aktivitetit janë përdorur në këtë studim për të identifikuar faktorët, të cilët ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë dhe mënyrën e praktikimit të këtyre faktorëve në kontekstin e studimit. Teoria e aktivitetit të sistemeve është adaptuar për ta kryer këtë hulumtim duke përdorur shumëllojshmëri konstruktesh për nevojat e këtij hulumtimi andaj kjo teori është më interes të jashtëzakonshëm për studimin pasi është treguar e frytshme për analizimin e faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë si dhe sfidave që hasin mësuesit, nxënësit dhe prindërit gjatë zbatimit të këtyre detyrave.

Sipas autorëve (Roth & Lees, 2007), CHAT është promovuar si një teori zhvillimore sepse kërkon jo vetëm të shpjegojë, por gjithashtu dhe më e rëndësishmja, të ndikojë në ndryshimet cilësore në praktikën njerëzore.

1.3. Arsyetimi i hulumtimit

Edhe pse detyrat e shtëpisë konsiderohen pjesë integrale e procesit arsimor, ende vazhdon të ketë debate për mënyrën e dhënies së detyrave të shtëpisë. Për çështjet rreth detyrave të shtëpisë për nxënësit është hulumtuar në mënyrë të konsiderueshme deri më sot, por debati vazhdon lidhur me sfidat me të cilat përballen mësuesit për përcaktimin e një qëllimi kuptimplotë (Beutlich, 2008; Epstein & Voorhis, 2001; Hoeke, 2017; Landing - Cooretjer, 2009). Kjo çështje është e lidhur ngushtë me specifikat e praktikës profesionale të mësuesit si dhe me të menduarit pedagogjik të mësuesve lidhur me rolin e mësuesit në përgjithësi dhe menaxhimin e detyrave të shtëpisë në veçanti. Për më tepër, një dimension kritik në përdorimin e detyrave të shtëpisë në shkollë është se si mësuesit i menaxhojnë këto detyra, përfshirë fazën e planifikimit, informatën kthyesë në detyrat e shtëpisë, kohën që nxënësit e kalojnë në detyra si dhe përfshirjen e prindërve në detyra të shtëpisë.

Rreth mënyrës se si mësuesit u qasen detyrave të tyre, por edhe detyrave të shtëpisë për nxënësit, është hulumtuar mjaft në nivel ndërkombëtar, përderisa variablat e kontekstit të shkollës së Kosovës përfaqësojnë një dimension që duhet të shqyrtohet në lidhje me mënyrën se si mësuesit e kuptojnë dhe i qasen kësaj çështjeje, me qëllim që të ofrojnë njohuri të reja shkencore rreth variablave më të gjera të sistemit dhe profesionit të mësimit në raport me trajtimin e duhur të detyrave të shtëpisë për nxënësit.

Vlen të përmendet fakti që ka një mungesë të qartë të një standardi apo të një plani në nivel të përgjithshëm ku mësuesit mund të bazojnë dhënien e detyrave të shtëpisë, në mënyrë që nevojat individuale të mund të adresohen varësisht nga nevojat e nxënësve pasi gjatë shqyrtimit të literaturës në kontekstin e studimit nuk është gjetur asnjë dokument zyrtar që posedon ndonjë standard për mënyrën e menaxhimit të detyrave të shtëpisë.

Realiteti i zbatimit të detyrave të shtëpisë në kontekstin e hulumtimit, por edhe më gjerë tregon se detyrat e shtëpisë nuk kryhen ashtu siç duhet ose për shkak se mungon informata kthyesë nga mësuesi. Studimet e fundit tregojnë që nxënësit kanë më shumë gjasa të punojnë detyra të shtëpisë kur mësuesit japin informata kthyesë (Núñez et al., 2015). Kjo dhe qasja e përgjithshme ndaj konceptimit të detyrave të shtëpisë, natyrisht janë të ndërlidhura me specifikat personale dhe profesionale të mësuesve, por edhe me specifikat e shkollës në përgjithësi.

Një pikënisje tjetër e këtij studimi është edhe nevoja e gjetjes së mundësisë për rritjen e potencialit të të mësuarit të nxënësit, si dhe ofrimi i mundësisë që detyrat e shtëpisë të jenë mjet përmes të cilit nxënësit kanë mundësi t'i zbatojnë në praktikë njohuritë e fituara. Është e rëndësishme të theksohet se lidhja e detyrave të shtëpisë me jetën reale nuk qëndron në nivelin e duhur, në Kosovë. Detyrat që përfshijnë zgjidhjen e problemeve dhe ndërlidhjen me përditshmërinë nuk janë të përfshiera mjaftueshëm nëpër tekstet shkollore. Nxënësit nuk janë shumë të sfiduar me detyra problemore që i

nxësin ata të mendojnë në mënyrë logjike. Këtë, e dëshmojnë edhe rezultatet e testit PISA. Bazuar në rezultatet e PISA (OECD, 2016), nxënësit duhet të forcojnë njohuritë e tyre, sa më shumë që të jetë e mundur, duke mësuar më shumë gjëra që lidhen me jetën e reale.

Duke qenë se detyrat e shtëpisë sigurojnë mësim domethënës jashtë ambientit të shkollës, identifikimi i përgjegjësive dhe i shprehive të punës kërkimore me nxënësit, si një nga mangësitë e theksuara të sistemit arsimor në ditët e sotme e në veçanti në kontekstin e këtij hulumtimi është mjaft i rëndësishëm.

1.4. Konteksti i hulumtimit

Sistemi arsimor në Kosovë në të gjitha periudhat e historisë është sfiduar shumë rreth zhvillimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pas mbarimit të luftës në Kosovë, sistemi i arsimit ishte në një proces të vazhdueshëm të reformave dhe inovacioneve që do të ndihmonin krijimin e një sistemi cilësor dhe gjithëpërfshirës. Pas vitit 1999, ishin identifikuar shumë probleme të mëdha, të cilat theksuan nevojën për ndryshim në sistemin e arsimit në vendin tonë. Sistemi i arsimit në Kosovë gradualisht filloi të transformohet duke punuar në drejtim të zhvillimit të cilësisë së procesit mësimor si dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Këto zhvillime u fokusuan në ridizajnimin e planprogrameve shkollore dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve. U bënë përpjekje të vazhdueshme që të largohet mësimdhënia tradicionale dhe shkolla të ketë filozofi me nxënësin në qendër (Saqipi, 2014).

Një ndër faktorët primar që ndikon, në mënyrë të drejtpërdrejtë, në ngritjen e cilësisë në shkolla është padyshim zhvillimi profesional i mësimdhënësve. Sipas dokumentit të Komisionit Evropian (2013), “Supporting teacher competence development - for better learning outcomes”, zhvillimi profesional i mësimdhënësve po konsiderohet si një detyrë profesionale për mësuesit në 24 vende evropiane. Kosova përgjatë shumë viteve vazhdimisht ka zhvilluar politika të ndryshme për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyrë të qëndrueshme. Për të ndihmuar rreth zhvillimit profesional të mësimdhënësve në fusha specifike ndihmuan shumë organizata joqeveritare (OJQ) dhe projekte të donatorëve.

Sipas Saqipi (2014), mbështetja e Kosovës nga partnerët ndërkombëtarë në hartimin e Kurrikulës në vitin 2001 për të reformuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënies në shkolla, konsiderohej si një zhvillim i madh në sistemin e arsimit në Kosovë. U ngjall një shpresë për përmirësimin e përvojave të nxënësve në shkolla. Në vitin 2011, MASHT, specifikoi se mësimdhënia dhe të nxënies në shkolla duhet të jetë e bazuar në kompetenca dhe në rezultate të të nxënies. Lidhur me këto, në nivelin e politikave kishte disa zhvillime (Kurrikula, 2011). Ndër të parat ishte Plani Strategjik

i Arsimit (PSAK) 2011 – 2016 (MASHT 2011), i cili kishte për qëllim trajnimin e mësuesve për t'u aftësuar lidhur me zbatimin e kurrikulës në klasë.

Zhvillimi profesional i mësuesit deri më tani është zhvilluar në formë të trajnimeve dhe shpesh kur flasin për zhvillimin profesional të mësimeve të referohemi shkuarjes nëpër trajnime të ndryshme. Trajnimi i mësuesve u pa si një instrument i fuqishëm për të përmirësuar praktikën e mësimit në klasa (Saqipi, 2014).

Zhvillimet e shumta që po bëhen në arsim, kërkojnë që mësuesi të jetë i përgatitur për të përballuar çdo reformë për të përgatitur sa më mirë brezat e rinj. Në vitin 2017, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) prezantoi kornizën strategjike për zhvillimin e mësimeve për Kosovë, e cila përbëhet prej shtatë standardeve që përcaktojnë atë se çfarë duhet të dinë dhe të bëjnë mësuesit. Këto standarde janë të grupuara në katër fusha të mësimit, si: vlerat profesionale (qëndrimet dhe sjelljet); njohuritë profesionale dhe të kuptuarit; praktika profesionale; mësimi dhe angazhimi profesional.

Sipas një studimi të realizuar nga "Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN" (2019), zhvillimi profesional i mësimeve, nga periudha e pasluftës (1999) ka pasur zhvillime të shumta si në kuadër të politikave, ashtu edhe në praktikën e realizimit. Në dekadën e fundit ka fituar një dimension të ri, në përpjekje për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm për zhvillimin e mësimeve, në dobi të të gjithë mësimeve, për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe avancimin e kompetencave të mësimit, sepse zhvillimi profesional i mësimeve vlerësohet të jetë një ndër faktorët kyç që ndikon, në mënyrë të drejtpërdrejtë, në ngritjen e cilësisë së mësimit dhe të nxënësve.

Konteksti i punës së mësimeve në Kosovë është mjaft kompleks, dinamik dhe sfidues për shkak të ndryshimeve në kualifikimin e mësimeve, kontekstin e shkollave dhe të kushteve të mjedisit që ofrojnë ato për punë me nxënës, për shkak të ndryshimeve në reformën kurrikulare dhe ndryshimeve në rolin e tyre, por edhe për shkak të aspekteve tradicionale të zhvillimit të mësimeve dhe natyrës së punës së tyre. Si çdokund tjetër në botë, mësuesit bartin një numër të përgjegjësiave mbi supë të cilat vetëm sa shtohen (KEEN, 2019).

Deri më tani zhvillimi profesional i mësimit është bërë përmes trajnimeve të ndryshme, goftë në baza vullnetare nga vetë mësuesi goftë nga institucionet e ndryshme të vendit apo edhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Pavarësisht që këto trajnime kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e kurrikulës, menaxhimin e klasës, vlerësimin e nxënësve dhe shumë fushave të tjera të rëndësishme që lidhen me sigurimin e mësimit cilësor në arsim ende e kemi të nevojshme që të sigurojmë ekspertë të mirëfilltë për zhvillimin e mësimit cilësor në sistemin e arsimit në Kosovë. Fokusi duhet të jetë edhe në zbatimin e mirëfilltë të kurrikulës.

Duhet ende shumë angazhim nga mësimehënësist që praktikojnë zbatimin e kurrikulës në klasat e tyre pasi ndjekja e trajnimeve për zbatimin e kurrikulës jo gjithherë ka treguar edhe rezultate të mira. Mësimehënësist vazhdimisht duhet të zhvillohen në mënyrë që t'u ndihmojnë nxënësve që të zhvillojnë kapacitete gjatë gjithë jetës.

Ata duhet që ta përmirësojnë mësimehënien dhe nxënien duke bashkëpunuar me të tjerët, duke reflektuar për punën e tyre, duke përdorur metoda të ndryshme të mësimehënies, duke përshtatur detyra sipas stileve të ndryshme të nxënies, duke motivuar nxënësist për punë si dhe duke dhënë informata kthyesë në vazhdimësi për detyrat që bëjnë nxënësist në klasë dhe shtëpi. Këtë e dëshmon edhe rezultati i fundit në testin PISA (OECD, 2019). Tri vjet pas testit fillestar, Kosova nuk ka shënuar përmirësim të madh në testin ndërkombëtar PISA. Me gjithë pritjet e premtimet e shumta, sistemi arsimor në vendin tonë nuk e ka kaluar shumë mirë këtë test. Rezultatet e testit kanë shfaqur të dhëna shqetësuese për njohuritë e 5 mijë nxënësve të moshës 15 vjeçare të testuar si mostër në vitin 2018. Këto rezultate janë një tregues i rëndësishëm i efektivitetit të sistemit të detyrueshëm të arsimit fillor dhe një tregues i besueshëm i edukimit të ardhshëm.

Sipas KEEN (2019), rezultatet e testit ndërkombëtar PISA 2015 dhe studimet e tjera që ndërliiden me cilësinë e mësimehënies dhe të të nxënist, tregojnë se zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimehënësve nuk ka alternativë, prandaj Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet që të shtojë veprimet konkrete për ndërtimin e një sistemi të mirëfilltë dhe të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimehënësve në funksion të realizimit të reformës arsimore dhe siç përcaktohet me Sistemin e Licencimit të Mësimehënësve dhe Kornizën Strategjike për Zhvillimin e Mësimehënësve në Karrierë.

Sipas Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (2017 – 2021), mësimehënësist janë bartësit e ndryshimeve në çdo sistem të arsimit, prandaj është me rëndësi përgatitja profesionale e tyre. Sipas Paquay dhe Wagner (2001) bazë e përbashkët në kultura të ndryshme për natyrën e mësimehënies, kompetenca e të mësuarit dhe e mësuesve mund të përshkruhet në gjashtë paradigma të gjera, të cilat duhet të shihen si aspekte të integruara, plotësuese të profesionit (siç është cituar në Supporting teacher competence development - for better learning outcomes, Komisioni Evropian, 2013):

- Mësuesi si një agjent reflektues;
- Mësuesi si një ekspert i ditur;
- Mësuesi si një ekspert i aftë;
- Mësuesi si aktor në klasë;
- Mësuesi si një agjent shoqëror;
- Mësuesi si një nxënës gjatë gjithë jetës.

Fatkeqësisht, në kontekstin tonë, politika për mësuesin si nxënës gjatë gjithë jetës mbetet mjaft e kufizuar. Praktika e mirë gjithnjë e më shumë i shikon mësuesit si nxënës gjatë gjithë jetës. Zhvillimet në sferën e arsimit kërkojnë që mësimitdhënësit të posedojnë shkathtësi të theksuara profesionale dhe pedagogjike, si dhe kompetenca të shtuara për vendimmarrje në shkollë dhe në klasë.

Nevoja për përgatitjen optimale të të rinjve për botën e globalizuar, me kërkesa dhe mundësi që vazhdimisht ndryshojnë, kërkon mësimitdhënës që mund të krijojnë një mjedis nxitës të të nxënës, që mbështet të nxënës dhe zhvillimin e kompetencave dhe shërben si model me veprimet e tij/saj. Një gjë e tillë nënkupton nevojën për fuqizim të rolit të mësimitdhënësit në raport me planifikimin mësuesor, zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimitdhënies dhe të të nxënës, vlerësimin e nxënësve, përgatitjen dhe përdorimin e materialeve online si dhe të mjeteve të ndryshme të konkretizimit. Të gjitha këto elemente kanë shtruar nevojën për zhvillim profesional të vazhdueshëm të mësimitdhënësve.

Pavarësisht të gjitha përpjekjeve për të bërë ndryshime në praktikën shkollë nuk është e mjaftueshme vetëm ndjekja e këtyre trajnimeve apo zhvillimi profesional i mësimitdhënësve deri këtu ku jemi sot. Një shkollë është kreative apo praktike po aq sa janë kreative e praktikë mësimitdhënësit e saj. Të jesh mësues i shkollës fillore është përgjegjësi e madhe që do të thotë të zbatosh të gjitha metodat, strategjitë dhe njohuritë nga të cilat do të përfitojnë nxënësit. Gjithmonë duhet pasur parasysh se përgatitja e mësuesve duhet të shikohet nga një këndvështrim më i gjerë duke përfshirë cilësinë e përgatitjes fillestare të mësuesve, kontekstin e shkollës dhe mënyrën se si është organizuar shkollimi. Meqë përmendëm më sipër sfidat nëpër të cilat ka kaluar sistemi ynë arsimor dhe zhvillimin profesional të mësimitdhënësve ende kemi shumë punë për të bërë që mësimitdhënësi të jetë sa më praktik dhe kreativ me klasën në të cilën punon.

Meqë fokusi i qëllimit të këtij studimi janë detyrat e shtëpisë në Kosovë, mësimitdhënësit nuk janë të përgatitur profesionalisht aq sa duhet me praktikimin e detyrave të shtëpisë. Edhe në këtë drejtim, mësimitdhënësve u nevojitet përgatitje më e mirë, pasi ende ekzistojnë botëkuptime të ndryshme për praktikimin e detyrave të shtëpisë në vendin tonë. Derisa në sistemin tonë arsimor praktikojmë detyrat e shtëpisë, nevoja për përgatitjen e mësimitdhënësve për këtë praktikë është më se e domosdoshme.

Në shkollat tona mungon një plan strategjik apo standard se si mësimitdhënësit t'i praktikojnë detyrat e shtëpisë. Derisa problemi qëndron në mungesën e një plani strategjik për zbatimin e detyrave të shtëpisë dhe mungesën e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në këtë aspekt mund të kemi edhe probleme të thella rreth menaxhimit të detyrave të shtëpisë në shkollat tona. Gjatë analizimit të dokumenteve të ndryshme nga Ministria e Arsimit nuk hasim në ndonjë udhëzim ose dokument specifik rreth udhëzimit të planifikimit të detyrave të shtëpisë. Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e nxënësve sipas Kornizës së Kurikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së

Kosovës (2016), një prej formave të vlerësimit formativ realizohet edhe përmes angazhimit të nxënësve në detyra të shtëpisë, por assesi nuk përmendet lloji i detyrave të shtëpisë apo edhe qëllimi i dhënies së detyrave të shtëpisë.

Sipas KEEN (2018), për vlerësimin e gjendjes së arsimit në nëntë komunat e Kosovës, përfshirë edhe Prishtinën, në të cilin është përzgjedhur një mostër mjaft e madhe nga nëntë komunat e përfshira në hulumtim, të pyetur se cilat metoda të reja të vlerësimit i përdorin mësuesit klasorë dhe lëndorë kanë treguar se përdorin metoda të ndryshme, si: ushtrimet dhe detyrat në klasë, detyrat e shtëpisë, esetë, punimet e projektet, punën në grupe, etj. Nga 79 mësuesit klasorë, 11.4 % tregojnë se japin detyra të shtëpisë me qëllim të vlerësimit të nxënësve, ndërsa nga 467 mësuesit lëndorë, 7.3% e tyre japin detyra të shtëpisë si metodë për vlerësimin e nxënësve. Përderisa në vendin tonë nxënësit janë të angazhuar në detyra të shtëpisë, shtrohen pyetjet: *Sa janë efektive detyrat e shtëpisë që punojnë nxënësit? Si dhe sa janë prindërit të përgatitur për t'iu ofruar ndihmë fëmijëve në punimin e detyrave të shtëpisë?*

Në vitin 2010, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), prezantoi disa të dhëna të rëndësishme nga hulumtimi për këndvështrimin e prindërve për pjesëmarrje në jetën e shkollës në Kosovë. Sipas këtij hulumtimi, drejtorët e shkollave thonë se shkolla nuk i ka udhëzuar prindërit me informata të nevojshme se si ata duhet të ndihmojnë fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë, por sipas tyre prindërit nuk e kanë kërkuar një gjë të tillë. Në anën tjetër, shumica e prindërve (rreth 65% e tyre), kanë thënë se gjatë vitit të kaluar, shkolla asnjëherë nuk ka kërkuar mendim për çështjet arsimore, si: përmbajtjet e leksioneve, tekstet e ndryshme, ngarkesa mësimore e nxënësit dhe detyrat e shtëpisë (KEC, 2010). Në këtë punim theksohet se në shumicën e rasteve fëmijët ndihmohen nga nëna ose babai për përfundimin e detyrave të shtëpisë.

Sipas një doracakut të përgatitur nga KEC (Qendra për Arsim e Kosovës) për planin zhvillimor të shkollës, prindërve dhe nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të kontribuojnë në planin zhvillimor të shkollës e me theks të veçantë në politikat që lidhen me detyrat e shtëpisë (KEC, 2010, fq. 9). Nëse shkollat nuk kanë politikë ose strategji për detyrat e shtëpisë, duhet të diskutohet me mësuesit dhe administratorët e tjerë. Politikat për detyrat e shtëpisë mund të ndahen dhe rishikohen me nxënësit, prindërit dhe mësuesit në fillim të çdo viti shkollor. Këto politika jo vetëm që ndihmojnë në përcaktimin e rolit të prindërve në detyrat e shtëpisë, por gjithashtu sigurojnë që nxënësit dhe prindërit të informohen për pritjet e mësuesve, prandaj nga politika e detyrave të shtëpisë përfitojnë të gjithë: mësuesit, nxënësit dhe prindërit (Brewster & Fager, 2000).

Zhvillimi i politikës së mirëfilltë për detyrat e shtëpisë është përfitim dhe mënyrë e mirë për të bashkëpunuar mësuesit në mes vete për rishikimin se si detyrat e shtëpisë mund të jenë më së miri të formuluar dhe të dhëna duke marrë parasysh faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të

shtëpisë. Andaj, në kontekstin tonë, detyrat jepen sipas dëshirës dhe si rrjedhojë mungon edhe një varg standardesh të rëndësishme, si: qëllimi i dhënies së detyrave të shtëpisë, përcaktimi i vëllimit dhe sasisë së detyrave të shtëpisë si dhe dhënia e informatës dhe vlerësimi kthyes nga mësuesi/ja pasi nxënësi përfundon detyrat e shtëpisë.

Mësuesit kanë një punë të jashtëzakonshme për të kryer çdo ditë në klasë dhe caktimi i detyrave të shtëpisë është pjesë e asaj pune (Tokarski, 2011). Detyrat e shtëpisë duhet të jenë mirë të planifikuara nga mësuesi dhe gjithmonë të kenë një qëllim të caktuar. Intervistat me mësues, prindër dhe nxënës, shpalosin sfida dhe probleme të shumta në sistemin e menaxhimit të detyrave të shtëpisë në shkollat tona. Fillimisht, mungon një plan strategjik nga shkolla për dhënien e detyrave të shtëpisë e mandej edhe përgatitja e mësuesve për detyra të shtëpisë. Sipas Epstein & Voorhis (2001), mund të përcaktohet nga drejtorët e shkollave apo ekipet arsimore për kohën që nxënësit duhet të jenë të ngarkuar me detyra të shtëpisë (siç është cituar në Peltier, 2011). Nxënësit në shkolla tona janë shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë si pasojë e mungesës së një plani strategjik nga shkolla dhe si rezultat i mos përgatitjes së mësuesve për dhënien e detyrave të shtëpisë.

1.5. Qëllimi dhe pyetjet e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është të identifikojë faktorët që ndikojnë te mësimitdhënësit për mënyrën se si i menaxhojnë detyrat e shtëpisë si dhe sfidat me të cilat përballen gjatë këtij procesi. Gjithashtu, studimi ka për qëllim të zbulojë se si ndërlidhen veçoritë personale (mosha, gjinia) e profesionale (përvoja e punës, zhvillimi profesional, ndjekja e trajnimeve) të mësimitdhënësit me perceptimin dhe praktikën e detyrave efektive të shtëpisë.

Për më tepër, studimi synon të shqyrtojë perceptimet e mësimitdhënësve, prindërve dhe nxënësve për qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë si dhe mënyrën e përdorimit të informatës e vlerësimit kthyes në këto detyra. Po ashtu, hulumtimi ka për qëllim të evidentojë kohën që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë si dhe llojet e detyrave të shtëpisë që ata punojnë. Theks i veçantë i këtij studimi është edhe roli i bashkëpunimit mes prindërve dhe mësimitdhënësve lidhur me detyrat e shtëpisë.

Ky hulumtim synon t'i përgjigjet pyetjes kryesore të hulumtimit, si në vijim:

- Cilët faktorë përcaktojnë efektivitetin e zbatimit të detyrave të shtëpisë në procesin mësimor?

Ky hulumtim mbështetet gjithashtu në nënpyetjet që dalin nga pyetja kryesore kërkimore, siç janë:

- 1. Cilat janë sfidat kryesore që kanë mësimitdhënësit për integrimin e detyrave të shtëpisë si pjesë e praktikës së zakonshme?*
- 2. Cila është qasja e mësimitdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë?*
- 3. Si shpjegohet praktika e mësimitdhënësve në menaxhimin e detyrave të shtëpisë krahas veçorive profesionale dhe personale?*
- 4. Cilat janë perceptimet e nxënësve për detyrat e shtëpisë?*
- 5. Si e shohin prindërit rolin e detyrave të shtëpisë dhe rolin e tyre në këtë proces?*

1.6. Struktura e kapitujve

Në *Kapitullin e I-rë*, paraqitet hyrja si dhe korniza teorike e studimit, e cila fillon me Teorinë e Konstruktivizmit si kornizë mbështetëse e studimit dhe gjashtë parimet e saj që tregojnë lidhjen e konstruktivizmit me detyrat e shtëpisë dhe teorinë e aktivitetit të sistemeve që ndihmon në identifikimin e faktorëve në menaxhimin efektiv të detyrave të shtëpisë. Kapitulli vazhdon me arsyetimin e hulumtimit për detyrat e shtëpisë, konteksti i Kosovës lidhur me detyrat e shtëpisë, qëllimi dhe pyetjet e hulumtimit si dhe sqarimi i koncepteve kryesore të studimit.

Në *Kapitullin e II-të*, paraqitet një përmbledhje e hollësishme e rishikimit të literaturës duke u mbështetur në kërkimet që janë botuar në lidhje me detyrat e shtëpisë. Në këtë kapitull përfshihen informata të rëndësishme për historikun e detyrave të shtëpisë nëpër periudha të ndryshme duke përfshirë edhe mendimet pro dhe kundër detyrave të shtëpisë nga hulumtues të ndryshëm. Në përfundim të këtij kapitulli janë të paraqitura konceptet kryesore që lidhen me detyrat e shtëpisë, si: qëllimi i detyrave të shtëpisë; zbatimi efektiv i detyrave të shtëpisë; dhënia e udhëzimeve e ofrimi i informatave kthyesë për nxënës; koha që shpenzojnë nxënësit në detyra dhe përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë.

Në *Kapitullin e III-të*, paraqitet metodologjia e studimit, e cila fillon me përshkrimin e dizajnit të studimit, metodat e përzgjedhura, mënyrën e përzgjedhjes së mostrës, procesin e pilotimit, mënyrën e mbledhjes së të dhënave si dhe karakteristikat demografike të pjesëmarrësve. Po ashtu, kapitulli jep të dhëna të rëndësishme për instrumentet e përdorura në studim, për përcaktimin e nivelit të besueshmërisë për instrumentin e përdorur në hulumtim, testet statistikore të përdorura në analizën e të dhënave, mënyrën e transkriptimit, kodimit dhe nxjerrjes së temave që lidhen me pyetjet e hulumtimit dhe në fund aspektin etik.

Në *Kapitullin e IV-të*, paraqiten në mënyrë të detajuar rezultatet e hulumtimit. Duke u bazuar në testin e normalitetit janë caktuar edhe testet statistikore të cilat janë të përshtatshme për analizimin e pyetjeve kërkimore. Pasi studimi implikon qasje mikse, në këtë kapitull janë të paraqitura edhe kodet e temat e dala nga intervistat me respondentët e studimit.

Në *Kapitullin e V-të*, paraqiten diskutimet lidhur me pyetjet e hulumtimit si dhe gjetjet e studimeve të tjera relevante që kanë trajtuar problematikën e detyrave të shtëpisë. Në këtë kapitull paraqiten edhe përfundimet lidhur me efektivitetin e detyrave të shtëpisë.

Në *Kapitullin e VI-të*, paraqiten kufizimet e studimit si dhe rekomandimet për hulumtimet në të ardhmen lidhur me detyrat e shtëpisë.

Në *Kapitullin e VII-të*, paraqiten burimet e përdorura në studim.

Në *Kapitullin e VIII-të*, përfshihen të dhënat e rëndësishme për instrumentet e përdorura në hulumtim dhe çështje të tjera që janë të rëndësishme për studimin.

KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në këtë kapitull paraqitet një shqyrtim me i thellë i materialeve, artikujve në revista të ndryshme shkencore, ueb faqeve që lidhen me fushën e mësimdhënies si dhe librave të ndryshëm që lidhen me temën e hulumtimit. Për më shumë, në kontekstin tonë deri më tani nuk kemi hasur artikuj apo hulumtime të shumta që lidhen me detyrat e shtëpisë. Në këtë kapitull fillohet me çështje të rëndësishme për historikun e detyrave të shtëpisë si dhe me diskutime që janë për dhe kundër detyrave të shtëpisë. Kapitulli përfundohet me pjesën më të rëndësishme të studimit duke pasqyruar informacione për detyrat e shtëpisë që lidhen me faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë.

2.1. *Historiku i detyrave të shtëpisë*

Detyrat e shtëpisë janë pjesë e rëndësishme e mësimdhënies. Ato janë pjesë integrale e punës mësimore të nxënësit, mësimdhënies, zgjerimit dhe plotësimit të njohurive të nxënësve. Detyrat e shtëpisë konsiderohen si urë lidhëse në mes të shkollës dhe shtëpisë. Për më shumë se 100 vjet ende vazhdon debati për rëndësinë e detyrave të shtëpisë. Shumë studiues, mësues dhe prindër kanë mendime të ndryshme për caktimin e detyrave të shtëpisë nga mësimdhënësi. Sikurse shumë metoda dhe strategji të tjera në fushën e arsimit edhe detyrat e shtëpisë janë konsideruar të dobishme e nganjëherë të padobishme.

Artikujt e përzgjedhur nga Dr. Harris Cooper ishin një ndihmë e madhe për rishikimin e literaturës. Dr. Harris Cooper, profesor i psikologjisë dhe drejtor i Programit të Dukës në Arsim, ka studiuar detyrat e shtëpisë më shumë se 20 vjet. Studiuesit e Dukës kanë studiuar më shumë se 60 studime kërkimore për detyrat e shtëpisë në mes viteve 1987 dhe 2003 dhe kanë konkluduar se detyrat e shtëpisë kanë një efekt pozitiv në arritjet e nxënësve.

Ka pasur një debat të vazhdueshëm për rëndësinë e detyrave të shtëpisë. Përkrahësit dhe kritikët janë intensivisht të apasionuar pas qëndrimeve të tyre, ndonjëherë duke shkuar deri aty sa të akuzojnë njëri – tjetrin. Disa i konsideruan detyrat e shtëpisë si një shejtan, grupi që ishte kundër detyrave të shtëpisë ndërsa të tjerët i konsideruan detyrat e shtëpisë si një shpëtimtar, grupi që ishte për detyra të shtëpisë (Landing - Corretjer, 2009). Cooper përcakton detyrat e shtëpisë si "detyra të caktuara për nxënësit nga mësuesit e shkollës fillore që janë menduar të kryhen gjatë orëve jo shkollore" (Cooper, 1989). Ky përkufizim përjashton a) studimin e drejtuar në shkollë, b) kurset e studimit në shtëpi, dhe c) aktivitetet jashtëshkollore, siç janë gazetave sportive ose studentore.

Ndryshimet ekstreme në teknologji dhe në sistemin arsimor kanë sfiduar çdo përkufizim të detyrave të shtëpisë. Prandaj, në ditët e sotme studiues të ndryshëm japin përkufizime të ndryshme për detyrat e shtëpisë.

Një studiuës tjetër i detyrave të shtëpisë është Lyn Corno i cili në një intervistë që është realizuar nga Bembenuy në vitin 2009, përcakton detyrat e shtëpisë si punë që nxënësit zgjedhin ta bëjnë vetë në shtëpi ose si projekte afatgjate. Sipas Corno, detyrat e shtëpisë janë një proces me të cilin përfundimi i detyrave të shtëpisë depërton në dinamikën e familjes dhe të bashkëmoshatarëve dhe ndikon në natyrën e mësimdhënies në organizatat e komunitetit, si dhe në shkolla (Bembenuy, 2009, fq.142). Detyrat e shtëpisë përgatitin fëmijën për jetë. Fëmija ka përgjegjësi dhe duhet të disiplinohet që t'i bëjë gjërat. Ai e mëson fëmijën të mendojë vetë, është një gur themeli për arsimin e ardhshëm dhe si funksionon sistemi. Për të marrë nota të mira dhe për t'u futur në Universitet, ata duhet të punojnë (fq.183). Detyrat e shtëpisë u lejojnë nxënësve të jenë aktiv dhe pjesëmarrës në mësimin e tyre me familjet e tyre. Ato u lejojnë fleksibilitet pasi nxënësit individualisht mund t'u drejtohen detyrave të shtëpisë duke përdorur mënyrat e tyre të preferuara për të përfunduar detyrat. Për më tepër, detyrat e përcaktuara nga mësuesit në klasë duhet të lidhen ngushtë me kurrikulën (Iflazoğlu et al., 2012, fq.58).

Shumica e hulumtimeve për detyrat e shtëpisë janë përqendruar në krahasimin e arritjeve në mes të nxënësve të cilët kanë punuar detyra të shtëpisë dhe atyre që nuk kanë punuar detyra të shtëpisë, marrëdhënies që nxënësit kalojnë kohë në detyra të shtëpisë dhe arritjeve të tyre. Për 16 vite Cooper at al hulumtoi për lidhjen e detyrave të shtëpisë me arritjet e nxënësve. Nga 32 dokumente që kishte hulumtimiti kishte 69 lidhje midis detyrave të shtëpisë dhe arritjeve të nxënësve, ku 50 prej tyre kishin treguar efekte pozitive ndërsa 19 prej tyre kishin treguar efekte negative (Cooper et al., 2006). Një tjetër fokus i studimit të detyrave të shtëpisë ishte sasia e stresit, ankthit dhe shqetësimit të përvojës së nxënësve për shkak të detyrave të shtëpisë (Hallam, 2006; Volley, 2017). Sipas Xu (2013), kryerja e detyrave të shtëpisë paraqet sfida të shumta për nxënësit, madje edhe për ata nxënësit që i shohin detyrat e tyre të rëndësishme dhe interesante.

2.2. Diskutime për detyra të shtëpisë dhe kundër detyrave të shtëpisë

Vitet e fundit ka pasur shumë diskutime për dobinë e detyrave të shtëpisë. Disa studiuës kanë qenë në favor të dhënies së detyrave të shtëpisë dhe disa të tjerë kundër detyrave. Ata kanë pasur disa dyshime në lidhje me efektivitetin që kanë detyrat e shtëpisë. Disa mësimdhënës kanë sugjeruar një listë të gjatë si të efekteve pozitive ashtu edhe të efekteve negative të detyrave të shtëpisë (Cooper, 1989; Epstein, 1988; Warton, 2001). Kështu, në tabelën 1 të dhënë më poshtë është paraqitur një listë e efekteve pozitive dhe negative e detyrave të shtëpisë. Lista është e gjatë dhe shpesh befasuese.

Disa mësues dhe prindër kanë treguar që detyrat e shtëpisë për fëmijët e tyre kanë pasur disa efekte negative. Ata shqetësohen se detyrat e shtëpisë mund t'i bëjnë nxënësit të ndjehen të kënaqur me informacionin akademik dhe për këtë arsye ata sugjerojnë që çdo aktivitet të mbetet si shpërblim për

ndonjë afat më të gjatë. Nëse nxënësve u kërkohet të kalojnë shumë kohë në detyra të shtëpisë, ata do të mërziten. Për më tepër, disa prindër të tjerë mendojnë që detyrat e shtëpisë mohojnë kohën e lirë dhe aktivitetet e komunitetit. Fëmijët duhet të pushojnë gjatë ditëve të pushimit pasi dhënia e detyrave të shtëpisë gjatë këtyre ditëve shkakton lodhje. Një tjetër problem është se përfshirja e prindërve shpesh mund të shndërrohet në ndërhyrje prindërore. Për shembull, prindërit mund t'i ngatërrojnë nxënësit nëse teknikat mësimore që ata përdorin ndryshojnë nga teknikat e përdorura nga mësuesit (Cooper et al., 2006; Ozer & Keskin, 2015).

Tabela 1. Efektet e detyrave të shtëpisë (Cooper 2001, 2006)

Efektet pozitive	Efektet negative
<p>Arritje e menjëhershme dhe të mësuarit</p> <p>Mbajtja më e mirë e njohurive faktike</p> <p>Kuptim i shtuar</p> <p>Mendimi më i mirë kritik, koncepti, formimi, përpunimi i informacionit</p> <p>Pasurimi i kurrikulës</p> <p>Akademik afatgjatë</p> <p>Mësim i inkurajuar gjatë kohës së lirë</p> <p>Qëndrim i përmirësuar ndaj shkollës</p> <p>Studim më i mirë dhe aftësi</p> <p>Jo mësimore</p> <p>Vetëdrejtim më i madh</p> <p>Vetëdisiplinë më e madhe</p> <p>Organizim më i mirë në kohë</p> <p>Më shumë kureshtje</p> <p>Zgjidhja më e pavarur e problemit</p> <p>Vlerësim më i madh i prindërve për përfshirjen në shkollë</p>	<p>Ngopje</p> <p>Humbja e interesit për materialin akademik</p> <p>Lodhje fizike dhe emocionale</p> <p><i>Mohim i kohës së lirë dhe aktiviteteve në komunitet</i></p> <p>Ndërhyrja prindërore</p> <p>Presion për të përfunduar dhe për të kryer mirë detyrat</p> <p>Konfuzion i teknikave mësimore</p> <p>Kopjimi</p> <p>Kopjimi nga nxënësit e tjerë</p>

Qasja e prindit ndonjëherë mund të jetë edhe e gabuar. Për shkak të ngarkesës së punës apo nivelit të shkollimit të prindërve ndihma që ata mund t'u ofrojnë fëmijëve të tyre në detyra të shtëpisë mund të jetë jo e përshtatshme gjë e cila mund të shkaktojë stres dhe ngarkesë te fëmijët.

Sipas Kohn (2006), hulumtimet për detyrat e shtëpisë kanë treguar që detyrat e shtëpisë nuk kanë shumë vlerë. Autori thekson se nxënësit ngarkohen me detyra të shtëpisë, ka konflikte që

shkaktohen në familje si pasojë e ngarkesës së tepruar me detyra të shtëpisë si dhe pamundësisë së fëmijëve për të zhvilluar aktivitete të lira për shkak të angazhimit në detyra të shtëpisë. Në fund të fundit, disa kundërshtarë madje shkojnë aq larg sa të hipotizojnë se detyrat e shtëpisë inkurajojnë mashtrimin përmes kopjimit të detyrave (Beutlich, 2008, f.11). Kopjimi i detyrave të shtëpisë është një dukuri negative që ndodh shpesh herë te fëmijët, por ndonjëherë shkon edhe përtej kësaj kur edhe vetë prindërit bëjnë detyrat e shtëpisë për fëmijët e tyre.

Pavarësisht këtij kundërshtimi, dhënia e detyrave të shtëpisë tregon se ka më shumë rezultate pozitive se sa negative. Efektet pozitive të detyrave të shtëpisë mund të përmirësojnë aftësitë e studimit të nxënësve dhe qëndrimet ndaj shkollës dhe t'u mësohet nxënësve që mësimi mund të zhvillohet brenda dhe jashtë shkollës. Fëmijëve duhet ta kuptojnë se mësimi zhvillohet kudo. Baş et al. (2017) kryen një studim sasior të metaanalizës në Turqi për të përcaktuar efektin e detyrave të shtëpisë në nivelet e arritjeve. Ata zbuluan se në arsimin fillor, detyrat e shtëpisë kanë më pak efekt në arritjet akademike të nxënësve. Megjithatë përmes detyrave të shtëpisë nxënësit përforcojnë edhe më shumë informatat e mësuara në klasë, pasurojnë ato informata me informacione shtesë duke zhvilluar edhe me shumë të menduarit e thellë kritik.

Efekte të tjera të rëndësishme që përfshijnë shumë përfitime të mundshme jo akademike janë që shumica prej tyre promovojnë tipare të karakterit të pavarur dhe të përgjegjshëm të nxënësve. Përveç kësaj nxënësit krijojnë vetëdisiplinë më të madhe për veten e tyre duke organizuar edhe më mirë kohën për të punuar detyrat e shtëpisë. Qysh në këtë kohë nxënësit fillojnë të bëhen edhe më shumë kureshtarë për të mësuar gjëra të reja.

Përfshirja e prindërve është efekti i fundit që shpjegohet nga Cooper në listën e mësipërme (Tabela 1). Përfshirja e tyre mund të ketë efekte pozitive gjithashtu, sepse mësuesit mund të përdorin detyrat e shtëpisë që prindërit të jenë pjesë e klasës dhe veprimtarisë së tyre.

Rasti **Për** dhe **Kundër** detyrave të shtëpisë nga Marzano dhe Pickering (2007), thotë se mësuesit nuk duhet të braktisin detyrat e shtëpisë. Përkundrazi, ata duhet të përmirësojnë cilësinë e detyrave. Në betejën për detyrat e shtëpisë (2007), Cooperi vuri në dukje se detyrat e shtëpisë duhet të kenë qëllime të ndryshme në nivele të ndryshme të klasave. Për nxënësit në klasat e mëhershme, mësuesi duhet të nxisë qëndrime, zakone dhe tipare pozitive. Prindërve t'u lejohet përfshirja e duhur dhe të përforcojnë mësimin e aftësive të thjeshta të prezantuara në klasë. Për nxënësit në klasat e larta fillore duhet të luajë një rol më të drejtpërdrejtë në nxitjen e arritjeve të përmirësuara në shkollë. Në klasën e gjashtë dhe më gjerë, duhet të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e notave. Sipas Corno (2000), një rol unik për detyrat e shtëpisë në një epokë moderne është të sigurohet komunikimi shoqëror dhe kontaktet mes bashkëmoshatarëve, sidomos moshatarëve që jetojnë përtej shkollës së lagjes, duke rritur kështu një ndjenjë të komunitetit (siç është cituar në Bembenutty, 2009).

Pavarësisht efekteve negative të shqyrtuara më lart, është absolutisht e nevojshme që fëmijët të kenë detyra shtëpie, por duhet të tregohet më shumë kujdes në përzgjedhjen e detyrave të shtëpisë, e cila duhet të nxisë kuriozitetin te fëmija si dhe kohën që duhet të kalojë një fëmijë për të bërë detyrat. Prindërit dhe mësuesit besojnë se detyrat e shtëpisë zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë. Një studim australian sugjeron që fëmijët mund të pranojnë rritjen e përgjegjësisë duke bërë detyrat e shtëpisë (Warton, 1997), ndërsa hulumtime të tjera sugjerojnë që fëmijët sa më të vegjël janë, mund të zhvillojnë strategji të detyrave të shtëpisë (siç është cituar tek Hallam, 2014).

McNulty (2018) konkludon se edhe pse shumica e fëmijëve nuk pëlqejnë të bëjnë detyrat e shtëpisë, ata e vlerësojnë atë si një mjet për të rritur të mësuarit dhe zhvillimin personal të tyre. Në një hulumtim për detyrat e shtëpisë, autorët theksojnë se rolet e mësuesve dhe prindërve, sasia dhe kohëzgjatja e detyrave të shtëpisë, përshtatshmëria për nivelin e zhvillimit të nxënësve, udhëzimet dhe informatat kthyesë për nxënësit, duhet të merren parasysh kur vlerësohen efektet e detyrave të shtëpisë në aspektin akademik (Baş & Cığerci, 2017).

Autori ka të drejtë kur thotë se detyrat e shtëpisë janë një praktikë unike arsimore pasi secili fëmijë nuk ka të njëjtën përvojë me detyrat e shtëpisë, prandaj praktikimi i detyrave të shtëpisë është mjaft sfidues dhe shumë kompleks duke pasur parasysh kufirin në mes të botës së shkollës dhe botës së shtëpisë (Vatterott, 2018).

2.3. Qëllimi i detyrave të shtëpisë

Studiuesit (Cooper, 2001; Epstein & Voorhis, 2001; Fawzy, 2012; Hoeke, 2017; Minke, 2017; Stogner, 2014; Voorhis, 2004) sugjerojnë se kur planifikojmë detyra të shtëpisë, duhet të kemi parasysh: qëllimin e detyrave të shtëpisë; zbatimin efektiv të detyrave të shtëpisë; dhënien e udhëzimeve, ofrimin e informatave kthyesë për nxënës; kohën që shpenzojnë nxënësit në detyra, llojet e detyrave të shtëpisë dhe përfshirjen e prindërve në detyrat e shtëpisë (shih. Figurën 3).




Figura 3. Faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë

Faktori më i rëndësishëm që ndikon në cilësinë e detyrave të shtëpisë padyshim që është qëllimi i detyrave të shtëpisë. Është shumë e rëndësishme kur mësimitdhënësi ka një qëllim të caktuar gjatë planifikimit të detyrave të shtëpisë për nxënësit. Detyrat e shtëpisë të hartuara mirë, me qëllim të qartë kanë mundësi për të rritur të mësuarit dhe zhvillimin e fëmijës. Qëllimi i detyrave të shtëpisë do të thotë që të gjitha detyrat e shtëpisë kanë kuptim. Mësimitdhënësit duhet t'iu japin nxënësve detyra që janë të qëllimshme për ta dhe të jenë të përshtatshme për stilet e tyre të të mësuarit. Mësimitdhënësit nuk duhet t'iu japin nxënësve detyra sa për t'iu dhënë, por vetëm kur ka një qëllim specifik. Caktimi i detyrave të shumta nuk është produktiv (Carr, 2013; Hoeke, 2017).

Qëllimet e detyrave të shtëpisë sipas mësimitdhënësve janë ato që shërbejnë për një funksion mësuesor: praktikë, përgatitje për orën tjetër, pjesëmarrje në mësim dhe zhvillim profesional.

Këto detyra mund të ofrojnë shumë mundësi për nxënësit që ata të mësojnë edhe në shtëpi duke paraqitur njohuritë dhe aftësitë e tyre në forma të ndryshme. Shpesh edhe në klasë disa nxënës flasin më shumë e disa të tjerë heshtin ose fare nuk iu dëgjohe zëri. Përmes detyrave të shtëpisë, secili nxënës ka mundësi që të marrë pjesë individualisht dhe të demonstrojë të kuptuarit e mësimit sipas aftësive të veta. Përveç kësaj, qëllimi i detyrave të shtëpisë duhet të jetë lehtësimi i mëtejshëm i mësimit, zhvillimi i aftësive organizative, nxënësit të bëhen të disiplinuar dhe të pavarur (Hancock, 2001; Voorhis, 2004). Cooper et al. (2006) treguan se qëllimet e detyrave të shtëpisë mund të klasifikohen në dy kategori të gjera, mësimore dhe jo mësimore. Kategoria mësimore përfshin rishikimin, praktikën, përgatitjen, zgjerimin dhe integrimin. Nga ana tjetër, kategoria jomësimore përfshin komunikimin midis prindit dhe fëmijës duke përbushur direktivat nga administratorët e shkollave, marrëdhëniet me publikun dhe ndëshkimin e nxënësve (Fawzy, 2012). Edhe në studimin e realizuar nga Baş et al. (2017), qëllimi i detyrave të shtëpisë është klasifikuar në dy kategori duke u bazuar në hulumtimet e shumë autorëve, të cilat paraqiten si qëllime të shumta që mësimdhënësit japin detyra të shtëpisë. Këto qëllime janë të klasifikuara në dy kategori si qëllime udhëzuese dhe qëllime jo udhëzuese.

Hulumtues të ndryshëm tregojnë se ka shumë arsye që mësuesit japin detyra të shtëpisë. Ata përshkruajnë 10 qëllime për dhënien e detyrave të shtëpisë: praktikë, përgatitje, pjesëmarrje, zhvillim personal, marrëdhënie prind – fëmijë, komunikimi prind – mësues, bashkëveprimet e kolegëve, politika, marrëdhëniet me publikun dhe dënimi (Epstein & Voorhis, 2001). Të gjitha këto qëllime duhet të jenë të ndërlidhura në mes vete me qëllim që të përfshijnë secilin nxënës në mësim, të rrisin përgjegjësin për punë, të menaxhojnë kohën dhe mbi të gjitha të fitojnë vetëbesim në punën që bëjnë gjatë punimit të detyrave. Megjithatë gjatë dizajnit të detyrave të shtëpisë nuk do të thotë se këto detyra duhet të përbushin të gjitha qëllimet. Kjo do të thotë se detyra mund të përbushë një qëllim ose disa qëllime. Disa mësues mund të caktojnë detyra të shtëpisë për t'i ndihmuar nxënësit të mësojnë, të fitojnë shprehje të punës e në të njëjtën kohë përgjegjësi për detyrën e dhënë, të menaxhojnë kohën, të fitojnë vetëbesim, etj.

Sa i përket dënimit si një nga qëllimet e lartpërmendura, historikisht disa mësues kanë përdorur detyrat e shtëpisë si mjet ndëshkues e fatkeqësisht ende vazhdon të përdoret në disa vende një gjë e tillë. Mënyra e përdorimit të detyrave të shtëpisë si ndëshkim është mjaft e gabuar përveç që iriton nxënësit për të mësuar në shtëpi, ka edhe shumë pasoja të tjera që nuk janë aspak të dobishme për zhvillimin personal të secilit fëmijë. Detyrat e shtëpisë gjithmonë duhet të sjellin kënaqësi të fëmijët e asnjëherë të përdoren si mjet ndëshkimi pasi efekti i tyre do të ketë pasoja negative për secilin nxënës pa dallim moshe, gjinie, apo niveli të njohurive.

Në anën tjetër, Hoeke (2017) pohon se mësimdhënësit i caktojnë detyrat e shtëpisë për katër arsye: mësuesit konsiderojnë se praktika e aftësive është e dobishme për nxënësit, prindërit i duan

detyrat e shtëpisë, shoqëria pret që nxënësit të kenë detyra të shtëpisë dhe mendon se detyrat e shtëpisë e dispijnojnë nxënësin duke e ngarkuar atë me përgjegjësi. Në një tjetër studim nga të dhënat e përbashkëta nga prindërit dhe mësimdhënësit u konkludua se detyrat e shtëpisë duhet dhënë për të përmirësuar performancën akademike të nxënësit gjë e cila realizohet duke dhënë informatë kthyese vazhdimisht në mënyrë që ata të përmirësohen aty ku kanë nevojë (Marcum, 2018). Notat e përmirësuar, rezultatet e testeve dhe të mësuarit nuk janë qëllimet e vetme të detyrave të shtëpisë. Mësuesit duhet të bëjnë shumë kujdes në caktimin e qëllimeve të detyrave të shtëpisë. Qëllimet duhet të jenë të arritshme dhe të përshtatshme për moshën e nxënësve. Nëse mësuesit japin shumë detyra nxënësit do të zhgënjehen dhe do të stresohen se si do t'i përfundojnë ato (Baher, 2017; Huisman, 2016).

Pothuajse nga të gjithë hulumtuesit e lartcekur po përmendet edhe zhvillimi personal si një qëllim i rëndësishëm në detyrat e shtëpisë. Përmes këtij zhvillimi, nxënësit duhet të vetëdijesohen se ata janë përgjegjës për të përfunduar detyrat e shtëpisë, prandaj nuk duhet që mësuesit apo prindërit në vazhdimësi të kujdesen apo edhe t'ua kujtojnë atyre që të përfundojnë detyrat e shtëpisë në shtëpi. Qëllimi i detyrave të shtëpisë duhet të jetë sa më shumë praktik, që nxënësit t'i zbatojnë në jetën e përditshme pasi në të kundërtën ata nuk do të kenë motiv për t'i punuar ato. Është shumë më rëndësi kur mësimdhënësi cakton detyra të shtëpisë të ketë parasysh edhe interesin e fëmijëve për temën që u pëlqen. Nëse nxënësit kanë punë hulumtuese për një temë të caktuar ose një shkrim të lirë, t'u lejohet atyre që vetë të zgjedhin për temën që kanë më shumë interes pasi kur ata e bëjnë një zgjedhje të tillë do të angazhohen më shumë për të përfunduar detyrat e shtëpisë dhe ato detyra do t'i punojnë me shumë kënaqësi. Sipas Voorhis (2004) çelësi i suksesit në detyrat e shtëpisë është kur mësimdhënësi bën kujdes në qëllimin e detyrave të shtëpisë, sasinë e detyrave si dhe komunikimin e mirëfilltë në mës të shkollës dhe familjes. Përveç kësaj një rëndësi shumë të madhe për efektivitetin e detyrave të shtëpisë është kur fëmijët informohen për qëllimin dhe përfitimin prej detyrave të shtëpisë. Atyre duhet t'u shpjegohet për rolin e detyrave të shtëpisë në mënyrë që të ndërgjegjësohen pse mësimdhënësit japin detyra të shtëpisë (Xu, 2011). Është shumë më rëndësi kur qëllimi i detyrave të shtëpisë kuptohet qartë nga të gjithë personat, të cilët kanë lidhje me detyrat e shtëpisë, qofshin mësimdhënësi, nxënës apo edhe prindër.

2.4. Efektiviteti i detyrave të shtëpisë

Përveç qëllimit të detyrave të shtëpisë, efektiviteti i detyrave të shtëpisë varet edhe nga shumë faktorë të tjerë, prandaj është e rëndësishme për mësuesin të dinë se cilët faktorë i ndihmojnë nxënësit në kryerjen efektive të detyrave të shtëpisë. Ka faktorë të jashtëm që kontribuojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë dhe në rritjen e suksesit të nxënësve. Dy nga faktorët janë motivimi i nxënësve dhe përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë. Përveç kësaj, ekzistojnë tri lloje të detyrave të shtëpisë që nxisin motivimin e nxënësve dhe përfshirjen e prindërve. Ato janë: detyrat interpersonale, detyrat interaktive dhe detyrat e bazuara në projekte (Beutlich, 2008).

Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë është një urë lidhëse mes nxënësve, prindërve dhe shkollave, gjë që e përbën një trekëndësh të rëndësishëm. Scott-Jones (1995) identifikon katër mënyra se si prindërit mund të përfshihen me fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë duke vlerësuar, monitoruar, ndihmuar dhe duke bërë detyrat e shtëpisë (Epstein & Voorhis, 2001, fq.6). Në një artikull ku diskutohet për elementet kryesore që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë dhe sugjerimeve praktike për mësuesit rreth planifikimit të detyrave të shtëpisë, autori thotë se për të rritur efektivitetin e detyrave të shtëpisë, mësuesit duhet të kuptojnë se çfarë i bën efektive detyrat e shtëpisë (Carr, 2013).

Vatterot (2010), paraqiti katër karakteristika të rëndësishme që i bëjnë detyrat e shtëpisë efektive, si: qëllimin, pronësinë, kompetencën dhe aspektin estetik. Sipas këtyre karakteristikave është shumë e rëndësishme që detyrat e shtëpisë të kenë kuptim pra të jenë të qëllimshme, efikase, të personalizuar dhe mënyra se si duket detyra e shtëpisë (estetike). Shumë nxënës në bazë të përshtypjes së parë e shikojnë një detyrë edhe vendosin për ta punuar apo jo. Shumë mirë e thënë edhe nga autori se paraqitja e detyrave të shtëpisë është e njëjtë sikur për një kuzhinier në gastronomi, i cili do të thoshte: “Prezantimi është gjithçka”. Andaj, sa më pak kërkesa të paraqitura në një fletë të detyrave të shtëpisë, të mos ketë kërkesa të mërzitshme, por të jenë detyra të kombinuara me grafikone apo ilustrime të ndryshme që i bëjnë detyrat të duken tërheqëse dhe interesante. Varësisht nga klasa në të cilën caktohen detyrat e shtëpisë duhet të bëhet me kujdes edhe paraqitja e detyrave pasi niveli i njohurive dallon nga klasa në klasë. Nëse kemi të bëjmë me detyra të klasës së parë sigurisht që detyrat duhet të kenë më shumë ilustrime dhe kërkesa mjaft të qarta pasi kemi të bëjmë me fëmijë që për herë të parë fillojnë të kenë detyra të shtëpisë. Caktimi i detyrave në klasat e tjera përsëri duhet të bëhet me kujdes pasi fëmijët vazhdimisht duhet të kenë motiv dhe kënaqësi kur marrin të punojnë detyrat e caktuara nga mësuesin. Edhe pronësia është një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në efektivitetin e detyrave të shtëpisë pasi krijohet një marrëdhënie personale midis nxënësit dhe përmbajtjes. Kur nxënësi ndihet i lidhur me përmbajtjen, ndihet më i motivuar për punim të detyrave (fq. 112).

Tabela 2. Karakteristikat e detyrave efektive (AFT)

- ✓ Siguroni udhëzime të qarta për nxënësit;
- ✓ Detyra që mund të përfundohen me sukses;
- ✓ Nuk janë shumë të gjata;
- ✓ Mund të jenë fleksibil në punimin e detyrave;
- ✓ Përdorimi i informacioneve dhe materialeve që janë lehtë të disponueshme;
- ✓ Përforconi dhe lejoni praktikimin e aftësive të mësuara më parë;
- ✓ Nuk janë detyra të papërfunduara të klasës;
- ✓ Janë interesante për nxënës dhe nxisin për hulumtim;
- ✓ Stimulojnë kreativitetin dhe imagjinatën në zbatimin e aftësive;
- ✓ Inkurajojnë nxënësit të bashkëpunojnë;
- ✓ Stimulojnë diskutimin në klasë dhe në shtëpi;

Federata Amerikane e Mësuesve (AFT), paraqet disa karakteristika që detyrat e shtëpisë i bëjnë efektive. Në tabelën e mësipërme janë të paraqitura disa karakteristika që janë shumë të rëndësishme që secili mësimit duhet të bëjë kujdes kur planifikon detyrat e shtëpisë.

Sipas AFT (2018), detyrat nuk duhet të jenë shumë të gjata gjë që krijojnë monotoni dhe marrin kohën e lirë të fëmijëve por ato duhet të jenë në raport me zhvillimin dhe moshën që posedon fëmija. Nuk është e rëndësishme sasia e detyrave të shtëpisë, por cilësia e tyre. Një gjë tjetër mjaft e rëndësishme është edhe mundësia e qasjes së nxënësve në materiale që janë të disponueshme për ta, pasi ka shumë nxënës që nuk kanë mundësi të kenë qasje në materialet e nevojshme për të përfunduar një detyrë. Ndoshta për shkak të kushteve ekonomike, nxënësit nuk posedojnë kompjuter ose internet në shtëpi, andaj kur mësimit duhet të planifikon detyra të shtëpisë duhet të bëjë kujdes në përzgjedhjen e detyrave. Kujdes i shtuar duhet të jetë që mësimit të mos japin detyra të shtëpisë të cilat kanë qenë të planifikuara të punohen në klasë e për arsye të ndryshme nxënësi nuk ka pasur mundësi t'i përfundojë në klasë, ato të vazhdojnë në shtëpi. Detyrat e shtëpisë gjithmonë duhet të jenë të planifikuara paraprakisht nga mësimit. Nëse detyrat e shtëpisë nuk janë interesante për nxënës dhe nuk nxisin hulumtim, nxënësit do të punojnë detyrat vetëm sa për të thënë se kanë punuar detyrat, prandaj detyrat të cilat nxisin hulumtim, zhvillojnë kreativitetin dhe imagjinatën i bëjnë edhe më efektive ato detyra. Detyrat duhet të nxisin edhe diskutim në klasë dhe në shtëpi. Nëse një gjë e tillë ndodh mësimit e ka arritur qëllimin e detyrave të shtëpisë. Sikurse në shtëpi edhe në klasë duhet të ndahet një pjesë e caktuar e kohës për të diskutuar lidhur me detyrat e shtëpisë. Në këtë mënyrë mësimit vëren sa nxënësit kanë pasur vështirësi ose jo në punimin e detyrave të shtëpisë (AFT, 2018, fq.41).

Një rol shumë të rëndësishëm që ndikon në efektivitetin e detyrave të shtëpisë është puna e përbashkët në mes të mësimit, nxënësit dhe prindërve. Sipas autorëve, Hong & Milgram (2000), pasi mësimit cakton detyrat e shtëpisë, prindërit duhet të sigurojnë ambientin e përshtatshëm për të punuar detyrat e shtëpisë, ndërsa nxënësit duhet të punojnë detyrat e shtëpisë sipas mënyrës që u përshtatet atyre më së miri. Për të arritur rezultate të ky bashkëpunim nga të tri palët është më se i nevojshëm. Një gjë tjetër që mësimit duhet ta ketë vazhdimisht është komunikimi i vazhdueshëm me nxënësit për dobitë dhe pasojat e tyre për kryerjen apo mos kryerjen e detyrave të shtëpisë. Qysh në fillim të vitit shkollor mësimit duhet të informojnë nxënësit lidhur me rregullat e tyre për punimin e detyrave të shtëpisë. Në këtë mënyrë, nxënësit janë të informuar për përgjegjësitë që kanë lidhur me detyrat e shtëpisë gjatë vitit shkollor.

2.5. Dhënia e udhëzimeve

Dhënia e udhëzimeve të qarta është shumë e rëndësishme kur mësimit jep detyra të shtëpisë. Sa herë që mësimit japin detyra të shtëpisë duhet të sigurohen që udhëzimet të jenë të qarta në mënyrë që mos të ketë dyshime apo gjëra të paqarta kur nxënësi fillon të punojë detyrat. Këtë e thekson edhe Schrat Carr në hulumtimin për detyrat e shtëpisë. Sipas autorit, nxënësit duhet të marrin udhëzime të kuptueshme kur fillojnë të punojnë detyrat e shtëpisë.

Sipas dokumentit të publikuar nga Hanover Research (2018), përmendet se si Federata Amerikane e Mësuesve thekson rolin e dhënies së udhëzimeve në detyrat e shtëpisë. Sipas kësaj, mësimit duhet të sigurojnë udhëzime të qarta për nxënësit. Nëse udhëzimet nuk janë të qarta, nxënësit do të ndjehen të mërzitur, të hutuar dhe nuk do të kenë interesim për kryerjen e detyrave gjë e cila i detyron ata të shtyjnë për një kohë kryerjen e tyre ose të mos punohen si duhet ato detyra (Baher, 2017).

Kur nxënësit kanë udhëzime të qarta në punimin e detyrave të shtëpisë, ata janë më të inkurajuar që t'i punojnë ato. Po ashtu dhënia e udhëzimeve të qarta në detyra të shtëpisë shkurton edhe kohën e punimit të detyrave si dhe lehtëson përfshirjen e prindit në detyra të shtëpisë. Kur nxënësi i ka të qarta dhe të kuptueshme udhëzimet për detyra, motivimi për t'i përfunduar ato nuk do t'i mungojë, andaj mësimit duhet të sigurohet që nxënësi ka kuptuar kërkesën e detyrave të shtëpisë para se të shkojë në shtëpi. Të njëjtën gjë e pohojnë edhe autorët, Hong & Milgram (2000), të cilët thonë se paraqitja e udhëzimeve të qarta ndikon në efektivitetin e detyrave të shtëpisë, pasi nëse nxënësit nuk i kanë udhëzimet e qarta, do t'i punojnë detyrat e shtëpisë në mënyrë të gabuar, nuk do t'i punojnë fare ose edhe mund të dështojnë në detyra. Koha për shpjegime shtesë për sqarimin e udhëzimeve të detyrave të shtëpisë është më së e nevojshme. Kjo gjë mbetet në fleksibilitetin e mësimit kur ai cakton kohën për të sqaruar para klasës detyrat e shtëpisë.

Nëse mësimitdhënësi e bën një gjë të tillë para se nxënësi të shkojë në shtëpi, ai do të lehtësojë punën e nxënësit dhe të prindit lidhur me kuptimin e detyrave të shtëpisë. Mësimitdhënësi duhet të inkurajojë nxënësit që pas udhëzimeve të dhëna, ata të jenë të lirë të bëjnë edhe pyetje shtesë nëse është e nevojshme lidhur me detyrat që do i kenë për t'i punuar në shtëpi. Në këtë mënyrë mësimitdhënësi do të sigurohet se nxënësi i ka të qarta udhëzimet për detyrat e shtëpisë.

Protheroe (2009) jep disa këshilla të rëndësishme për mësimitdhënësit të cilët mund të ndihmojnë fëmijët për të kuptuar qartë udhëzimet e detyrave të shtëpisë:

- Detyrat e shtëpisë të caktohen në fillim të orës mësimore;
- Të shpjegohen se si duhet të punohen detyrat e shtëpisë duke përfshirë edhe shembuj të tjerë të cilët mund të shënohen edhe në tabelë;
- Nxënësve t'u jepet mundësia të fillojnë të punojnë detyrat e shtëpisë në klasë dhe në këtë mënyrë mësimitdhënësi vëren nëse nxënësit i kanë kuptuar detyrat e shtëpisë;
- Nxënësve t'u lejohet të bashkëpunojnë me shokun apo shoqen e klasës për të diskutuar udhëzimet e detyrave të shtëpisë së bashku.

Këto këshilla mund të sigurojnë mësimitdhënësin që nxënësit i kanë të qarta udhëzimet e detyrave të shtëpisë dhe ata janë në gjendje të punojnë detyrat e shtëpisë pa ndihmën e askujt. Kështu nxënësit nuk do të kërkojnë as ndihmë nga prindërit dhe sqarime shtesë lidhur me detyrat e shtëpisë.

2.6. Informata kthyesë për detyrat e shtëpisë

“The true mark of a teacher lies in the ability to provide targeted feedback that will lead to enhanced performance.”

(Piccinin, 2003)

Një tjetër faktor i rëndësishëm që ndikon në kryerjen e detyrave ka të bëjë me informatën kthyesë nga mësuesi te nxënësi. Është shumë e rëndësishme të dihet se çfarë bëjnë mësuesit kur ata marrin detyrat e shtëpisë nga nxënësit. Në rastin më të mirë, detyrat e shtëpisë duhet të rishikohen. Autorët, Hong dhe Milgram (2000), pohojnë se detyrat e shtëpisë bëhen më të rëndësishme dhe kuptimplota kur nxënësit marrin informatë kthyesë lidhur me detyrat e shtëpisë, ndërsa sipas Protheroe (2009), shprehet se fëmijët mësojnë më shumë nga detyrat e shtëpisë kur ata marrin informatë kthyesë dhe në të njëjtën kohë diskutojnë bashkë me klasën lidhur me detyrat që kanë punuar në shtëpi. Informatat kthyesë duhet të jenë të fokusuar në korigjim të gabimeve, cilësi, fushat ku duhen zhvilluar e në veçanti te komentet motivuese për nxënësit. Duhet të kundërshtohen komentet tradicionale vlerësuese që mësuesit shpesh i përdorin, të tilla si punë e shkëlqyeshme ose punë e mirë. Sipas Nicol (2010), nxënësit shpesh raportojnë se nuk i kuptojnë informatat kthyesë me shkrim dhe se komentet nuk u ndihmojnë në sqarimin e fushave që ata nuk i kuptojnë. Megjithatë mësuesit shpesh ndihen të mbingarkuar nga detyrimi për të dhënë këto komente dhe ata shpesh e ndjejnë këtë që nuk ndihmojnë në përmirësimin e të mësuarit.

Në një studim rasti “The application of constructivist learning theory to homework practice: a case study of a trial of pencil-free approaches to home-learning in Key Stage Two Science”, studiuesi ndjen zhgënjim për mungesën e informatës kthyesë për detyra të shtëpisë. Sipas intervistave të realizuara me prindër dhe nxënës del që detyrat e shtëpisë vetëm dorëzohen mbi bankën e mësuesit dhe kaq. Sipas autorit edhe në tekstet kryesore, vlerësimi i detyrave të shtëpisë përmendet shkurtimisht dhe rekomandohen të njëjta këshilla në lidhje me informatën kthyesë (Forster, 2011).

Sipas Costa et al. (2017), detyrat e shtëpisë gjithmonë duhet të korigjohen, pasi kjo përforcon rëndësinë dhe dobinë e perceptuar të detyrave të shtëpisë nga nxënësit. Në një studim “Predicting approach to homework in Primary school students”, gjetjet tregojnë se përfshirja e prindërve dhe informata kthyesë e mësuesit për detyrat e shtëpisë e rrisin angazhimin e nxënësve për të punuar detyrat e shtëpisë (Valle et al., 2015). Sigurisht, kur prindërit mbështesin detyrat e shtëpisë e në të njëjtën kohë fëmijët marrin edhe informatë kthyesë nga mësuesi, puna e tyre vlerësohet dhe mbështetet nga të dyja palët, andaj ata janë të motivuar që t’i punojnë detyrat e shtëpisë. Çdo njeri ka dëshirë që puna e tij të vlerësohet pa marrë parasysh se çfarë forme e vlerësimit mund të jetë ajo, prandaj edhe nxënësit ndihen mirë kur puna që e bëjnë vlerësohet nga të rriturit qofshin ata mësuesi, prindërit apo

kujdestarët e tyre. Informata kthyese ka ndikim të fuqishëm në mësim dhe në të arriturat e nxënësve (Hattie & Timperley, 2007). Sipas teorisë së konstruktivizmit, informatat kthyese janë shumë të rëndësishme pasi nxënësit do të ndihen të motivuar, sepse ata e dinë se puna e tyre është vlerësuar dhe sepse u janë dhënë sqarime rreth gabimeve të bëra në mënyrë që të tregojnë rezultate më të mira në të ardhmen (Dale, 2012).

Black dhe William (1998) pohojnë se informatat kthyese ndriçojnë pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve, japin disa sugjerime për përmirësim dhe shmangin krahasimin e një nxënësi me bashkëmoshatarët e tij (siç është cituar në Mussawy, 2009). Informata kthyese është më e dobishme kur mësuesit japin sugjerime specifike se si mund të përmirësohen detyrat e shtëpisë dhe diskutojnë problemet me nxënësit në mënyrë individuale ose me tërë klasën. Informatat kthyese që përjetësojnë një mbështetje të tepruar të nxënësit nga mësuesit nuk janë domosdoshmërisht më të mira dhe mund të jenë jo produktive pasi nuk arrijnë t'u tregojnë nxënësve se si të ecin përpara (Asghar, 2013). Një perspektivë tjetër e punës së nxënësve është dhënia e informatës kthyese nga shoku ose shoqja e klasës. Informatat e tilla mund të jenë shumë të dobishme. Një gjë e tillë i ndihmon nxënësit të mësojnë aftësi sociale, bashkëpunuese dhe të mësojnë se si të vlerësohen përpjekjet e tyre dhe të tjerëve (Paulu, 2009).

Kur nxënësit kanë informata kthyese të qarta tregohet se puna e tyre është respektuar derisa ata marrin këshilla dhe kanë mundësi të zvogëlojnë boshllëqet aty ku kanë nevojë (Fawzy, 2012; Hattie & Gan, 2011). Kur nxënësit marrin informatë kthyese konstruktive, ata do të mësojnë edhe më shumë dhe do të ndihen më të rëndësishëm, prandaj derisa mësuesit japin detyra të shtëpisë duhet të gjejnë kohën dhe mundësinë për të dhënë informata kthyese me gojë ose me shkrim. Mësuesit duhet të gjejnë kohë të japin informatë kthyese në kohën e duhur edhe pse pajtohem me mendimin e autorit (McNulty, 2018) se siguri i informatës kthyese dhe përcjellja në mënyrë efektive të secili fëmijë në detyra të shtëpisë brenda orarit ditor është e vështirë të realizohet në mënyrën më të mirë të mundur. Është shumë e rëndësishme kur nxënësit marrin informatë kthyese lidhur me detyrat e shtëpisë në momentin që ata dorëzojnë detyrat e shtëpisë, pasi në të kundërtën informata kthyese pas një kohe më të gjatë nuk do ta ketë efektin e duhur. Informata kthyese e menjëhershme pasi nxënësit përfundojnë detyrat e shtëpisë çojnë në mësim më të mirë sesa të presësh deri ditën tjetër për të marrë të njëjtën informatë kthyese. Pra kur nxënësit marrin informatë kthyese ata do të jenë edhe më shumë të angazhuar në mësim (D'antoni et al., 2015; Kehrer et al., 2013; Kortemeyer et al., 2005).

Skaggs (2007) shpjegon se dhënia e informatës kthyese është më shumë punë individuale e mësuesit pasi dallojnë mësuesit nga njëri – tjetri në mënyrën e kontrollimit të detyrave të shtëpisë. Sipas autorit, disa mësues mbledhin detyrat e shtëpisë dhe japin informatë kthyese, kurse disa të tjerë i kontrollojnë detyrat e shtëpisë vetëm nëse janë plotësuar ato.

Në një hulumtim nga mësues të shkollave fillore dhe të mesme, përdorimi i informatës kthyesë në detyrave të shtëpisë u referua si një mjet i rëndësishëm për të nxitur nxënësit për të përfunduar detyrat e shtëpisë. Mësimdhënësit pohuan se informata kthyesë është e nevojshme për të ndihmuar nxënësit të kryejnë detyrat e shtëpisë (Cunha et al., 2018).

Nëse mësimdhënësit nuk kanë mundësi të japin informatë kthyesë duhet të rishikojnë sasinë e detyrave të shtëpisë që ata kanë caktuar për nxënësit. Shkurtimi i sasisë së detyrave të shtëpisë u jep më shumë mundësi që ata të gjejnë kohë për të dhënë informatë kthyesë. Përveç kësaj, sipas udhëzuesit për vlerësimin e nxënësve ‘ Jo gjithmonë është e mundur që nxënësit të marrin informata kthyesë për detyrat e kryera, rekomandohet që për detyrat e shtëpisë të jepen edhe pyetje që i mundësojnë nxënësit të vetëreflektojnë, kurse mësimdhënësit, të informohet më mirë për nevojat e nxënësve për përmirësime eventuale. Këto informata janë shumë të vlefshme që mësimdhënësi mund t’i shfrytëzojë si udhëzime për punën individuale me nxënësit (MASHTI, 2020).

2.7. Koha që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë

Koha që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë ka një rëndësi shumë të madhe gjë që ndikon edhe në rezultatet e tyre në procesin mësimor. Kur mësuesit caktojnë detyra të shtëpisë duhet të kenë parasysh moshën e tyre dhe kapacitetin në mënyrë që nxënësit të kenë interesim për të përfunduar detyrat e shtëpisë ose të mos kopjojnë detyrat nga shokët e klasës. Ka mënyra të ndryshme që të përcaktohet koha të cilën nxënësit duhet ta kalojnë në bërjen e detyrave të shtëpisë. Për shkak të aftësive të të nxënësve, jo të gjithë nxënësve u duhet kohë e njëjtë për kryerjen e së njëjtës detyrë. Sasia e detyrave të shtëpisë që u jepet nxënësve, ka ndryshuar nga viti në vit. Për këtë arsye, koha e shpenzuar për detyrat e shtëpisë është shumë komplekse dhe shumë studiuues janë marrë me këtë çështje.

Në artikullin “A Nation at Rest: The American Way of Homework”, autorët kanë përdorur disa sondazhe kombëtare për të siguruar një perspektivë 50 vjeçare për kohën e kaluar në detyra të shtëpisë. Tani mësuesit caktojnë më shumë detyra të shtëpisë se sa në të kaluarën dhe ka disa dëshmi për rritjen e sasisë së detyrave për nxënësit e klasës fillore (Gill & Schlossman, 2003). Normalisht, detyrat e shtëpisë vijnë duke u shtuar me kalimin e fëmijëve në një shkallë më të lartë.

Studiuesit dhe organizatat e ndryshme përfshirë Shoqatën Kombëtare të Prindërve dhe Mësuesve (PTA) dhe Shoqatën Kombëtare të Arsimit (NEA) mbështetin një “ rregull 10 – minutash”, i cili inkurajon mësuesit të caktojnë për nxënësit 10 minuta për detyrat e shtëpisë në nivel klase në të gjitha lëndët. Tabela e mëposhtme paraqet kohën që duhet të kalojnë nxënësit e klasës së parë deri në klasën e pestë duke punuar detyra të shtëpisë.

Tabela 3. Udhëzime për ngarkesën e detyrave të shtëpisë sipas nivelit të klasës – “ Rregulla 10 minutash

Niveli	Koha
Klasa e parë	10 minuta
Klasa e dytë	20 minuta
Klasa e tretë	30 minuta
Klasa e katërt	40 minuta
Klasa e pestë	50 minuta

Rregulli 10 minutash është përshtatur nga hulumtues të ndryshëm të cilët me vite të tëra janë marrë me praktikën e detyrave të shtëpisë, si: Cooper, Robinson dhe Patall, (2006). Mësuesit duhet të bëjnë shumë kujdes në caktimin e kohës për punimin e detyrave të shtëpisë në mënyrë që të mos marrin shumë kohë edhe nga aktivitetet e tjera që nxënësit i bëjnë në shtëpi.

Disa studiues kanë përdorur të dhëna dhe kanë bërë matje paraprake të aftësive të nxënësve që të identifikohen modelet e shkakut ndërmjet kohës dhe arritjes. Këto studime tregojnë që nëse nxënësit shpenzojnë më shumë kohë në kryerjen e detyrave të shtëpisë, atëherë aftësitë e tyre do të përmirësohen me kalimin e kohës (Epstein & Voorhis, 2001). Njerëzit ankohen për kohën e shpenzuar në kryerjen e detyrave të shtëpisë, sepse oraret janë të ngarkuara dhe për shkak se mësuesit nuk kanë konsistencë në caktimin e detyrave të shtëpisë. Prandaj, është e dobishme të shqyrtojmë lidhjen ndërmjet detyrave të shtëpisë dhe prindërve (Landing - Corretjer, 2009). Koha që nxënësit e kalojnë në detyra të shtëpisë duhet të monitorohet me kujdes dhe të jetë e përshtatshme për nivelin e klasës dhe të mos iu marrë shumë kohë nga familja (Marzano, 2003). Respektimi i rregullit “10 minutash” për secilin nivel të klasës, do të ishte në favor të nxënësve dhe prindërve, pasi fëmijët nuk do të jenë shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë nëse respektohet ky rregull.

Përveç respektimit të rregullit “10 minutash” mësuesit duhet të bëjnë kujdes që gjatë ditëve të vikendit dhe festave të veçanta të mos caktojnë detyra të shtëpisë. Gjatë ditëve të vikendit, fëmijët kanë nevojë të pushojnë dhe të kalojnë kohën e lirë duke u argëtuar me anëtarët e familjes e jo duke bërë detyra të shtëpisë. Nëse fëmijët do të kenë detyra të shtëpisë gjatë kohës kur ata kanë pushim do të krijohet lodhje te ata dhe do të mërziten nga detyrat dhe shkolla. Gjatë kohës së pushimit, atyre duhet t’u mundësohet të zhvillojnë aktivitete të ndryshme relaksuese që ata të çlodhen nga mësimet e

shkolla. Në këtë mënyrë, fëmijët do të jenë të gatshëm të shkojnë përsëri në shkollë (Ozer & Keskin, 2015).

2.8. Mbingarkesa e nxënësve në detyra të shtëpisë

Një faktor mjaft i rëndësishëm që lidhet me kohën që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë është edhe mbingarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë. Hulumtuesit theksojnë se detyrat e shtëpisë duhet të caktohen në sasi të arsyeshme po ashtu të përshtatshme për nivelin mësimor në raport me aftësitë e nxënësve si dhe me nivelin e klasës. Ngarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë po shihet si një problem shumë serioz dhe shqetësues si nga nxënësit ashtu edhe nga prindërit. Caktimi i detyrave të shumta shkakton efekte negative për shëndetin psikologjik të fëmijëve (Ndebele, 2018; Zhang, 2019).

Autori (Zhang, 2019) paraqet disa arsye për mbingarkesën e nxënësve me detyra të shtëpisë:

- ✓ Mësimdhënësit të ndikuar thellësisht nga idetë tradicionale,
- ✓ Mungesa e komunikimit në mes të mësimdhënësve,
- ✓ Mungesa e kërkimit për format e reja të detyrave të shtëpisë,
- ✓ Mungesa e vetëdijes dhe të kuptuarit adekuat të ndikimi i detyrave të shtëpisë tek fëmijët.

Mësimdhënësit duhet të bëjnë kujdes në cilësinë e detyrave e jo në sasinë. Caktimi i detyrave të shumta do të thotë që mësimdhënësi nuk ka menaxhuar në mënyrë jo të duhur caktimin e detyrave të shtëpisë. Autorët (Hallam, 2006; MacBeath & Turner, 1990) në studimin e tyre theksojnë se mësimdhënësit kur caktojnë detyrat e shtëpisë duhet të kenë parasysh:

- detyrat e shtëpisë duhet të lidhen qartë me punën e vazhdueshme në klasë;
- duhet të ketë një model të qartë për punën në klasë dhe detyrat e shtëpisë;
- detyrat e shtëpisë duhet të jenë të ndryshme;
- detyrat e shtëpisë duhet të jenë të menaxhueshme;
- detyrat e shtëpisë duhet të jenë sfiduese, por jo shumë të vështira;
- detyrat e shtëpisë duhet të lejojnë iniciativën dhe kreativitetin individual;
- detyrat e shtëpisë duhet të nxisin vetëbesimin dhe mirëkuptimin;
- duhet të ketë njohje ose shpërblim për punën e bërë;
- duhet të ketë udhëzime dhe mbështetje.

Në studimin kuantitativ të hulumtuesve (Chraif & Anitei, 2012), nxënësit pohuan se ngarkesa e madhe me detyra të shtëpisë ju shkakton dhimbje koke, marramendje, lodhje prandaj mësimdhënësit duhet të marrin parasysh sasinë e detyrave të shtëpisë, numrin e ditëve që nxënësit kanë detyra, numrin e orëve që nxënësit punojnë detyrat pasi në këtë mënyrë ruajnë shëndetin fizik dhe psikologjik për nxënësit. Në një tjetër studim për detyrat e shtëpisë, kritika dhe shqetësimi kryesor i nxënësve ishte mbingarkesa

e detyrave të shtëpisë, ku si pasojë e kësaj nxënësit mund të humbin interesimin për detyra të shtëpisë (Jiang, 2018). Për shkak të mbingarkesës nevoja për më shumë kohë për të përfunduar detyrat e shtëpisë mund të zvogëlojë arritjet akademike të nxënësve (Murillo & Martinez-Garrido, 2014). Përveç zvogëlimit të arritjes akademike nuk mund të sjellin asnjë përfitim por vetëm pasoja në aspektin fizik, emocional, social dhe edukativ të fëmijës dhe familjes. Po ashtu dhe humbja e interesimit të fëmijës për mësim është e paevitueshme (Pressman et al., 2015, Ndebele, 2018).

2.9. Llojet e detyrave të shtëpisë

Lloji i detyrave të shtëpisë që vendos shkolla ndryshon sipas moshës dhe aftësisë së nxënësit dhe kërkesave të kurrikulës (Hallam, 2004)

Përveç dhënies së udhëzimeve për detyra të shtëpisë, një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në inkurajimin e nxënësve për të përfunduar detyrat e shtëpisë është edhe lloji i detyrave që cakton mësimdhënësi.

Beutlich (2008) thekson se ekzistojnë tri lloje të detyrave të shtëpisë që ndikojnë në motivimin e nxënësve dhe përfshirjen e prindërve për të përfunduar me sukses detyrat: detyrat ndërpersonale, detyrat interaktive dhe detyrat e bazuara në projekte. Edhe autorë të tjerë mbështesin detyrat interaktive pasi duke përfshirë anëtarët e familjes në detyra të shtëpisë, ata ndajnë fakte interesante me fëmijët e tyre (Epstein & Voorhis, 2001). Pothuajse në çdo hulumtim për detyra të shtëpisë, kur flitet për llojet e detyrave të shtëpisë fokus të veçantë zënë detyrat me projekte ose detyrat problemore (Beutlich, 2008; Epstein & Voorhis, 2001; Landing - Cooretjer, 2009; Stogner, 2014).

Konferenca në shtëpi është një lloj tjetër i detyrave të shtëpisë ku fëmijët ndajnë detyrat e klasës me anëtarët e tjerë të familjes dhe diskutojnë për punën e tyre (Stogner, 2014). Një shembull të njëjtë me këtë e përshkruajnë edhe autorët (Epstein & Voorhis, 2001), por ata duke përdorur dosjet e klasës (portofoliot) si rishikim dhe diskutim i punës që zhvillohet në klasë. Sipas Dobozy (2010), detyrat e shtëpisë që përfshijnë eksplorimin i lejojnë studentët të shikojnë fusha të reja dhe të ndryshme të një lënde sipas interesave dhe preferencave të tyre. Detyrat e shtëpisë që përfshijnë shprehje kërkojnë kërkime të zhvilluara mirë, të menduarit kritik dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve. Këto detyra shtëpie janë gjeneruese, që do të thotë se ato kërkojnë që nxënësit të gjenerojnë njohuri të reja. Ato kërkojnë shumë planifikim dhe përafrim të ngushtë midis rezultatit të të nxënës dhe detyrës mësimore (cituar në Rudman, 2014).

Është shumë e rëndësishme kur mësimdhënësit caktojnë detyra të shtëpisë të kenë parasysh që të caktojnë detyra që janë interesante për nxënësin, u japin mundësi nxënësve që vetë të zgjedhin detyra

që kanë interes për ato detyra. Në këtë mënyrë nxënësit përmbushin nevojat specifike të nxënësve (Rudman, 2014; Vatterot, 2010).

2.10. Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë

Edukimi dhe qëndrimi ndaj punës së fëmijëve fillon nga familja. Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijëve të tyre derisa fëmija të fillojë shkollën, prandaj përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë është një urë lidhëse midis nxënësve, prindërve dhe shkollave, gjë e cila e bën një trekëndësh të rëndësishëm. Derisa prindërit ndihmojnë fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë, ata zbulojnë pikat e forta dhe të dobëta të tyre. Është e rëndësishme të theksohet se përfshirja e prindërve në bërjen e detyrave të shtëpisë mund të ketë efekte pozitive dhe negative.

Për habi, disa studime tregojnë se detyrat e shtëpisë mund të jenë burim i konfliktit familjar. Sipas Kralovec dhe Buell (2000), detyrat e shtëpisë shkatërrojnë kohën e familjes. Studimet tregojnë se prindërit shpesh ndihen edhe të papërgatitur për ndihmë, ose ata ofrojnë ndihmë të papërshtatshme (Voorhis, 2011). Por ka edhe raste kur edhe prindërit përfundojnë detyrat e fëmijës së tyre dhe shumë hulumtues mendojnë që detyrat e shtëpisë inkurajojnë edhe mashtrimin përmes kopjimit të detyrave (Beutlich, 2008). Në një studim “Homework in primary education from the perspective of teachers and pupils”, të dhënat e nxjerra nga hulumtuesit, konkludojnë se lidhja midis shkollës dhe familjes duhet të forcohet, sepse prindërit janë thelbësorët për të inkurajuar fëmijët e tyre dhe për t'i mbështetur ata në organizimin e detyrave të shtëpisë (Costa et al., 2017).

Një tjetër studim për opinionet e prindërve për detyrat e shtëpisë, konkludon se prindërit i shohin detyrat e shtëpisë si të domosdoshme dhe të rëndësishme për të mbështetur të mësuarit, përvetësimin e njohurive dhe është jetike në ndërtimin e besimit dhe përgjegjësisë. Sipas disa prindërve që ndihmuan fëmijët e tyre me detyrat e shtëpisë, besonin se vëllimi i detyrave të shtëpisë ishte shumë i madh dhe se fëmijët nuk kanë kohë të mjaftueshme për aktivitete në kohën e lirë. Shumica e autorëve dhe prindërve besojnë se detyrat e shtëpisë janë të dobishme dhe të domosdoshme (Kukk et al., 2015).

Veç kësaj, hulumtimet kanë treguar po ashtu se nga përfshirja e familjes përfiton edhe mësuesi. Ata krijojnë ndjenja pozitive rreth mësimdhënies në shkollat e tyre kur ka më shumë përfshirje të prindërve në shkollë (Epstein & Dauber, 1991; Hoover-Dempsey et al., 1987). Mësimdhënësit që komunikojnë me prindërit kanë tendencë të rrisin pritshmërinë dhe vlerësimin për të gjithë prindërit dhe vazhdojnë t'i shtojnë aktivitetet për përfshirjen e familjes (Epstein & Voorhis, 2001). Megjithëse detyrat e shtëpisë u dedikohen nxënësve (d.m.th. nxënësit zgjedhin se si, ku dhe se me kë do t'i bëjnë detyrat e shtëpisë), prindërit shpesh e strukturojnë mjedisin shtëpiak për fëmijët e tyre. Njohuritë e mësimdhënësve dhe prindërve për parapëlqimet e detyrave të nxënësve do të ishin të vlefshme që të kuptohen zgjedhjet individuale të nxënësve dhe mënyra se si angazhohen ata në detyrat e shtëpisë dhe

të mësojnë se si të krijojnë detyra për ata nxënës që kanë nevojë për ndihmë shtesë (Iflozoğlu, 2014, fq. 14). Detyrat e shtëpisë mund t'u japin prindërve mundësinë që të shohin se çfarë po ndodh në shkollë dhe që të shprehin qëndrime pozitive drejt arritjes. Për shumë fëmijë, ndoshta, detyrat e shtëpisë janë zëvendësuese të televizionit dhe video lojërave (Bembenuty, 2009).

Marzano (2003) thotë se prindërit duhet të përfshihen në detyrat e shtëpisë kur është e përshtatshme. Sipas tij, prindërit duhet t'i ndihmojnë nxënësit të përmbledhin informacionin që ata kanë mësuar, por prindërit nuk duhet të ndihen sikur kanë nevojë të veprojnë si mësues ose si policë për t'u siguruar që ata të kryejnë detyrat e shtëpisë. Në vitin 2005, Xu realizoi një hulumtim për përqendrimin e nxënësve në detyrat e shtëpisë. Ata pohuan se janë më të koncentruar në detyrat e shtëpisë kur njëri nga prindërit u qëndron afër se sa ndonjë bashkëmoshatar ose kur punojnë vetë (cituar në Beutlich, 2008).

Në një hulumtim të realizuar nga Cooper (2001) për efektet e detyrave të shtëpisë, ndër efektet pozitive që përmendet është edhe përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë. Kur prindërit përfshihen në detyra të shtëpisë, rrisin vlerësimin për shkollimin e fëmijëve të tyre dhe shprehin qëndrime pozitive për ta. Po ashtu, nxënësit mësojnë se mësimi mund të zhvillohet kudo e jo vetëm brenda shkollës. Harris Cooper sugjeron pesë këshilla të rëndësishme që prindërit të luajnë gjatë procesit të detyrave të shtëpisë:

1. Bëhu menaxher në skenë. Sigurojuni fëmijëve tuaj ambient të përshtatshëm për punimin e detyrave të shtëpisë (vend të qetë dhe të ndriçueshëm) po ashtu edhe sigurimi i materialeve të nevojshme. Është shumë e rëndësishme kur fëmijët të fillojnë të punojnë detyrat e shtëpisë të kenë një ambient të përshtatshëm së bashku me mjetet e nevojshme që mund t'iu nevojiten gjatë punimit të detyrave të shtëpisë. Gjëja e parë që ata duhet ta kenë është vendi i qetë dhe i ndriçueshëm, pasi në këtë mënyrë do të jenë të gatshëm të fillojnë me punimin e detyrave të shtëpisë duke mos shkëputur vëmendjen se çfarë po ndodh rreth tyre. Në të kundërtën, nëse ndodhen në një ambient jo edhe shumë të përshtatshëm, pra që ka zhurmë apo mungojnë mjetet e nevojshme për punimin e detyrave të shtëpisë atëherë fëmijët nuk do të kenë vëmendjen dhe koncentrimin e duhur.
2. Bëhu motivues. Detyrat e shtëpisë ofrojnë një mundësi të shkëlqyeshme për t'i thënë fëmijës së sa e rëndësishme është shkolla. Jeni pozitiv për detyrat e shtëpisë. Ka shumë rëndësi kur prindërit vazhdimisht i diskutojnë me fëmijët anët pozitive të punimit të detyrave të shtëpisë. Në këtë mënyrë, fëmijët kuptojnë më shumë për rëndësinë e punimit të detyrave të shtëpisë.
3. Bëhu rol model. Nëse fëmija juaj lexon edhe ju lexoni. Shembulli më i mirë për fëmijët janë prindërit. Fëmijët imitojnë dhe marrin si model veprimet e prindërve të tyre, prandaj nëse fëmijët shohin që prindërit e tyre po lexojnë edhe ata do të lexojnë me shumë kënaqësi.

4. Bëhu monitorues. Nëse fëmija juaj kërkon ndihmë jepni udhëzime, jo përgjigje. Ka shumë rëndësi edhe ndihma që prindërit ua ofrojnë fëmijëve të tyre. Nëse fëmijët kërkojnë ndihmë, atëherë prindërit më shumë kujdes duhet të ndihmojnë ata, duke i udhëzuar që vetë të gjejnë përgjigjen e duhur. Nëse prindërit i ndihmojnë fëmijët e tyre duke u ofruar përgjigje të gatshme atëherë një gjë e tillë është e mjaft e gabuar.
5. Bëhu mentor. Nëse detyra e shtëpisë do të bëhet vetëm, rri larg.

Këto sugjerime i paraqiti Cooper gjatë një interviste të realizuar nga Bembenutty (Bembenutty, 2009). Këto këshilla janë shumë të rëndësishme që çdo fillim viti mësuesi të diskutojë me prindërit për përfshirjen e tyre në detyrat e shtëpisë e në veçanti për prindërit fillestarë. Mësimdhënësit duhet ta kenë parasysh se jo të gjithë prindërit mund të kenë nivel të njejtë shkollimi, prandaj mund të ndodhë që ndonjëherë të mos kenë njohuri të mjaftueshme për të ndihmuar fëmijët e tyre në detyra të shtëpisë (Huisman, 2016). Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme kur mësimdhënësi vazhdimisht bashkëpunon me prindërit dhe u jep këshilla të nevojshme për ndihmën që duhet t'ua ofrojnë prindërit fëmijëve në detyra të shtëpisë. Ndonjëherë për shkak të informatave të pamjaftueshme prindërit mund të udhëzojnë fëmijët gabim në punimin e detyrave të shtëpisë.

Në një udhëzues për prindërit “Si ta ndihmoni fëmijën për detyra të shtëpisë”, autori jep disa këshilla të rëndësishme për prindërit në rast kur fëmija kërkon vazhdimisht ndihmë gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Disa nga problemet që mund të shfaqen mund të jenë:

- Fëmija mund të jetë i pavëmendshëm në klasë;
- Mund të ketë probleme me dëgjimin apo kujtesën;
- Fëmija mund të mos e kuptojë mësimin dhe kjo e pengon t'i kuptojë edhe detyrat që jepen;
- Fëmija mund të jetë duke i përdorur detyrat e shtëpisë si një mjet për të tërhequr vëmendjen e prindërve;
- Mësuesi mund t'u ketë dhënë ushtrime për çështje që ende nuk janë shpjeguar në klasë;
- Detyrat mund të jenë të paqarta, ta pasakta ose pa kuptim;

Sipas autorit, prindërit dhe mësuesit duhet të punojnë së bashku për të gjetur një zgjidhje. Nëse bashkëpunojnë ashtu siç duhet shumica e këtyre problemeve do të zgjidhen (Schumm, 2005). Edhe, Woolfolk (2011), jep disa këshilla për bashkëpunimin e mirëfilltë në mes të prindërve dhe mësuesve. Sipas autores, mësuesit duhet të sigurohen që prindërit e dinë se ç'kërkohet të mësojnë fëmijët e tyre, t'u kërkohet familjarëve këshilla rreth detyrave të shtëpisë dhe të përdorin këshillat e tyre si dhe nëse fëmijët nuk kanë dikë për t'i ndihmuar në shtëpi, të gjejnë mundësi të tjera për t'iu ofruar ndihmë këtyre fëmijëve.

Në një dokument të publikuar nga Hanover Research në vitin 2018, janë paraqitur disa strategji për prindërit që ndikojnë në praktikën efektive të detyrave të shtëpisë. Sipas këtij dokumenti, prindërit duhet të informohen mirë në fillim të vitit shkollor se si duhet të ndihmojnë fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë. Do të ishte e dobishme që prindërit të shohin edhe ndonjë shembull se si duhet të punohet me fëmijët në detyrat e shtëpisë, qoftë shembull i prezantuar nga mësuesi ose ndonjë prind i klasës. Ata duhet të inkurajohen të kenë një rol mbështetës gjë i cili ndikon që edhe vetë ata të inkurajojnë fëmijët e tyre për punimin e detyrave. Edhe krijimi i një mjedisi të përshtatshëm në shtëpi është një ndër strategjitë që përmendet vazhdimisht gjë që ndikon në praktikën efektive të detyrave të shtëpisë.

Në vitin 2011, Voorhis realizoi një studim eksperimental për përfitimin e ndihmës së prindërve me detyrat e shtëpisë. Ai zbuloi se trajnimi i prindërve për të ndihmuar në detyrat e shtëpisë mund të sjellë përfitim. Voorhis tregoi se kur prindërit udhëzoheshin për mënyrën e duhur për të ndihmuar fëmijët e tyre, niveli i stresit në familjet e tyre u ul (siç është cituar në Hoeke 2017). Sipas një hulumtimi të realizuar në disa shkolla fillore në Stamboll, hulumtuesit konkluduan se sa më të moshuar mësuesit, ata nuk i konsiderojnë detyrat e shtëpisë si një mjet për të komunikuar me prindërit (Ilgar & Ilgar, 2012). Në të njëjtin kontekst, një tjetër hulumtim “Evaluating The Difficulties Faced By Primary School Students In Doing Homework/Research From Parents' Point Of View”, hulumtuesit theksojnë se prindërit nuk janë në gjendje të kursejnë kohë për të ndihmuar fëmijët e tyre në detyra të shtëpisë, prandaj prindërit kërkuan që detyrat të jenë të përshtatshme për nivelin e nxënësve në mënyrë që nxënësit të jenë në gjendje t’i bëjnë detyrat e shtëpisë, pa ndihmën e prindërve (Ozer & Keskin, 2015). Në të njëjtin hulumtim, prindërit theksojnë se shpeshherë përballen edhe me probleme ekonomike për të siguruar materiale të ndryshme shkollore, të cilat iu nevojiten fëmijëve për punimin e detyrave të shtëpisë. Disa prindër deklarojnë se edhe mungesa e internetit ose e kompjuterit krijon vështirësi për fëmijët të cilët punojnë detyra kërkimore ose projekte të ndryshme. Në këto raste, mësime dhënësit duhet të kenë parasysh se çfarë materiale të punës kërkojnë për detyra të shtëpisë pasi jo të gjithë nxënësit mund të kenë mundësi të sigurojnë mjetet e nevojshme për punë.

2.11. Përmbledhje

Edhe pse kemi mendime *në favor* dhe *kundër* detyrave të shtëpisë nga autorë e hulumtues të ndryshëm, studimet për detyrat të shtëpisë mbesin të hapura dhe të papërfunduara. Si rrjedhojë, shqyrtimi i literaturës na shpie në hulumtim të mëtutjeshëm të aspekteve të ndryshme profesionale të mësimdhënësve me qëllim të zbatimit sa më efektiv dhe praktik të detyrave të shtëpisë.

Sipas shumë autorëve, detyrat e shtëpisë duhet të jenë mirë të planifikuara që të mund të jenë të dobishme për shumë nxënës (Cooper et al., 2006; Epstein & Voorhis, 2001; Fawzy, 2012; Hoeke, 2017; Stogner, 2014; Voorhis, 2004; Woolfolk, 2011).

Cooper et al. (2006) tha se detyrat e shtëpisë u përdorën për shumë qëllime, si akademike ashtu edhe jo akademike, ndërsa Kohn (2006), tregon për ngarkesën në detyrat e shtëpisë dhe konflikteve që shkaktohen në familje. Ai sugjeron që numri i detyrave të pakësohet dhe cilësia e tyre të rritet (fq. 168). Për të përfituar nga detyrat e shtëpisë, nxënësit duhet ta kuptojnë detyrën e shtëpisë. Po ashtu puna duhet të kontrollohet, nxënësve t'u jepet mundësia për t'i përmirësuar gabimet ose fushat ku duhet zhvilluar më shumë (Hoeke, 2017; Woolfolk, 2011). Një gjë e rëndësishme që përmendet në këtë kapitull është koha që nxënësit duhet të kalojnë në detyra të shtëpisë. Mësimdhënësit duhet të bëjnë kujdes që të mos ngarkojnë shumë fëmijët me detyra të shtëpisë duke marrë parasysh edhe kohën e lirë që duhet ta kalojnë ata në shtëpi. Respektimi i rregullit “10 minutash” të merret parasysh nga mësimdhënësit kur ata caktojnë detyra të shtëpisë për nivel klase. Përveç respektimit të këtij rregulli, mësimdhënësit të kenë kujdes që të mos caktojnë detyra të shtëpisë në ditët e vikendit dhe gjatë ditëve të festave pasi fëmijët kanë nevojë të pushojnë gjatë ditëve të pushimit.

Në fund, shpjegohet për rëndësinë e bashkëpunimit me prindër lidhur me detyrat e shtëpisë. Hulumtimet (Bembenuity, 2009; Cooper, 2001) theksojnë se prindërit duhet të informohen qysh në fillim të vitit shkollor për detyrat e shtëpisë dhe ndihmën që duhet t'ua ofrojnë prindërit fëmijëve të tyre gjatë punimit të detyrave të shtëpisë. Ata japin këshilla të rëndësishme duke filluar nga krijimi i ambientit të përshtatshëm për punim të detyrave edhe deri të përcjellja e fëmijëve gjatë kohës që ata punojnë detyra të shtëpisë. Për më tepër, autorët mund të theksojnë se është shumë e rëndësishme që prindërit të mundohen të jenë shembull i mirë i fëmijëve të tyre gjatë punimit të detyrave të shtëpisë.

KAPITULLI III

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Qëllimi kryesor i studimit është identifikimi i faktorëve që ndikojnë të mësimeve për mënyrën si i menaxhojnë detyrat e shtëpisë, sfidat me të cilat përballen mësimeve gjatë këtij procesi si dhe rolin e bashkëpunimit të prindërve në këtë aspekt. Gjithashtu, studimi ka për qëllim të zbulojë se si ndërlikohen veçoritë personale e profesionale të mësimeve me perceptimin dhe praktikën e detyrave efektive të shtëpisë. Hulumtimi i përket qasjes mikse që shërbehet me të dhëna sasiore dhe cilësore.

Ky kapitull prezanton metodologjinë e hulumtimit duke filluar me dizajnin e hulumtimit, kampionin




Figura 4. Procedura e metodologjisë së hulumtimit

(mostra), procesin e pilotimit, mbledhja e të dhënave, instrumentet e përdorura në studim, besueshmëria e instrumenteve të studimit, analiza e të dhënave dhe aspektin etik (fig. 4).

3.1. Dizajni i hulumtimit

Hulumtimi implikon qasje mikse, që shërbehet me të dhëna sasiore dhe cilësore, ndërsa dizajni i hulumtimit i përket dizajnit të Triangulimit (Creswell et al., 2003), i njohur si dizajni më i përshtatshëm për qasjet mikse të hulumtimit. Kombinimi i të dy metodave të përziera u siguron lexuesve një kuptim më të mirë se sa një metodë e veçantë. Hulumtuesit mbështesin metodat mikse duke theksuar se metodat e përziera ofrojnë lidhje me realiste midis studimeve sasiore dhe cilësore. Kombinimi i metodës sasiore me atë cilësore, ofron një kuptim më të mirë për një problem kërkimor ose çështje se sa vetëm njëra qasje vetëm (Creswell, 2007; Almalki, 2016). Sipas Creswell dhe Plano Clark (2007), zgjedhja e metodës mikse kombinon pikat e forta të secilës metodologji dhe minimizon dobësitë (siç është cituar në McKim, 2015).

Schulze (2003), në gjetjet e tij tregon se hulumtimi i metodave të përziera ka shumë përparësi pasi ofron më shumë gjerësi, thellësi dhe është më i pasur së sa metodat sasiore dhe cilësore vetëm. Fillimisht, hulumtimi ka konsistuar në mbledhjen e të dhënave përmes një pyetësi për mësimdhënësit e ciklit fillor respektivisht për mësuesit e klasës së pestë. Më pas, është realizuar një intervistë gjysmë e strukturuar me mësimdhënësit, nxënës dhe prindër.

3.2. Pjesëmarrësit dhe mostra

Pjesëmarrësit e këtij studimi janë mësuesit, prindërit dhe nxënësit. Shtrirja e popullacionit është realizuar në katër komuna: një komunë e madhe – qendrore (Prishtina), një komunë e mesme (Peja) dhe dy komuna të vogla (Istogu dhe Lipjani), që përfaqësojnë karakteristikat e komunave në Kosovë.

Për caktim të mostrës të dhënat janë siguruar nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (2016/2017). Korniza tregon se në komunën e Prishtinës janë 2539 mësimdhënësit, në Pejë janë 1309 mësimdhënësit, në Lipjan janë 762 mësimdhënësit dhe në Istog janë 523 mësimdhënësit (MASHT, 2017), pra gjithsej 5133 mësimdhënësit. Bazuar në tabelën për caktimin e madhësisë së mostrës (Cohen et al., 2007, fq.104) për konfidencën 95%, kampioni ynë për marzhë gabimi për 5% do të jetë 365 mësimdhënësit të ciklit fillor. Ky numër përbën 7.11% të të gjithë popullacionit të mësimdhënësit të ciklit fillor të këtyre komunave. Gjatë llogaritjes të së njëjtës përqindje në numrin e mësimdhënësit sipas komunave, nga Komuna e Prishtinës pjesë e studimit janë 181 mësimdhënësit, nga Komuna e Pejës 93 mësimdhënësit, ndërsa nga Komuna e Istogu dhe Lipjanit janë 54 përkatësisht 37 mësimdhënësit. Mostra për hulumtim është përcaktuar sipas metodës së probabilitetit (Kumar, 2014, fq. 242). Pra, në mënyrë të rastësishme janë zgjedhur 18 shkolla në Komunën e Prishtinës, 10 shkolla në Komunën e Pejës, 5 shkolla në Komunën e Istogut dhe 4 shkolla në Komunën e Lipjanit. Nga secila shkollë janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga 10-12 mësimdhënësit. Për çështje sigurie janë

realizuar 370 pyetësorë dhe pasi është bërë pastrimi i të dhënave, numri final i kampionit të përfshirë në studim rezultoi të jetë 366 pjesëmarrës (mësimdhënës).

Të gjithë mësimdhënësit e përzgjedhur kanë plotësuar një pyetësor për të kuptuar perceptimet që mësuesit kanë për detyrat e shtëpisë. Për të kuptuar më thellë perceptimet e mësimdhënësve lidhur me detyrat e shtëpisë si dhe për të sqaruar më mirë ndonjë rezultat të fituar përmes përpunimit të dhënave sasiore janë organizuar nga 5 intervista me mësimdhënës, 5 intervista me nxënës dhe 5 intervista me prindër në secilën komunë që është realizuar studimi.

3.2.1. Pjesëmarrësit

Në hulumtimin kuantitativ kanë marrë pjesë gjithsej 366 mësimdhënës të ciklit 1-5, kurse 352 prej tyre apo 96.2% ishin të gjinisë femërore dhe 14 të tjerë apo 3.8% mësimdhënës të gjinisë mashkullore. Me përvojë 1-5 vjet ishin 89 mësimdhënës apo 24.3% e mësimdhënësve, 49 mësimdhënës apo 13.4% e mësimdhënësve me përvojë prej 6-10 vjet. 86 mësimdhënës apo 23.5% e mësimdhënësve me përvojë 11-15 vjet dhe mbi 16 vjet përvojë morën pjesë 142 mësimdhënës apo 38.8% e mësimdhënësve.

Tabela 4. Numri i të anketuarve (mësimdhënësve) sipas gjinisë dhe përvojës së punës.

Pozita në mësimdhënie	N	%
Mësues/e i/e ciklit 1-5	366	100%
Gjinia	N	%
Femër	352	96.2
Mashkull	14	3.8
Përvoja ime në mësimdhënie është?	N	%
1-5 vjet	89	24.3
6-10 vjet	49	13.4
11-15 vjet	86	23.5
16 e më shumë vjet	142	38.8

Në hulumtimin kualitativ janë realizuar nga 5 intervista me mësime dhënë, 5 nxënë dhe 5 prindër në secilën komunë ku është zhvilluar studimi, pra gjithsej 20 mësime dhënë, 20 nxënë dhe 20 prindër janë pjesëmarrës në studim.

Tabela 5. Të dhënat e mësime dhënëve pjesëmarrës në intervista

Kodi	Mosha	Gjinia	Përvoja e punës	Kohëzgjatja
M01	36	F	14 vjet	28 min
M02	38	F	13 vjet	20 min
M03	38	F	16 vjet	30 min
M04	42	F	16 vjet	15 min
M05	36	F	14 vjet	17 min
M06	38	F	3 vjet	19 min
M07	41	F	12 vjet	30 min
M08	38	F	16 vjet	19 min
M09	38	F	15 vjet	20 min
M10	28	F	4 vjet	24 min
M11	27	F	5 vjet	18 min
M12	42	F	18 vjet	23 min
M13	38	F	14 vjet	20 min
M14	28	F	5 vjet	26 min
M15	28	F	2 vjet	30 min
M16	34	F	10 vjet	19 min
M17	27	F	3 vjet	20 min
M18	34	F	13 vjet	24 min
M19	36	F	10 vjet	30 min
M20	35	F	12 vjet	19 min

Të dhënat e paraqitura në tabelën 5 tregojnë numrin e mësime dhënëve pjesëmarrës në intervista, gjithsej 20 mësime dhënë. Të gjitha të intervistuarat janë femra, mosha e tyre varion nga 27 deri në 42 vjet, ndërsa përvoja e punës sillet nga 2 deri në 18 vjet. Në fund është paraqitur edhe kohëzgjatja e intervistës e cila paraqitet me intervale të ndryshme kohore prej 15 minuta deri në 30 minuta.

Tabela 6. Të dhënat e nxënësve pjesëmarrës në intervista

Kodi	Mosha	Gjinia	Lokacioni/ Shkolla	Numri i nxënësve në klasë
N01	10 vjeç	M	Urban/Prishtinë	19
N02	10 vjeç	M	Urban/Prishtinë	19
N03	10 vjeç	F	Urban/Prishtinë	14
N04	11 vjeç	M	Urban/Prishtinë	14
N05	11 vjeç	F	Urban/Prishtinë	45
N06	11 vjeç	F	Rural /Pejë	47
N07	11 vjeç	M	Urban/Pejë	23
N08	11 vjeç	F	Rural/Pejë	28
N09	10 vjeç	F	Rural/Pejë	28
N10	10 vjeç	M	Rural/Pejë	35
N11	10 vjeç	M	Urban/ Istog	42
N12	11 vjeç	F	Rural/ Istog	37
N13	10 vjeç	F	Urban/ Istog	44
N14	11 vjeç	M	Rural/ Istog	35
N15	11 vjeç	F	Rural/ Istog	39
N16	11 vjeç	M	Urban/ Lipjan	17
N17	10 vjeç	F	Urban/ Lipjan	26
N18	11 vjeç	F	Rural/ Lipjan	31
N19	10 vjeç	M	Urban/ Lipjan	19
N20	10 vjeç	F	Urban/ Lipjan	20

Të dhënat rreth të intervistuarve të nxënësve janë paraqitur në tabelën e mësipërme. Të gjithë pjesëmarrësit janë nxënës të klasës së pestë. Janë 11 femra dhe 9 meshkuj, mosha e tyre varion 10 – 11 vjet.

Të dhënat e paraqitura në tabelën 7 tregojnë se mosha e prindërve pjesëmarrës në intervista varion nga 35 – 47 vjet, ndërsa të intervistuar janë 4 meshkuj dhe 16 femra, ku prej tyre 7 janë amvise dhe 13 me profesione të ndryshme.

Tabela 7. Të dhënat e prindërve pjesëmarrës në intervista

Kodi	Mosha	Gjinia	Lokacioni/ Shkolla	Profesioni
P01	47 vjeç	F	Urban/Prishtinë	Inxhiniere
P02	35 vjeç	F	Urban/Prishtinë	Amvise
P03	38 vjeç	F	Urban/Prishtinë	Juriste
P04	40 vjeç	F	Urban/Prishtinë	Amvise
P05	47 vjeç	M	Urban/Prishtinë	Arkitekt
P06	45 vjeç	M	Rural /Pejë	Ekonomist
P07	39 vjeç	F	Urban/Pejë	Inferimiere
P08	35 vjeç	F	Rural/Pejë	Amvise
P09	39 vjeç	F	Rural/Pejë	Mësuese
P10	41 vjeç	M	Rural/Pejë	Amvise
P11	46 vjeç	M	Urban/ Istog	Ekonomist
P12	39 vjeç	F	Rural/ Istog	Mësuese
P13	40 vjeç	F	Urban/ Istog	Arsimtare
P14	38 vjeç	F	Rural/ Istog	Amvise
P15	44 vjeç	F	Rural/ Istog	Mësuese
P16	35 vjeç	F	Urban/ Lipjan	Amvise
P17	45 vjeç	F	Urban/ Lipjan	Mësuese
P18	47 vjeç	F	Rural/ Lipjan	Arsimtare
P19	39 vjeç	F	Urban/ Lipjan	Mësuese
P20	35 vjeç	F	Urban/ Lipjan	Amvise

3.3. Procesi i pilotimit

Për të analizuar koeficientin e besueshmërisë së instrumentit (pyetësorit), është bërë pilotimi në një mostër prej 50 respondentëve, për të cilët pasi është konfirmuar shkalla e besueshmërisë, janë përfshirë në analizën finale të të dhënave për gjithë mostrën e studimit.

Testi i besueshmërisë është realizuar për grupet e pyetjeve me shkallë të Likertit (që kryesisht masin qëndrimet e respondentëve në shkallë matëse). Grupi i parë i pyetjeve kishte nivel të besueshmërisë prej 0.949, ndërsa grupi i dytë i pyetjeve kishte nivel të besueshmërisë prej 0.865, kurse vlera mesatare e përgjithshme ishte 0.907. Pra, Cronbach Alfa tregoi një nivel të lartë të besueshmërisë për të gjitha grupet e pyetjeve dhe na mundësoi që studimi të vazhdojë tutje.

3.4. Mbledhja e të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave është realizuar nga autorja e studimit. Studimi është shtrirë në katër komuna të Kosovës, të cekura edhe më sipër. Fillimisht është kërkuar leje nga Drejtoritë Komunale për Arsim (DKA –të) dhe pas aprovimit për lejimin e hulumtimit nëpër shkolla janë kontaktuar udhëheqësit e shkollave ku do të realizohej hulumtimi, të cilët janë informuar për qëllimin e zhvillimit të hulumtimit dhe mënyrës së plotësimit të pyetësorëve. Po ashtu, respondentëve pjesëmarrës u është siguruar ruajtja e konfidencialitetit, të cilët do të plotësojnë pyetësorët si dhe janë dhënë udhëzimet e nevojshme për qëllimin dhe për mënyrën e administrimit të pyetësorëve. Më pas është caktuar koha dhe vendi i përshtatshëm për mësimdhënësit në mënyrë që të mos pengohet procesi mësimor. Para administrimit të pyetësorëve, studiuesja e hulumtimit ka siguruar pjesëmarrësit për ruajtjen e konfidencialitetit duke ua bërë të ditur se të dhënat e studimit do të përdoren vetëm për qëllime akademike.

Mësimdhënësit kishin kohë të mjaftueshme për plotësimin e pyetësorëve. Pas plotësimit pyetësorët janë dorëzuar tek autorja e studimit. Niveli i kthimit të pyetësorëve të plotësuar ishte në përqindjen maksimale. Mbledhja e të dhënave është realizuar gjatë periudhës Tetor 2019 – Mars 2020. Përveç mbledhjes së të dhënave përmes pyetësorëve, u realizuan edhe intervista me mësues të klasave të pesta, me nxënës dhe prindër të tyre.

Kriter për zgjedhjen e mësuesve ishte që mësuesit të jenë të klasës së pestë pasi ata kishin kaluar pesë vjet me praktikimin e detyrave të shtëpisë dhe kishin një përvojë në menaxhimin e detyrave të shtëpisë në klasat e tyre. Mësimdhënësit ndihmuan autoren e studimit të realizojnë intervistat me nxënës dhe prindërit e tyre. Fillimisht është caktuar koha e përshtatshme kur pjesëmarrësit ishin të gatshëm për intervista.

Procesi i intervistimit është realizuar përmes platformës “Zoom” për shkak të pandemisë Covid-19. Para fillimit të intervistimit, pjesëmarrësve u është siguruar ruajtja e anonimitetit të tyre. Po ashtu pjesëmarrësve u është kërkuar mundësia e ruajtjes së intervistës si dhe u është siguruar që intervista do të përdoret vetëm për qëllim të studimit. Intervistat zgjatën 20 – 30 minuta.

Intervistat u realizuan gjatë muajit korrik – gusht 2020. Të gjithë pjesëmarrësit në studim morën pjesë me kënaqësi në studim dhe mirëpritën iniciativën e tillë për të diskutuar rreth çështjes së detyrave të shtëpisë dhe ishin të gatshëm të kontribuonin edhe në të ardhmen për studime të tilla.

3.5. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

Për mbledhjen e të dhënave sasiore është përdorur një pyetësor i adaptuar posaçërisht për qëllimin e këtij studimi, duke kombinuar një pyetësor nga studimi i doktoratës në Universitetin Walden nga Gladys Landing-Corretjer dhe një nga Universiteti Shtetëror i Tennessee-s nga Christy E. Hoeke i cili është përshtatur dhe standardizuar për qëllimet e studimit dhe kontekstin e Kosovës.

Pyetësori ishte i ndarë në katër pjesë:

- Pjesa e parë e pyetësorit përmbante të dhënat demografike, ku pjesëmarrësit (mësimdhënësit) dhanë të dhënat për gjininë e tyre, për përvojën e tyre në mësimdhënie, zhvillimin profesional (ndjekjen e trajnimeve për detyrat e shtëpisë).
- Pjesa e dytë e pyetësorit përmbante 15 pyetje, të cilat janë shprehur me shkallë matëse të Likertit (d.m.th. 5= Pajtohem plotësisht, 4 = Pajtohem, 3 = Kam mendim neutral, 2 = Nuk pajtohem, 1 = Nuk pajtohem aspak). Pyetjet kishin për qëllim të matnin qëndrimet e pjesëmarrësve lidhur me detyrat e shtëpisë dhe efektivitetin e tyre, si për shembull: “Nxënësi fitojnë njohuri nga detyrat e shtëpisë”, “Krijojnë shprehi si vetë – disiplinimi, pavarësia, përgjegjësia personale dhe vetë – drejtimi”, “Zhvillojnë shprehi të mira të punës”, etj.
- Pjesa e tretë e pyetësorit përfshiu 13 pyetje, të cilat të shprehura në shkallë matëse të Likertit, kishin për qëllim të matnin qëndrimet e pjesëmarrësve lidhur me sfidat për implementimin e detyrave të shtëpisë, si për shembull: “Orari i shkurtër i mësimin pamundëson vlerësimin e detajuar të detyrave të shtëpisë.” “Prindërit nuk tregojnë interesim që nxënësit të kenë detyra të shtëpisë.” “Numri i madh i nxënësve në klasë vështirëson përdorimin e informatës kthyesë në klasë.” “Nxënësit nuk kryejnë detyrat e shtëpisë në mënyrë të pavarur.”.
- Pjesa e fundit e pyetësorit përfshiu 7 pyetje të përziara, të cilat kishin për qëllim matjen e perceptimeve të mësimdhënësve lidhur me përdorimin e informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë, llojet e detyrave të shtëpisë, lëndën që japin më shumë detyra të shtëpisë dhe kohën që kalojnë nxënësit në detyra të shtëpisë.

Për të kuptuar më thellë perceptimet e mësimdhënësve lidhur me detyrat e shtëpisë dhe për të përmbushur më mirë qëllimin e studimit si dhe për të sqaruar më mirë ndonjë rezultat të fituar përmes përpunimit të dhënave sasiore janë realizuar edhe intervista gjysmë të strukturuar me mësimdhënës, nxënës dhe prindër.

- Intervista me mësimdhënës përfshiu 7 pyetje. Qëllimi i këtyre pyetjeve ishte që mësimdhënësit të tregonin përvojat e tyre lidhur me detyrat e shtëpisë, qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë, zhvillimin profesional lidhur me detyrat e shtëpisë, vështirësitë gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë, përdorimin e informatës kthyesë si dhe përfshirjen e prindërve në detyrat e shtëpisë, etj (Shih, Shtojcën A).
- Intervista me nxënës përfshiu 8 pyetje. Qëllimi i intervistës ishte që nxënësit të tregonin për qëndrimet e tyre për detyrat e shtëpisë, llojet e detyrave të shtëpisë, kohën që ata kalojnë në detyra të shtëpisë, përkrahjen e prindërve në detyra të shtëpisë si dhe mënyrën e përdorimit të informatës kthyesë në detyra të shtëpisë (shih, shtojcën B).
- Intervista me prindër përfshiu 5 pyetje. Qëllimi i këtyre pyetjeve ishte që prindërit të tregojnë perceptimet e tyre për detyrat e shtëpisë si dhe faktorët implikues gjatë zbatimit të detyrave të shtëpisë që punon fëmija i tyre (Shih, Shtojcën C).

3.6. Besueshmëria e instrumenteve të studimit

Instrumenti kryesor për mbledhjen e të dhënave kuantitative të studimit ishte pyetësori i përbërë me një shkallë të tipit Likert e qëndrimeve të mësimdhënësve lidhur me pyetjet e hulumtimit. Dy vetitë më të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë gjatë përdorimit të një pyetësori ose një procedure vlerësimi janë besueshmëria dhe vlefshmëria. Besueshmëria është qëndrueshmëria e rezultateve të një pyetësori, ndërsa vlefshmëria është saktësia e konkluzioneve ose interpretimeve që bëhen nga rezultatet e provave (Johnson & Christensen, 2017). Për të matur besueshmërinë e pyetësorit është përdorur një nga masat më të përdorura të besueshmërisë në shkencat shoqërore, Cronbach Alfa (D. G. Bonet & T. A. Wright, 2014).

Testi i besueshmërisë është realizuar për grupet e pyetjeve, gjegjësisht për pyetjet ordinare (me përgjigje të renditshme apo me shkallë të Liker-it).

Tabela 8. *Cronbach Alfa Reliability Test*

Grupet e pyetjeve	Numri i variablave	Cronbach's Alpha
Opinionit i mësimdhënësve për detyrat e shtëpisë	15	0.944
Sfidat për implementimin e detyrave të shtëpisë	13	0.851
Mesatarja e nivelit të besueshmërisë		0.897

Tabela e mësipërme tregon se grupi i parë i pyetjeve ka 15 pyetje të testuara dhe nivel të besueshmërisë prej 0.944 apo 94.4% besueshmëri, kurse grupi i dytë i pyetjeve ka gjithsej 13 pyetje dhe nivel të besueshmërisë prej 0.851 apo 85.1%, kurse vlera mesatare e përgjithshme është 0.897 apo 89.7% .

3.7. Procedurat e analizës së të dhënave

3.7.1. Analiza kuantitative

Analiza e të dhënave statistikore është kryer përmes Programit Statistikor për Shkenca Sociale (SPSS 21 versionin për Windows).

Fillimisht janë aplikuar analizat përshkruese (deskriptive) të variablave të studimit, për të vazhduar me tutje me analizat inferenciale.

Analiza deskriptive është përdorur për të analizuar të dhënat demografike, opinionet e mësimdhënësve, në raport me qasjen dhe se si ata i shohin detyrat e shtëpisë, opinionin e përgjithshëm të mësimdhënësve mbi sfidat për implementimin e detyrave të shtëpisë si dhe opinionet për përdorimin e informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë, të gjitha këto të shprehura përmes frekuencave, mesatareve, devijimit standard dhe shpërndarjen e të dhënave në kategori të caktuara të variablave të studimit.

Testi i normalitetit është bërë për të identifikuar shpërndarjen e të dhënave të studimit dhe testet tjera që duhet përdorur për të vërtetuar pyetjet e hulumtimit. Ky test është realizuar përmes analizave joparametrike (Kolmogorov Smirnov dhe Shapiro Wilk), dy teste të cilat na mundësojnë të vërtetojmë shpërndarjen e të dhënave.

Testi i normalitetit është realizuar për grupin e pyetjeve që matin opinionin e mësimdhënësve për detyrat e shtëpisë; është gjetur vlera mesatare e të gjitha variablave të opinionit të mësimdhënësve për detyrat e shtëpisë dhe sfidave të përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë. Sipas këtij testi, të dhënat kanë shpërndarje jo normale.

Për të vlerësuar raportet ndërmjet variablave të studimit dhe pyetjeve hulumtuese janë përdorur kryesisht këto analiza inferenciale:

- ✓ Analiza faktoriale
- ✓ Kruskal Wallis
- ✓ Mann Whitey U-test

Analiza faktoriale është kryer për të siguruar vlefshmërinë e ndërtimit të pyetësorit, e cila vlerëson strukturën faktoriale të pyetjeve në pyetësor.

Metoda statistikore Kruskal Wallis është përdorur në rastet kur variabla e studimit ka pasur me shumë se dy kategori dhe për ta testuar atë në raport me variablën e varur për analizën e përvojës (e cila është analizë joparametrike). Në bazë të rezultateve shohim se tek opinion i përgjithshëm i mësimdhënësve kemi koeficientin e Kruskal Wallis- $H=3.018$, shkallë lirie prej 3, kurse $p\text{-value}=0.389$ e cila është më e lartë se 0.05%. Në rastin e dytë të sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë, Kruskal Wallis- $H= 6.122$, shkallë lirie prej 3 dhe $p\text{-value}=0.106$.

Mann Whitney U-test është përdorur për të vlerësuar diferencat mes variablave kategorike, si p.sh: gjinia, grupmosha, vitet e përvojës ose trajnimeve, në raport me efektivitetin dhe sfidat lidhur me detyrat e shtëpisë.

Saktësisht, në rastin e parë kemi Mann-Whitney- $U= 13.204$, kurse $p\text{-value}=.0051$ e cila është mbi nivelin e besueshmërisë prej 0.05%, e gjithashtu edhe në rastin e dytë kemi Mann-Whitney- $U = 14.760$ dhe $p\text{-value}=.778$.

3.7.2. Analiza kualitative

Analiza tematike është përdorur për analizimin e intervistave. Për t'iu përgjigjur sa më mirë pyetjeve kërkimore, përqendrimi është bazuar në identifikimin e temave nga këndvështrimet e pjesëmarrësve (mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve). Sipas Bryman (2012), analiza tematike është një nga qasjet më të përdorura për analizën e të dhënave cilësore (siç është cituar në McNulty, 2018). Kjo analizë ofron procedura të arritshme dhe sistematike për nxjerrjen e kodeve dhe temave nga të dhënat cilësore (Clarke & Braun, 2017).

Intervistat gjysmë të strukturuar janë hartuar dhe zhvilluar nga studiuesi i hulumtimit. Hulumtuesi është i interesuar në përmbajtjen e bisedës së intervistës dhe në mënyrën se si shprehen pjesëmarrësit (Matthews & Ross, 2010).

Pas transkriptimit të intervistave janë koduar të dhënat duke pasur parasysh çështjet që kanë të bëjnë me qëllimin e hulumtimit. Më pas, kodet janë grupuar në tema për të nxjerrë përfundime në lidhje me perceptimet e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve. Për të rritur vlefshmërinë e studimit, intervistat e transkriptuara u analizuan edhe nga një kolege e fakultetit dhe pas analizës u gjetën të përbashkëtat dhe dallimet, të cilat ndihmuan në krijimin e kodeve dhe temave, që kanë një rëndësi të madhe për këtë studim.

3.8. Aspekti etik

Fillimisht, për realizimin e studimit është marrë leje nga Drejtoritë Komunale për Arsim, në katër komuna (Prishtinë, Pejë, Istog, Lipjan), ku është zhvilluar studimi.

Më pas është diskutuar me drejtorët e shkollave për qëllimin e hulumtimit dhe kohën më të përshtatshme për të realizuar hulumtimin në mënyrë që të mos pengohet procesi mësimor. Pjesa hyrëse e pyetësorit shpjegonte qëllimin e hulumtimit dhe siguronte pjesëmarrësit që pyetësi është anonim e do të ruhet konfidencialiteti i tyre në përgjigjet që do t'i japin në hulumtim. Pjesëmarrësit u informuan që pjesëmarrja e tyre nuk është e detyrueshme, andaj të gjithë pjesëmarrësit kanë marrë pjesë vullnetarisht në studim.

Sa u përket intervistave me nxënës, fillimisht është kërkuar leje nga prindërit e tyre, ku prindërit paraprakisht kanë nënshkruar fletëpëlqimin për lejimin e fëmijës për të marrë pjesë në hulumtim (shih në shtojcë fletëpëlqimin). Sa u përket intervistave me mësime dhe prindër është kërkuar leje nga pjesëmarrësit përmes nënshkrimit të një fletëkonfirmimi, ku pjesëmarrësit lejojnë të bëhet incizimi i tyre përmes platformës “Zoom”. Atyre u është siguruar që biseda e tyre do të përdoret vetëm për çështjen e këtij studimi dhe më pas të dhënat e tyre do të fshihen.

KAPITULLI 4

4. REZULTATET E HULUMTIMIT

Ky kapitull paraqet rezultatet e studimit, duke filluar me paraqitjen e të dhënave demografike e duke vazhduar me analizën sasiore dhe cilësore.

4.1. Paraqitja demografike e karakteristikave të mostrës

Pyetësi është ndarë në katër pjesë. Pjesa e parë e pyetësit ka përmbajtur 7 pyetje me të dhëna demografike për gjininë, përvojën e punës së pjesëmarrësve dhe zhvillimin profesional që lidhet me detyrat e shtëpisë. Të gjitha këto të dhëna janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Siç vërehet në tabelën 9, në hulumtim kanë marrë pjesë gjithsej 366 mësime të ciklit 1-5, ku 352 prej tyre apo 96.2% ishin të gjinisë femërore dhe 14 të tjerë apo 3.8% mësime të gjinisë mashkullore. Duke marrë parasysh që në profesionin e mësimit më shumë dominon gjinia femërore, si rrjedhojë edhe në numrin e pjesëmarrësve sipas gjinisë dominon gjinia femërore.

Tabela 9. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas gjinisë

Pozita në mësime	N	%
Mësues/e i/e ciklit 1-5	366	100%
Gjinia	N	%
Femër	352	96.2
Mashkull	14	3.8

Sa i përket përvojës së punës vërehet se me përvojë 1-5 vjet ishin 89 mësime apo 24.3%, 49 mësime apo 13.4% e mësimeve me përvojë prej 6-10 vjet.

86 mësime apo 23.5% e mësimeve me përvojë 11-15 vjet dhe mbi 16 vjet përvojë morën pjesë 142 mësime apo 38.8%. Vërehet dominim i pjesëmarrësve me përvojë pune mbi 16 vjet. Mesatarja e përgjithshme e mësimeve me përvojë pune është $M = 2.77$ $SD = 1.20$.

Tabela 10. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas përvojës së punës

Përvoja ime në mësime është?	N	%
1-5 vjet	89	24.3
6-10 vjet	49	13.4
11-15 vjet	86	23.5
16 e më shumë vjet	142	38.8

$M = 2.77$, $SD = 1.20$

Shpërndarja e përqindjes lidhur me zhvillimin profesional që mësime dhënësit kanë ndjekur, rezulton të perceptohen në këtë mënyrë nga respondentët: 181 mësime dhënësit apo 48.5% e konsiderojnë zhvillimin profesional të rëndësishëm për detyrat e shtëpisë, 166 mësime dhënësit apo 45.5% mendojnë të kundërtën, ndërsa 19 mësime dhënësit apo 5.2% nuk u përgjigjen në këtë pyetje.

Mesatarja e përgjithshme e rezultateve të përgjigjeve të mësime dhënësitve lidhur me çështjen se sa zhvillimi profesional u ka ndihmuar për detyrat e shtëpisë është $M = 1.48$ $SD = .500$.

Tabela 11. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas zhvillimit profesional që i ka ndihmuar në detyrat e shtëpisë

Zhvillimi profesional që kam ndjekur më ka ndihmuar për detyrat e shtëpisë	N	%
Po	181	49.5
Jo	166	45.4
N/A	19	5.2

$M = 1.48$, $SD = .500$

Gjetjet e studimit tregojnë se shumica e mësime dhënësitve pajtohen se shkolla apo sistemi shkollor pret që mësuesit të caktojnë detyrat e shtëpisë në mënyrë të rregullt. Për këtë pajtohen 317 mësime dhënësit pjesëmarrës në hulumtim apo 86.6%, kurse 46 mësime dhënësit apo 12.6% shprehën të kundërtën, ndërsa 3 të tjerë apo 0.8% nuk janë përgjigjur. Mesatarja e përgjithshme e rezultateve të përgjigjeve të mësime dhënësitve për sistemin shkollor që shprehet që mësuesit të caktojnë detyra të shtëpisë në mënyrë të rregullt është $M = 1.13$ $SD = .333$.

Tabela 12. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas shkollës që pret mësuesit të caktojnë detyra të shtëpisë

Sipas jush shkolla/sistemi shkollor pret që mësuesit të caktojnë detyrat e shtëpisë në mënyrë të rregullt	N	%
Po	317	86.6
Jo	46	12.6
N/A	3	0.8

$M = 1.13$, $SD = .333$

Në tabelën 13, mësime dhënësit shprehen se janë të përgatitur mjaftueshëm për procesin e detyrave të shtëpisë, ku 197 mësime dhënësit apo 53.8% shprehen se pajtohen plotësisht me pohimin.

144 mësime dhënësit apo 39.9% u shprehën se pajtohen. 20 kanë mendim neutral apo 5.5%, 3 nuk pajtohen apo 0.8% dhe 1 nuk pajtohet aspak apo 0.3%. Mesatarja e përgjithshme e rezultateve të përgjigjeve të mësime dhënësitve që tregojnë përgatitjen e tyre në detyra të shtëpisë është $M = 4.46$ $SD = .664$.

Tabela 13. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas përgatitjes së tyre me detyrat e shtëpisë

Ndihem i përgatitur mjaftueshëm për procesin e detyrave të shtëpisë?	N	%
Nuk pajtohem aspak	1	0.3
Nuk pajtohem	3	0.8
Kam mendim neutral	20	5.5
Pajtohem	144	39.3
Pajtohem plotësisht	197	53.8
N/A	1	0.3

M = 4.46, SD = .664

Gjithashtu, respondentët janë pyetur nëse fakulteti i ka përgatitur mjaftueshëm për detyrat e shtëpisë (shih tabelën 14).

Nga përgjigjet e tyre shohim se 109 mesimdhënës apo 29.8% e mesimdhënësve janë shprehur se pajtohen plotësisht që fakulteti i ka përgatitur për detyrat e shtëpisë. 93 mesimdhënës apo 25.4% e mesimdhënësve thonë se pajtohen. 90 mesimdhënës apo 24.6% e mesimdhënësve janë neutralë. 42 mesimdhënës apo 11.5% e mesimdhënësve nuk pajtohen dhe 31 mesimdhënës apo 8.5% e mesimdhënësve nuk pajtohen aspak që fakulteti i ka përgatitur për detyrat e shtëpisë. Mesatarja e përgjithshme e rezultateve të përgjigjeve të mesimdhënësve që tregojnë se studimet në fakultet i kanë përgatitur mjaftueshëm për detyrat e shtëpisë është M= 3.57 SD= 1.26.

Tabela 14. Tabela e frekuencave – shpërndarja e respondentëve sipas përgatitjes së fakultetit për detyrat e shtëpisë

Studimet në fakultet më kanë përgatitur mjaftueshëm për detyrat e shtëpisë?	N	%
Nuk pajtohem aspak	31	8.5
Nuk pajtohem	42	11.5
Kam mendim neutral	90	24.6
Pajtohem	93	25.4
Pajtohem plotësisht	109	29.8
N/A	1	0.3

M = 3.57, SD = 1.26

4.2. Perceptimet e mësimeve për qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë

Në këtë pjesë është përdorur qasja përshkruese e variablave të studimit për të paraqitur opinionet e mësimeve në raport me qasjen e tyre për detyrat e shtëpisë. Nga respondentët u kërkuar të vlerësojnë qëndrimet e tyre lidhur me qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë, të cilat u vlerësuan në shkallë Likerti me 5 shkallë nga 1 (plotësisht nuk pajtohem) tek 5 (plotësisht pajtohem).

Opinionet e mësimeve për qasjen e tyre ndaj detyrave të shtëpisë janë analizuar dhe interpretuar më poshtë, bazuar në përqindjet e çdo deklaratë në 5 kategori (d.m.th. 5= Pajtohem plotësisht, 4 = Pajtohem, 3 = Kam mendim neutral, 2 = Nuk pajtohem, 1 = Nuk pajtohem aspak). Përveç përqindjeve nëpër kategori, janë paraqitur edhe mesataret dhe devijimi standard për qasjen e mësimeve lidhur me detyrat e shtëpisë.

Në bazë të rezultateve të mëposhtme, mësuesit pajtohen se nxënësit e tyre fitojnë njohuri nga detyrat e shtëpisë dhe për këtë kemi mbi 80% që pajtohen ($M=4.28$, $SD=.792$) kurse në anën tjetër shumica dërmuese mbi 75% detyrat e shtëpisë i konsiderojnë si kriter për ngritjen e arritjeve të nxënësve ($M=4.07$, $SD=.907$).

Sipas përgjigjeve të 94% të mësimeve, detyrat e shtëpisë krijojnë shprehje si vetëdisiplinimi, pavarësia, përgjegjësia personale dhe vetëdrejtimi ($M = 4.62$, $SD = .675$), ndërsa 86% e mësimeve pohojnë se detyrat e shtëpisë sfidojnë nxënësin nga ajo që është mësuar në klasë ($M= 4.39$, $D= .796$).

Perceptimet e mësimeve lidhur me zhvillimin e kreativitetit nga detyrat e shtëpisë, 87% e mësimeve theksojnë se detyrat e shtëpisë ndikojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe krijimtarisë ($M= 4.35$, $SD= .765$), kurse në pyetjen se detyrat e shtëpisë ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj shkollës e pohuan 79% e mësimeve ($M = 4.20$, $SD =.901$).

Shumica e mësimeve (86%) shprehin se detyrat e shtëpisë inkurajojnë nxënësit të zbatojnë aftësitë e mësuara në jetën e përditshme ($M = 4.33$, $SD = .809$).

Tabela 15. Shpërndarja e opinioneve të mësimeve për qasjen e tyre lidhur me qëllimin e detyrave të shtëpisë

	1	2	3	4	5	Mean	Std
Nxënësit fitojnë njohuri nga detyrat e shtëpisë.	0.3%	1.9%	13.8%	37.7%	46.3%	4.28	0.79
Janë një ndër kriteret e ngritjes së arritjeve të nxënësve.	1.1%	5.7%	13.9%	43.4%	35.8%	4.07	0.90
Janë një mënyrë efektive për të promovuar qëndrime pozitive rreth të mësuarit.	0.0%	2.5%	9.3%	44.0%	44.2%	4.30	0.73
Krijojnë shprehi si vetëdisiplinimi, pavarësia, përgjegjësia personale dhe vetë-drejtimi.	0.5%	1.1%	4.4%	24.0%	69.9%	4.62	0.67
Zhvillojnë shprehi të mira të punës.	0.8%	0.8%	4.6%	20.5%	73.2%	4.64	0.68
Ndikojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe krijimtarisë.	0.3%	2.5%	8.8%	38.9%	49.6%	4.35	0.76
Ndikojnë në zhvillimin e memorizimit të asaj që punohet në klasë.	1.1%	0.8%	5.5%	25.4%	67.2%	4.57	0.73
Vazhdim i të mësuarit që nxënësit mësojnë në shkollë.	1.1%	1.1%	3.8%	26.3%	67.7%	4.58	0.72
Përmirësojnë mësimnxënien.	0.3%	1.9%	6.8%	30.1%	60.9%	4.49	0.73
Sfidojnë nxënësit nga ajo që është mësuar në klasë.	0.5%	2.2%	9.8%	32.5%	54.9%	4.39	0.79
Inkurajojnë reflektimin rreth vetvetes tek nxënësit.	0.3%	3.6%	9.3%	39.7%	47.1%	4.30	0.80
Ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj shkollës.	1.4%	2.7%	16.1%	34.2%	45.6%	4.20	0.90
Inkurajojnë nxënësit të zbatojnë aftësitë e mësuara në jetën e përditshme.	1.1%	1.6%	10.1%	37.4%	49.7%	4.33	0.80
U sigurojnë mundësi nxënësve të përvetësojnë materialin e paraqitur në klasë.	0.3%	1.6%	7.4%	33.6%	57.1%	4.46	0.72
U mundësojnë nxënësve të integrojnë lëndët mësimore.	0.8%	3.0%	10.9%	37.4%	47.8%	4.28	0.83

4.3. Rezultatet lidhur me efektivitetin e detyrave të shtëpisë dhe qëllimin e tyre

Lidhur me pyetjen se a pajtohen mësimitdhënësit se detyrat e shtëpisë janë një mënyrë efektive për të promovuar qëndrime pozitive rreth të mësuarit, rezultatet tregojnë se 88.2 % e mësimitdhënësve pajtohen derisa pjesa tjetër kanë mendim neutral dhe nuk pajtohen ($M=4.30$, $SD= .739$).

Rezultatet tregojnë se shumica e mësimitdhënësve (93.9 %) përmes detyrave të shtëpisë presin që fëmijët të krijojnë shprehje si vetëdisiplinimi, pavarësia, përgjegjësia personale dhe vetëdrejtimi ($M=4.62$, $SD= .675$); mësimitdhënësit shprehen se përmes detyrave të shtëpisë nxënësit kanë mundësi të zhvillojnë shprehje të mira të punës ($M=4.64$, $SD= .686$), si dhe ndikojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe krijimtarsisë së tyre ($M=4.35$, $SD= .765$). Detyrat e shtëpisë, sipas mësimitdhënësve ndikojnë edhe në zhvillimin e memorizimit të asaj që punohet në klasë ($M=4.57$, $SD= .732$), si dhe vazhdim i të mësuarit që nxënësit mësojnë në shkollë ($M=4.58$, $SD= .720$).

Rezultatet tregojnë se shumica e mësimitdhënësve (91%) konsiderojnë se detyrat e shtëpisë përmirësojnë mësimitnxënien ($M=4.49$, $SD= .732$) si dhe sfidojnë nxënësit nga ajo që është mësuar në klasë ($M=4.39$, $SD= .796$). Sipas perceptimeve të mësimitdhënësve, konsiderohet se përmes detyrave të shtëpisë ndikohet në inkurajimin dhe reflektimin rreth vetvetes të nxënësit ($M=4.30$, $SD= .803$), si dhe përkrahjen nxënësit të zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj shkollës ($M=4.20$, $SD= .901$). Po ashtu, shumica e mësimitdhënësve (87.1%) shprehen se detyrat e shtëpisë inkurajojnë nxënësit të zbatojnë aftësitë e të mësuarit në jetën e përditshme ($M=4.33$, $SD= .809$) dhe se u mundësojnë nxënësve të integrojnë lëndët mësimore ($M=4.28$, $SD= .838$).

4.4. Perceptimet e mësimitdhënësve rreth sfidave për implementimin e detyrave të shtëpisë

Rezultatet e mëposhtme shfaqin perceptimet e përgjithshme të mësimitdhënësve mbi sfidat për implementimin e detyrave të shtëpisë. Nga rezultatet e hulumtimit mund të kuptohet se:

58.4 % e mësimitdhënësve shprehen se nuk ka kohë të mjaftueshme për përpilimin e detyrave të shtëpisë ($M= 3.49$, $SD = 1.08$). Pra, duke marrë parasysh që në shkolla punohet me orar të shkurtër, mësimitdhënësit nuk kanë kohë të mjaftueshme të krijojnë detyrat e shtëpisë. Në të shumtën e rasteve, ata detyrohen që detyrat t'i përgatitin paraprakisht në shtëpi pasi krijimi i detyrave të shtëpisë në shkollë, u merr kohën e nevojshme për orë mësimore.

Nga 366 respondentë, 77.8% e tyre theksojnë si sfidë përpilimin e detyrave të shtëpisë bazuar jo vetëm në mesataren e klasës, por në mënyrë individuale përshtatur aftësive psiko-fizike të secilit nxënësi ($M= 4.02$, $SD = .922$). Padyshim që numri i madh i nxënësve në klasë dhe niveli jo i njëjtë i njohurive është një sfidë në vete pasi caktimi i detyrave të njëjta për të gjithë klasën nuk garanton sukses të njëjtë për të gjithë nxënësit.

Shumica e mësimitdhënësve (80.8%) shprehen se ka numër të madh të nxënësve në klasa dhe se kjo ndikon në krijimin e vështirësisë për përdorimin e informatës kthyesë në klasë (M= 4.16, SD= 1.01).

Tabela 16. Perceptimet e mësimitdhënësve rreth sfidave për implementimin e detyrave të shtëpisë

	1	2	3	4	5	Mean	Std
Mungesa e kohës për përpilimin e detyrave të shtëpisë.	4.9%	15.8%	20.8%	42.6%	15.8%	3.49	1.08
Përpilimi i detyrave bazuar jo vetëm në mesataren e klasës por në mënyrë individuale përshtatur aftësi psiko – fizike të secilit.	1.6%	5.5%	15.1%	44.8%	33.0%	4.02	0.92
Numri i madh i nxënësve në klasë vështirëson përdorimin e informatës kthyesë në klasë.	3.0%	5.5%	10.7%	34.4%	46.4%	4.16	1.01
Orari i shkurtër i mësimit pamundëson vlerësimin e detajuar të detyrave të shtëpisë.	6.0%	9.6%	11.8%	33.0%	39.6%	3.90	1.19
Nxënësit nuk kryejnë detyrat e shtëpisë në mënyrë të pavarur.	3.0%	12.1%	18.9%	39.7%	26.3%	3.74	1.06
Nxënësit kopjojnë përgjigjet e detyrave të shtëpisë nga shokët e klasës.	8.5%	17.6%	29.4%	29.9%	14.6%	3.24	1.15
Vështirësia për të bërë vlerësimin në funksion të motivimit të nxënësve për mësim.	3.6%	10.1%	28.5%	40.5%	17.3%	3.58	1.00
Pamundësia për të bërë dhe kthyer informatën kthyesë me kohë.	4.7%	14.3%	23.9%	38.5%	18.7%	3.52	1.09
Prindërit nuk tregojnë interesim që nxënësit të kenë detyra të shtëpisë.	6.6%	19.2%	28.2%	27.1%	18.9%	3.33	1.17
Detyrat e shtëpisë shkaktojnë tension në shtëpi.	12.1%	19.2%	26.6%	23.0%	19.2%	3.18	1.28
Detyrat e shtëpisë u marrin kohën e lirë nxënësve.	20.1%	27.7%	20.3%	17.9%	14.0%	2.78	1.33
Mungesa e mjeteve (kompjuter) dhe materialeve (fjalor ose burime tjera) në shtëpi shihet si sfidë në kryerjen e detyrave të shtëpisë.	9.8%	22.1%	22.1%	27.6%	18.3%	3.22	1.25
Fëmijët të cilët kanë prindër me shkollim më të ulët nuk marrin mbështetje nga prindërit në detyrat e shtëpisë.	6.6%	18.6%	20.2%	29.5%	25.1%	3.48	1.23

Rezultatet e studimit tregojnë se shkollat kanë orar të shkurtër të mësimit, gjë që ndikon në pamundësinë e vlerësimit të detajuar të detyrave të shtëpisë. Këtë e theksojnë 72.6% e mësimitdhënësve (M = 3.90, SD= 1.19); po ashtu, rezultatet nxjerrin në pah se nxënësit nuk po i kryejnë detyrat e shtëpisë

në mënyrë të pavarur ($M = 3.74$, $SD = 1.06$). Gjetjet e studimit potencojnë se nxënësit kopjojnë detyrat e shtëpisë nga shokët e klasës ($M = 3.24$, $SD = 1.15$). Mësimdhënësit e konsiderojnë se kanë vështirësi edhe në vlerësimin e nxënësve në funksion të motivimit të nxënësve për mësim ($M = 3.58$, $SD = 1.00$) si dhe pamundësi për të dhënë informatë kthyesë me gojë ($M = 3.52$, $SD = 1.09$).

Rezultatet japin indikacione për mësimdhënësit që nuk janë të kënaqur me qasjen e prindërve në raport me detyrat e shtëpisë e që konsiderohen se janë jo bashkëpunues ($M = 3.33$, $SD = 1.17$), pasi detyrat e shtëpisë po shkaktojnë tension në shtëpi ($M = 3.18$, $SD = 1.28$). Sipas rezultateve të mësimdhënësve, konsiderohet se detyrat e shtëpisë u marrin kohën e lirë nxënësve, por këtu perceptimet e mësimdhënësve janë të ndara, duke reflektuar këto përqindje: 31.9% e mësimdhënësve pajtohen, 20.3% kanë mendim neutral dhe 47.8% nuk pajtohen ($M = 2.78$, $SD = 1.33$). Perceptimet e mësimdhënësve lidhur me çështjen nëse mungesa e mjeteve të teknologjisë informative, materialeve në shtëpi konsiderohet si sfidë për kryerjen e detyrave të shtëpisë, ndërsa rezultatet tregojnë se 45.9% pajtohen derisa pjesa tjetër kanë mendim neutral dhe nuk pajtohen ($M = 3.22$, $SD = 1.25$). Nga 366 të anketuar, 54.6% e tyre po konsiderojnë se prindërit të cilët kanë shkollim më të ulët janë më pak të interesuar për t'i ndihmuar fëmijët e tyre ($M = 3.48$, $SD = 1.23$).

4.5. Perceptimet e mësimdhënësve rreth përdorimit të informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë

Pjesëmarrësit janë pyetur nëse japin informatë kthyesë në detyrat e shtëpisë dhe rezultatet e studimit tregojnë se 95.9% e tyre japin informatë kthyesë në detyrat e shtëpisë, ndërsa pjesa tjetër deklarojnë se nuk japin informata kthyesë në detyrat e shtëpisë.

Tabela 17. Perceptimet e mësimdhënësve rreth dhënies së informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë

A jepni informatë kthyesë në detyrat e shtëpisë?	N	%
Po	351	95.9
Jo	10	2.7
N/A	5	1.4

Në pyetjen se ku fokusohen më shumë gjatë dhënies së informatës kthyesë (shih tab.18), gjetjet e studimit tregojnë se shumica e mësimdhënësve (70%) shprehen se fokusohen në korrigjimin e gabimeve pastaj mbi 45% shprehen se fokusohen në cilësinë e përgjithshme, ndërsa 32% thonë në pikat e forta dhe mbi 45% në fushat ku duhet zhvilluar.

Tabela 18. Perceptimet e mësimitdhënësve rreth çështjes ku fokusohen më së shumti gjatë përdorimit të informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë

	Po	Jo
Nëse jepni informatë kthyesë tregoni se ku fokusoheni më shumë (ju mund të zgjidhni më shumë se një opsion):	%	%
Korrigjim i gabimeve	73.8	26.2
Cilësia e përgjithshme	47.0	53.0
Pikat e forta	32.8	67.2
Fushat ku duhet zhvilluar	48.4	51.6

Sipas rezultateve të modalitetit të informatës kthyesë, kuptohet se informatat kthyesë për detyra të shtëpisë i japin përmes shkrimit 85% e mësimitdhënësve, ndërsa 55% e mësimitdhënësve deklarojnë se japin informatë kthyesë në mënyrë verbale, me notë më shumë se 23% e mësimitdhënësve dhe përmes formave të tjera afër 10% e mësimitdhënësve.

Tabela 19. Perceptimet e mësimitdhënësve rreth mënyrës së përdorimit të informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë

	Po	Jo
Informatën kthyesë në detyrat e shtëpisë e jap (ju mund të zgjedhni më shumë se një opsion):	%	%
Me notë	23.8	76.2
Me shkrim	85.0	15.0
Me gojë/verbalisht	54.4	45.6
Tjetër	9.6	90.4

Tabela 20 paraqet perceptimet e mësimitdhënësve për lëndët që japin më shumë detyra të shtëpisë. Gjetjet e studimit tregojnë se lëndët në të cilat jepen më tepër detyrat janë *Gjuha shqipe* me rreth 65% të mësimitdhënësve të cilët e konsiderojnë shumë të rëndësishme, 67.0% (shumica) e mësimitdhënësve e konsiderojnë po ashtu *Matematikën* si lëndë të dytë për nga rëndësia dhe voluminoziteti i detyrave të shtëpisë, kurse 86% e mësimitdhënësve lëndën *Njeriu dhe natyra* e rendisin të tretën. Lëndën e *Historisë* dhe lëndët e tjera i vlerësojnë në nivelin e katërt dhe më pak të rëndësishme (shih tabelën 20). Siç po vërehet *Gjuha shqipe* dhe *Matematika* janë të renditura si më shumë të rëndësishme, ndërsa lëndët e tjera (Shoqëria dhe mjedisi, Arti figurativ, Edukata muzikore, Shkathtësi për jetë) si më pak të rëndësishme. Në veçanti, lëndët e shkathtësive nuk po vërehen si pjesë e rëndësishme e detyrave të shtëpisë. Ashtu sikurse lëndët bazë që janë *Gjuha shqipe* dhe *Matematika*, edhe lëndët e shkathtësive duhet të zënë një vend të rëndësishëm në detyrat e shtëpisë.

Tabela 20. *Perceptimet e mësimitdhënësve për lëndët që japin më shumë detyra të shtëpisë*

Lëndët që ju jepni më shumë detyra të shtëpisë:	Shumë e rëndësishme	E dyta	E treta	E katërta	Më pak e rëndësishme
	%	%	%	%	%
Gjuhë shqipe	68.2	28.0	0.6	1.2	2.1
Matematikë	29.2	67.0	0.6	2.1	1.2
Njeriu dhe natyra	0.0	2.1	86.7	9.4	1.8
Histori	0.0	2.6	6.5	51.0	39.9
Lëndë të tjera	3.6	0.0	6.9	37.3	52.3

Në pyetjen për llojet e detyrave që mësimitdhënësit përfshijnë gjatë dhënies së detyrave të shtëpisë nga rezultatet mund të kuptojmë 73.2% e mësimitdhënësve japin detyra logjike. Sipas rezultateve, 69.1% e mësimitdhënësve janë shprehur se japin fletë pune, ndërsa 68.9% e mësimitdhënësve japin detyra në drejtshkrim, përderisa 66.4% e mësimitdhënësve japin detyra në lexim.

Sipas rezultateve, 61% e mësimitdhënësve detyrat e shtëpisë i japin në fushën e komentimit, ndërsa 48.9% e mësimitdhënësve japin projekte si format i detyrave të shtëpisë, ndërsa forma të tjera të detyrave janë shprehur që japin 9.6 % e mësimitdhënësve.

Tabela 21. *Perceptimet e mësimitdhënësve për llojet e detyrave që përfshihen në detyrat e shtëpisë*

Detyrat e shtëpisë që ju jepni përfshijnë:	Po	Jo
Lexim	66.4%	33.6%
Drejtshkrim	68.9%	31.1%
Projekte	48.9%	51.1%
Detyra Logjike	73.2%	26.8%
Komentim	61.5%	38.5%
Krijime	52.7%	47.3%
Fletë pune	69.1%	30.9%
Tjetër	9.6%	90.4%

4.6. Perceptimet e mësimdhënësve rreth kohës që kalojnë nxënësit në detyra të shtëpisë

Në tabelën 22 janë paraqitur perceptimet e mësimdhënësve për kohën që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë. Mësimdhënësit shprehen se pothuajse 4 apo 5 ditë u japin detyra të shtëpisë, saktësisht 41.3% thonë se u japin detyra 4 ditë në javë, kurse 37.4% rreth 5 herë në ditë, kurse përqindja tjetër thonë se u japin 1 deri 3 herë në javë. Mesatarja e përgjithshme e rezultateve të përgjigjeve të mësimdhënësve për caktimin e detyrave të shtëpisë gjatë një jave shkollore është $M = 5.09$ $SD = .905$.

Tabela 22. Perceptimet e mësimdhënësve për caktimin e detyrave të shtëpisë gjatë një jave shkollore

Gjatë një jave shkollore, sa shpesh caktoni detyra të shtëpisë?	N	%
1 ditë në javë	3	0.8
2 ditë në javë	21	5.7
3 ditë në javë	54	14.8
4 ditë në javë	151	41.3
5 ditë në javë	137	37.4

$M = 5.09, SD = .905$

Lidhur me pyetjen rreth kohës për të cilën ata e konsiderojnë se fëmijët punojnë për detyra të shtëpisë, rezultatet nxjerrin në pah intervalin kohor mes 30-45 minuta në ditë për të cilin janë deklaruar rreth 60.1% e mësimdhënësve, rreth 26.5% e mësimdhënësve pohojnë për intervalin kohor 1 - 1½ orë, kurse pjesa tjetër, 6.8%, thonë 5-15 minuta dhe 4.6% e mësimdhënësve janë shprehur për intervalin kohor rreth 2-2 ½ orë. Mesatarja e përgjithshme e rezultateve të përgjigjeve të mësimdhënësve për kohën që nxënësit e kalojnë në detyra të shtëpisë gjatë ditës është $M = 2.86$ $SD = 7.17$.

Tabela 23. Perceptimet e mësimdhënësve për kohën që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë

Sa kohë mendoni se nxënësit tuaj në ditën kur kanë detyra të shtëpisë kalojnë duke kryer një detyrë shtëpie?	N	%
5 - 15 minuta	25	6.8
30 - 45 minuta	220	60.1
1 - 1½ orë	97	26.5
2 - 2½ orë	17	4.6
Tjetër	5	1.4
N/A	2	0.5

$M = 2.86, SD = 7.17$

4.7. Rezultatet e Testit të Normalitetit për variablat e studimit

Testi i Normalitetit përcakton nëse të dhënat tona kanë shpërndarje normale/parametrike apo jo-normale/joparametrike, ndërsa kjo shpërndarje na dikton edhe testet që duhen përdorur për të vërtetuar pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit. Për të vërtetuar shpërndarjen e të dhënave, është përdorur testi i Kolmogorov Smirnov dhe Shapiro Wilk. Testi i Normalitetit është realizuar për tre variablat e studimit dhe rezultatet tregojnë se në bazë të vlerave, shpërndarja e të dhënave është jo normale, duke treguar sinjifikancë statistikore vlerën nën 0.05 (më saktësisht vlerat e gjetura janë 0.00 dhe 0.002 ($p > 0.5$)).

Tabela 24. Rezultatet e Testit të Normalitetit për variablat e studimit

Tests of Normality

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	df	Sig.	Statistic	df	Sig.
Opinion i përgjithshëm i mësimdhënësve	0.148	366	0.000	0.849	366	0.000
Sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë	0.067	366	0.000	0.987	366	0.002

a. Lilliefors Significance Correction
 Shpërndarje normale është kur p value $\geq 0.05\%$
Shpërndarje jo-normale është kur p value $< 0.05\%$

Para fillimit të testeve për të vërtetuar pyetjet e hulumtimit është bërë grupimi i pyetjeve në tri kategori kryesore: sfidat; qasja dhe në veçoritë personale dhe profesionale.

Për të arritur deri tek variabla e pavarur e sfidave që mësimdhënësit hasin është realizuar analiza faktoriale e cila ka mundësuar të verifikohet se cila prej ndryshoreve është e fortë, pra cila prej ndryshoreve-variablave paraqet koeficient më të lartë dhe në sa komponentë po klasifikohen sfidat.




Figura 5. Grupimi i pyetjeve të pyetësorit në tri kategori kryesore

Rezultatet e tabelës së mëposhtme tregojnë se $KMO = 1.410.804$, shkallë të lirisë prej 78 dhe $p\text{-value} = .000$ e cila është brenda kufirit të besueshmërisë prej 0.01%.

Tabela 25. Rezultatet e testit KMO dhe Bartlett për pyetësin e sfidave

<i>KMO and Bartlett's Test</i>		
Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		0.856
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	1,410.804
	Df	78
	Sig.	0.000

Në bazë të rezultateve të tabelës së mëposhtme kuptojmë se vetëm dy komponentë kanë kaluar vlerën 1.00 të Eigenvalue, e cila përcakton numrin e faktorëve apo komponentëve. Saktësisht komponenti parë ka vlerën 4.719, kurse i dyti 1.527 për të konfirmuar homogjenitetin e pyetjeve të pyetësit. Për të matur rëndësinë e ndryshoreve/variablave, është përcaktuar një nivel më i fortë i koeficientit i cili duhet të jetë mbi 0.60 për t'u vlerësuar si ndryshore/variabël e rëndësishme.

Tabela 26. Analiza faktoriale e shkallës për pyetësin lidhur me sfidat e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë

Component	Initial Eigenvalues			Extraction Sums of Squared Loadings			Rotation Sums of Squared Loadings		
	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %
	1	4.719	36.303	36.303	4.719	36.303	36.303	3.273	25.178
2	1.527	11.743	48.046	1.527	11.743	48.046	2.973	22.868	48.046
3	0.981	7.549	55.595						
4	0.942	7.245	62.840						
5	0.807	6.207	69.047						
6	0.735	5.652	74.700						
7	0.595	4.579	79.279						
8	0.564	4.338	83.617						
9	0.542	4.167	87.783						
10	0.513	3.947	91.730						
11	0.416	3.201	94.931						
12	0.357	2.750	97.681						
13	0.301	2.319	100.000						

Rotated Component Matrix^a

	Component	
	1	2
Mungesa e kohës për përpilimin e detyrave të shtëpisë.	0.257	0.560
Përpilimi i detyrave bazuar jo vetëm në mesataren e klasës por në mënyrë individuale përshtatur aftësive psiko – fizike të secilit.	-0.032	0.687
Numri i madh i nxënësve në klasë vështirëson përdorimin e informatës kthyesë në klasë.	0.043	0.792
Orari i shkurtër i mësimit pamundëson vlerësimin e detajuar të detyrave të shtëpisë.	0.193	0.653
Nxënësit nuk kryejnë detyrat e shtëpisë në mënyrë të pavarur.	0.415	0.481
Nxënësit kopjojnë përgjigjet e detyrave të shtëpisë nga shokët e klasës.	0.598	0.169
Vështirësia për të bërë vlerësimin në funksion të motivimit të nxënësve për mësim.	0.355	0.591
Pamundësia për të bërë dhe kthyer informatën kthyesë me kohë.	0.436	0.617
Prindërit nuk tregojnë interesim që nxënësit të kenë detyra të shtëpisë.	0.659	0.245
Detyrat e shtëpisë shkaktojnë tension në shtëpi.	0.770	0.144
Detyrat e shtëpisë u marrin kohën e lirë nxënësve.	0.715	0.065
Mungesa e mjeteve (kompjuter) dhe materialeve (fjalor ose burime tjera) në shtëpi shihet si sfidë në kryerjen e detyrave të shtëpisë.	0.672	0.213
Fëmijët të cilët kanë prindër me shkollim më të ulët nuk marrin mbështetje nga prindërit në detyrat e shtëpisë.	0.575	0.114

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Rotation Method: Varimax ëith Kaiser Normalization.

a. Rotation converged in 3 iterations.

Siç mund të shohim edhe nga rezultatet në tabelën e mësipërme, komponentin e parë mund ta emërtojmë si: Mungesa e bashkëpunimit në mes prindërve – nxënësve dhe marrja e kohës së lirë të nxënësve për t'u involvuar në detyra të shtëpisë. Pra, sipas mësimdhënësve, prindërit nuk janë shumë bashkëpunues me fëmijët e tyre për t'i përfunduar detyrat e shtëpisë në kohën e duhur apo ashtu si duhet. Si ndryshore të rëndësishme që janë klasifikuar në këtë komponent janë: Prindërit nuk tregojnë interesim që nxënësit të kenë detyra të shtëpisë (0.659); Detyrat e shtëpisë shkaktojnë tension në shtëpi (0.770); Detyrat e shtëpisë u marrin kohën e lirë nxënësve (0.715) dhe Mungesa e mjeteve (kompjuter) dhe materialeve (fjalor ose burime tjera) në shtëpi shihet si sfidë në kryerjen e detyrave të shtëpisë (0.672). Në bazë të kontekstit të ndryshoreve mund të konkludohet se komponenti kryesor i ka renditur/përfshirë sfidat të cilat kanë të bëjnë direkt me interesimin e prindërve për bashkëpunim, në kuadër të detyrave të shtëpisë, mungesa e komunikimit brenda prindërve dhe nxënësve, pastaj pamundësinë që krijojnë detyrat e shtëpisë që nxënësit të kenë kohë të lirë për argëtim, mungesa e

pajisjeve të teknologjisë informative dhe niveli i ulët i edukimit të prindërve ndikon direkt dhe indirekt në suksesin e nxënësve.

Bazuar në përgjigjet e respondentëve, komponenti i dytë është emërtuar si: Mungesë e informatës kthyesë. Ka shumë arsye që ndikojnë të mësimdhënësit që informata kthyesë të mos jepet në kohën e duhur. Në këtë komponent janë klasifikuar si ndryshore me vlerë: Pamundësia për të kthyer informatën kthyesë me kohë (0.617); Orari i shkurtër i mësimit pamundëson vlerësimin e detajuar të detyrave të shtëpisë (0.653); Përpilimi i detyrave bazuar jo vetëm në mesataren e klasës por në mënyrë individuale përshtatur aftësive psiko – fizike të secilit (0.687) dhe Numri i madh i nxënësve në klasë vështirëson përdorimin e informatës kthyesë në klasë (0.792), të cilat kanë të bëjnë direkt me numrin e madh të nxënësve nëpër klasë. Ky numër i madh shkakton problem në vlerësimin e nxënësve pastaj pamundësia e përpilimit të detyrave në aspekte të tjera përveç asaj mesatares, koha e shkurtër e orës mësimore për të vlerësuar nxënësit dhe pamundësia për të kthyer mesazhin vlerësuar për secilin nxënë, ndoshta në mënyrën e duhur.

Rezultatet e tabelës së mëposhtme tregojnë se $KMO=3.545$, shkallë të lirisë prej 105 dhe $p\text{ value}=.000$ e cila është brenda kufirit të besueshmërisë prej 0.01%.

Tabela 27. Rezultatet e testit *KMO* dhe *Barlett* për pyetësorin e qasjes së mësimdhënësve

<i>KMO and Bartlett's Test</i>		
Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		0.944
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	3,545.605
	Df	105
	Sig.	0.000

Në bazë të rezultateve të tabelës së mëposhtme kuptojmë se vetëm dy komponentë kanë kaluar vlerën 1.00 të Eigenvalue, e cila përcakton numrin e faktorëve apo komponentëve. Saktësisht komponenti i parë ka vlerën 8.443, kurse i dyti 1.093.

Tabela 28. Analiza faktoriale e shkallës për pyetësonin lidhur me qasjen e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë

Total Variance Explained

Component	Initial Eigenvalues			Extraction Sums of Squared Loadings			Rotation Sums of Squared Loadings		
	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %
	1	8.443	56.289	56.289	8.443	56.289	56.289	5.569	37.125
2	1.093	7.288	63.577	1.093	7.288	63.577	3.968	26.452	63.577
3	0.850	5.668	69.245						
4	0.599	3.993	73.238						
5	0.567	3.782	77.019						
6	0.517	3.446	80.465						
7	0.475	3.164	83.629						
8	0.453	3.023	86.652						
9	0.362	2.415	89.067						
10	0.348	2.319	91.386						
11	0.301	2.010	93.396						
12	0.281	1.874	95.270						
13	0.271	1.810	97.080						
14	0.224	1.491	98.571						
15	0.214	1.429	100.000						

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Rotated Component Matrix^a

	Component	
	1	2
Nxënësit fitojnë njohuri nga detyrat e shtëpisë.	0.586	0.393
Janë një ndër kriteret e ngritjes së arritjeve të nxënësve.	0.684	0.342
Janë një mënyrë efektive për të promovuar qëndrime pozitive rreth të mësuarit.	0.626	0.404
Krijojnë shprehi si vetëdisiplinimi, pavarësia, përgjegjësia personale dhe vetëdrejtimi.	0.307	0.747
Zhvillojnë shprehi të mira të punës.	0.281	0.833
Ndikojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe krijimtarisë.	0.545	0.552
Ndikojnë në zhvillimin e memorizimit të asaj që punohet në klasë.	0.245	0.763
Vazhdim i të mësuarit që nxënësit mësojnë në shkollë.	0.376	0.740
Përmirësojnë mësimnxënien.	0.584	0.504
Sfidojnë nxënësit nga ajo që është mësuar në klasë.	0.733	0.249
Inkurajojnë reflektimin rreth vetvetes tek nxënësit.	0.753	0.262
Ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj shkollës.	0.769	0.258
Inkurajojnë nxënësit të zbatojnë aftësitë e mësuara në jetën e përditshme.	0.789	0.326
U sigurojnë mundësi nxënësve të përvetësojnë materialin e paraqitur në klasë.	0.641	0.466
U mundësojnë nxënësve të integrojnë lëndët mësimore.	0.789	0.268

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Rotation Method: Varimax with Kaiser Normalization.

a. Rotation converged in 3 iterations.

Në bazë të rezultateve të mësipërme shohim se komponentin e parë mund ta emërtojmë si: Përvetësim i aftësive të mësuara në shkollë.

Mësimdhënësit paraqesin shumë faktorë për të arsytuar përse ata japin detyra të shtëpisë. Andaj edhe janë klasifikuar si të rëndësishme ndryshoret: Janë një ndër kriteret e ngritjes së arritjeve të nxënësve (0.684); Janë një mënyrë efektive për të promovuar qëndrime pozitive rreth të mësuarit (0.626); Sfidojnë nxënësit nga ajo që është mësuar në klasë (0.733); Inkurajojnë reflektimin rreth vetvetes te nxënësit (0.753); Ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj shkollës (0.769); Inkurajojnë nxënësit të zbatojnë aftësitë e mësuara në jetën e përditshme (0.789); U sigurojnë mundësi nxënësve të përvetësojnë materialin e paraqitur në klasë (0.641); U mundësojnë nxënësve të integrojnë lëndët mësimore (0.789); U sigurojnë mundësi nxënësve të përvetësojnë materialin e paraqitur në klasë (0.641); U mundësojnë nxënësve të integrojnë lëndët mësimore me koeficient (0.789).

Komponenti i dytë është emërtuar si zhvillim personal pasi faktorët që janë klasifikuar si të rëndësishëm na bëjnë të të konkludojmë se detyrat e shtëpisë krijojnë shprehi të punës dhe përgjegjësi të nxënësit. Në komponentin e dytë janë klasifikuar komponentë si të rëndësishme: Krijojnë shprehi si vetëdisiplinimi, pavarësia, përgjegjësia personale dhe vetëdrejtimi (0.747); Ndikojnë në zhvillimin e memorizimit të asaj që punohet në klasë (0.763); Zhvillojnë shprehi të mira të punës (0.833); Vazhdim i të mësuarit që nxënësit mësojnë në shkollë (0.740). Ky komponent ka një rëndësi shumë të madhe për nxënësit pasi përmes këtyre qëllimeve ata duhet të vetëdijesohen se kanë përgjegjësi për detyrat e dhëna nga mësimdhënësit dhe mësojnë që mësimi nuk ndodh vetëm në shkollë, por mund të ndodhë në shtëpi dhe kudo tjetër.

Për të matur veçoritë profesionale dhe personale të mësimdhënësve janë shfrytëzuar si variabla kontrolluese ato demografike si (përvoja dhe zhvillimi profesional). Për të arritur deri te rezultatet, është përdorur metoda statistikore Kruskal Wallis për analizën e përvojës kurse Mann Whitney U-test – (Independent Sample test) është përdorur për të analizuar dimensionin e zhvillimit profesional në raport me perceptimet dhe sfidat që kanë mësimdhënësit lidhur me detyrat e shtëpisë.

Variabla të pavarura janë *Përvoja dhe Zhvillimi profesional*, kurse ato të varura janë *mesatarja e përgjithshme e perceptimeve të mësimdhënësve, sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë*.

Tabela 29. Dallimet e mesatareve lidhur me opinionet dhe sfidat gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë në raport me përvojën e mësimdhënësve

<i>Ranks</i>			
	Përvoja ime në mësimdhënie është?	N	Mean Rank
Opinionit i përgjithshëm i mësimdhënësve	1-5 vjet	89	195.72
	6-10 vjet	49	163.15
	11-15 vjet	86	182.99
	16 e më shumë vjet	142	183.17
	Total	366	
Sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë	1-5 vjet	89	197.33
	6-10 vjet	49	152.83
	11-15 vjet	86	190.71
	16 e më shumë vite	142	181.05
	Total	366	

Në bazë të rezultateve të mëposhtme shohim se tek opinionit i përgjithshëm i mësimdhënësve koeficienti i Kruskal Wallis është $H=3.018$, shkallë lirie prej 3, kurse $p\text{-value}=0.389$ e cila është më e lartë se 0.05%. Në këtë rast, rezultatet theksojnë se nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm sinjifikant në mes të përvojës së mësimdhënësve dhe opinionit të tyre në raport me detyrat e shtëpisë.

Në rastin e dytë, te sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë, Kruskal Wallis- $H= 6.122$, shkallë lirie prej 3 dhe $p\text{-value}=0.106$, pra edhe në këtë rast, rezultatet tregojnë se nuk ka dallime të rëndësishme sinjifikante në mes të përvojës së punës së mësimdhënësve dhe opinionit të tyre mbi sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë.

Tabela 30. Rezultatet e testit Kruskal Wallis: Dallimet në përvojën e mësimitdhënësve dhe opinionin e sfidat e mësimitdhënësve për detyrat e shtëpisë

<i>Test Statistics^{a,b}</i>		
	Opinionin i përgjithshëm i mësimitdhënësve	Sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë
Kruskal-Wallis H	3.018	6.122
Df	3	3
Asymp. Sig.	0.389	0.106

a. Kruskal Wallis Test

b. Grouping Variable: Përvoja ime në mësimitdhënie është?

Në pjesën e mëposhtme është analizuar dallimi në mes të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe opinionit të tyre për detyrat e shtëpisë dhe sfidave të përgjithshme për detyrat e shtëpisë. Pra, këtu është bërë dallimi në mes të mësimitdhënësve që janë shprehur se zhvillimi profesional i ka ndihmuar për detyrat e shtëpisë dhe atyre që kanë shprehur të kundërtën.

Tabela 31. Dallimi i mesatareve lidhur me opinionin dhe sfidat e mësimitdhënësve për detyrat e shtëpisë në raport me zhvillimin profesional të tyre

<i>Ranks</i>				
	Zhvillimi profesional që kam ndjekur më ka ndihmuar për detyrat e shtëpisë	N	Mean Rank	Sum of Ranks
Opinionin i përgjithshëm i mësimitdhënësve	Po	181	184.05	33,312.50
	Jo	166	163.05	27,065.50
	Total	347		
Sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë	Po	181	172.55	31,231.50
	Jo	166	175.58	29,146.50
	Total	347		

Rezultatet e mëposhtme përmes analizës Mann Whitney-U-test, tregojnë se në asnjërin prej rasteve nuk është gjetur dallim i rëndësishëm sinjifikant.

Saktësisht në rastin e parë kemi Mann-Whitney-U= 13.204, kurse p-value=.0051 e cila është mbi nivelin e besueshmërisë prej 0.05%, e gjithashtu edhe në rastin e dytë kemi Mann-Whitney-U = 14.760 dhe p-value=.778, rezultate që nuk paraqesin dallim sinjifikant mes këtyre kategorive të variablave.

Tabela 32. Rezultatet e testit Mann – Whitney U: Dallimet lidhur me zhvillimin profesional të mësimeve dhe opinionin e sfidat e mësimeve për detyrat e shtëpisë

<i>Test Statistics^a</i>		
	Opinionin i përgjithshëm i mësimeve	Sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë
Mann-Whitney U	13,204.500	14,760.500
Wilcoxon W	27,065.500	31,231.500
Z	-1.953	-0.281
Asymp. Sig. (2-tailed)	0.051	0.778

a. Grouping Variable: Zhvillimi profesional që kam ndjekur më ka ndihmuar për detyrat e shtëpisë

4.8. Analiza kualitative

Në këtë pjesë është paraqitur analiza cilësore e të dhënave. Gjetjet nga intervistat janë paraqitur në tri pjesë: intervistat me mësues, intervistat me prindër dhe intervistat me nxënës.

4.9. Gjetjet nga intervistat me mësues

Tabela 33 paraqet një përmbledhje të temave që dalin nga intervistat me mësues lidhur me përgatitjen e tyre profesionale për të caktuar detyra të shtëpisë, qëllimet e dhënies së detyrave të shtëpisë, sfidat e tyre gjatë praktikimit të detyrave të shtëpisë, mënyrën e përdorimit të informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë si dhe rolin e bashkëpunimit me prindër.

Janë identifikuar tetë tema të rëndësishme për studimin, si:

- Mungesa e një standardi në shkollë për planifikimin e detyrave të shtëpisë;
- Mungesa e zhvillimit profesional për detyra të shtëpisë;
- Ngarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë;
- Krijimi i shprehjes së punës dhe zhvillimi i njohurive;
- Informata kthyesë si ndihmë për të përforcuar njohuritë;
- Llojet e detyrave të shtëpisë;
- Përshtatja e detyrave të shtëpisë sipas nivelit të njohurive të nxënësve;
- Pikëpamje kundërtë të mësimeve për bashkëpunimin me prindër;

Tabela 33. Kodet dhe temat që rrjedhin nga analiza tematike e të dhënave të intervistës me mësuesit

Kodet	Temat
<p>Shkolla nuk na imponon të japim detyra të shtëpisë.</p> <p>Detyrat e shtëpisë, përzgjedhje individuale e mësueses.</p> <p>Detyrat janë vendim individual i mësueses.</p> <p>Nuk ka rregulla të shkruara për caktimin e detyrave të shtëpisë.</p> <p>Mësuesja si përcaktuese e ngarkesës dhe llojit të detyrave.</p> <p>Mundohemi si aktiv t’i japim detyrat njëjtë.</p> <p>Secila mësuese jep detyra për klasën e vet.</p> <p>Drejtorja nuk na obligon për detyra të shtëpisë.</p> <p>Detyrat e shtëpisë janë pavarësi e mësueses.</p> <p>Jemi vetë të lirë të japim detyra të shtëpisë.</p> <p>Sa kërkojnë prindërit japim detyra.</p> <p>Shkolla nuk ka standard për detyra të shtëpisë.</p> <p>As prej DKA, as prej MASHTI – nuk ka standard për detyra të shtëpisë.</p>	<p>Mungesë e një standardi në shkolla për planifikimin e detyrave të shtëpisë</p>
<p>Nuk kemi ndjekur trajnime për detyra të shtëpisë.</p> <p>Trajnimi MKLSH “miks trajnimesh”</p> <p>Trajnimi i KKK</p> <p>Në master diskutim për detyra të shtëpisë.</p> <p>Trajnimi <i>Aplikimi i TIKUT në mësim.</i></p>	<p>Mungesë e zhvillimit profesional për detyra të shtëpisë</p>
<p>Detyra të tepërta.</p> <p>Stres të tepërt.</p> <p>Fëmijë të stresuar.</p> <p>Nuk jam ihtarë e detyrave të shtëpisë.</p> <p>Sa më pak ngarkesë.</p> <p>S’kam dëshirë me i ngarku fëmijët me detyra të shtëpisë.</p> <p>Detyrat e shtëpisë për vikend janë ngarkesë për nxënësit.</p> <p>Detyrat si ngarkesë nëse nuk kënaqen duke i bërë.</p>	<p>Ngarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë</p>

Detyra e shtëpisë i jap që nxënësi me u bë i pavarur.

Me fitu shprehi të punës.

Të jenë më të përgatitur për të ardhmen.

Të angazhohen fëmijët me detyra të shtëpisë.

Fëmija të ketë përgjegjësi duke punuar detyra të shtëpisë.

Për të ushtruar më shumë.

Përsëritja e mësimëve.

Përforsim i njësive të mësuara.

Angazhim shtesë.

Rikujtim i njësive se çfarë është mësuar në klasë.

Me i zgjeru njohuritë.

Zgjerohet horizonti i nxënësve.

Të hulumtohet më shumë.

Plotësim i asaj që mësojnë në shkollë.

Rrisin të nxënit dhe të mësuarit.

Të zhvillohet kreativiteti.

Për t'i vlerësuar nxënësit.

Për një rezultat më të mirë.

Verifikim i përparimit të nxënësve.

Feedback.

Për t'i motivuar nxënësit.

Korrigjim i përmbajtjes.

Korrigjim për drejtshkrim.

Korrigjim për gramatikë.

Korrigjim në fushat ku duhet zhvilluar.

Theksim i gabimeve.

Lëvdata për motivim.

Lëvdata e pastaj kritika.

Lëvdata për bukurshkrim.

Fokusohe në cilësi.

Pikat më të mira i potencoj.

Puna kreative.

Më shumë informata me gojë.

E gjithë klasa i përmirësojnë përnjëherë.

Kontrollë frontale.

I kontrolloj në shtëpi.

Nuk më premtan kohë në klasë.

I kthej të nesërmen pasi i kontrolloj në shtëpi.

Numër shumë i madh i nxënësve në klasë.

Krijimi i shprehisë së punës dhe zhvillimi i njohurive

Informata kthyesë si ndihmë për të përforcuar njohuritë

Detyrat me bazë lojën, argëtimin.
Detyra si formë e testimi të nivelit të të
kuptuarit të njësisë mësimore nga nxënësit.
Detyra si nxitje vullneti e jo krijim i
monotonisë.
Detyra nga të gjitha fushat.
Hulumtim i shkurtër.
Detyra të integruara.
Projekte të ndryshme.
Detyra problemore.
Zhvillimi i të menduarit kritik – anagrame,
fjalëkryqe.
Detyra të shtëpisë për t'u argëtuar.
Detyra të shtëpisë për t'u kënaqur.
Detyra sa më atraktive.

Llojet e detyrave të shtëpisë

Detyra të shtëpisë për të gjithë nxënësit.
Ndarja e detyrave për nxënës të mirë dhe të
më pak të mirë.
Përshtatja e detyrave për të gjithë nxënësit.
Niveli jo i barabartë i nxënësve.
Detyrat e përbashkëta.
Përshtatja e detyrave me nivelin e nxënësve.
Krijimi i detyrave të shtëpisë.
Numri i detyrave.
Për sa kohë të jepen detyra (dilema).
Sa detyra të shtëpisë janë të mjaftueshme.
Gjatë përpilimit të detyrave has në
vështirësi.
Përgatitja e detyrave të ndryshme për
klasën.
Kushtet ekonomike.
Mungesa e internetit për hulumtim.
Mungesa e printerit për kopje.
Mungesa e kompjuterit.

Përshtatja e detyrave të shtëpisë sipas nivelit të njohurive të nxënësve

Prindërit nuk ndajnë shumë kohë për fëmijët
e tyre.
Goxha shqetësuese mbështetja e prindërve
për detyrat e shtëpisë.
Prindërit ankohen për detyra të shtëpisë.
Shumë pak bashkëpunojmë me prindër
pavarësisht që insistojmë.
Ngarkesa ditore e prindërve minimizon
kohën që ata të përkushtohen.
Prindërit vlerësojnë detyrat si barrë.
Akuza nga prindërit për ngarkesën në detyra

Pikëpamje kundërthënëse të mësimdhënësve për bashkëpunimin me prindër

Mospërfshirja e prindërve dhe mospërkushtimi shumë shqetësues.
Bashkëpunim shumë të mirë me prindër.
Bashkëpunim të vazhdueshëm me prindër.
Bashkëpunim shumë të fortë.
Prindërit lirshëm diskutojnë me mësuesen detyrat e shtëpisë.
Prindërit ndonjëherë hasin në vështirësi se si t'i kryjnë detyrat e shtëpisë.
Duhet sqarime shtesë pasi prindërit nuk i kuptojnë detyrat.
Niveli i shkollimit të prindërve është pengesë për të kuptuar detyrat e shtëpisë.
Roli i prindërve minimal në të kuptuarit e nivelit të fëmijëve në mësimnxënie.

4.9.1. Mungesë e një standardi në shkolla për planifikimin e detyrave të shtëpisë

Bazuar në përgjigjet e mësimdhënësve nëse në shkollat ku ata punojnë kanë ndonjë dokument apo rregullore se si duhet mësimdhënësit të caktojnë detyrat e shtëpisë në nivel shkolle, shkolla nuk posedon asnjë plan apo standard për caktimin e detyrave të shtëpisë. Sipas tyre, ata janë të lirë të caktojnë detyrat e shtëpisë ashtu siç kanë dëshirë pasi shkolla nuk i obligon të japin detyra të shtëpisë. Detyrat e shtëpisë mbesin përgjegjësi e mësimdhënësit. Mësimdhënësit mund të caktojnë edhe kohën që nxënësi duhet të ketë për detyra të shtëpisë, llojet e detyrave të shtëpisë, mënyrën e përdorimit të informatës kthyesë si dhe përfshirjen e prindërve në detyra të shtëpisë.

Ja disa nga mendimet e mësuesve:

Nuk ka ndonjë rregull të shkruar për caktimin e detyrave të shtëpisë, andaj ne jemi që përcaktojmë detyrat e shtëpisë (Mësuesja, 4).

Shkolla nuk ka standard. Po se mu lidh në mënyrë zingjirë nuk kemi, as prej ministrisë e as prej DKA-së dhe as prej kurrikulës, po të gjitha ato nënkuptohen. Domethanë, ti prej krejt aty ki me marrë lloj përgjegjësie se a duhet t'japësh detyra dhe a nuk duhet të japësh detyra (Mësuesja, 12).

Prej shkollës nuk e kemi obligim, ne jemi t'liira si dojmë vetë (Mësuesja, 7).

Në asnjë dokument nuk është gjetur ndonjë plan ose ndonjë rregull i shkruar për mënyrën se si mësimdhënësit të caktojnë detyra të shtëpisë. As në Kornizën e Kurrikulës nuk hasim ndonjë gjë specifike lidhur me mënyrën se si mësimdhënësit duhet të praktikojnë detyrat e shtëpisë përveçse vlerësimi formativ të përdoret në detyra të shtëpisë. Për këtë arsye edhe shumica e mësimdhënësve

hezitojnë kur caktojnë detyra të shtëpisë pasi nuk kanë asnjë standard nga shkolla për mënyrën e dhënies së detyrave të shtëpisë e në veçanti për kohën që nxënësit duhet të kenë detyra të shtëpisë. Shumë studime tregojnë për rëndësinë e politikës së detyrave të shtëpisë (Cooper, 1994, Skaggs, 2007). Derisa mungon një plan për caktimin e detyrave të shtëpisë mund të hasim në vështirësi për menaxhimin e detyrave të shtëpisë në nivelin fillor. Sipas Epstein & Voorhis (2001), mund të përcaktohet nga drejtorët e shkollave apo ekipet arsimore për kohën që nxënësit duhet të jenë të ngarkuar me detyra të shtëpisë (siç është cituar në Peltier, 2011).

Një grup hulumtuesish (Merritt et al., 2015), hulumtuan nëpër shkolla për politikën e detyrave të shtëpisë dhe identifikuan se shumë shkolla kanë politika shumë të qarta rreth caktimit të detyrave të shtëpisë, por ka edhe shkolla të cilat nuk kanë politika të qarta ose nuk kanë fare. Një hulumtim tjetër ka korrelacion me këtë hulumtim pasi në shkolla mungon një politikë për detyrat e shtëpisë si dhe ka njohuri të gabuara midis prindërve dhe mësuesve rreth politikave të detyrave të shtëpisë (Holland et al., 2021). Politikëbërësit duhet të bëjnë kujdes në caktimin e politikave për detyrat e shtëpisë pasi me një dokument të qartë nëpër shkolla, puna dhe përgjegjësia e mësimit duhet të jetë më e lehtë. Përveç kësaj, nxënësit dhe prindërit do të jenë më të informuar dhe më të përgatitur për përgjegjësitë e tyre lidhur me detyrat e shtëpisë.

4.9.2. Mungesë e zhvillimit profesional për detyra të shtëpisë

Mësimdhënësit vazhdimisht janë zhvilluar profesionalisht duke ndjekur trajnime të ndryshme. Edhe pse mësimdhënësit kanë ndjekur trajnime të shumta për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies në klasa, ata nuk janë të trajnuar për caktimin e detyrave të shtëpisë. Nga 20 mësimdhënës, 5 prej tyre pohojnë se trajnimi i MKLSH-së (Të menduarit kritik gjatë shkrimit – leximit), i ka ndihmuar deri diku që ata të përdorin teknika të ndryshme gjatë krijimit të detyrave të shtëpisë sipas Taksonomisë së Blumit. Po ashtu edhe trajnimi për Kurrikulën e Re, u ka ndihmuar që detyrat t'i bëjnë sa më atraktive për nxënësit. Megjithatë mësimdhënësit nuk e shohin të mjaftueshme përgatitjen e tyre për detyra të shtëpisë. Si rrjedhojë, mësimdhënësit shpeshherë kanë edhe dilema për caktimin e detyrave të shtëpisë duke filluar nga përshtatja e detyrave të shtëpisë për gjithë klasën, koha që nxënësit duhet të kalojnë në detyra, dhënia e informatës kthyesë e deri te bashkëpunimi me prindër.

Më poshtë janë disa mendime të mësuesve për këtë temë:

Për fat të keq asnjëherë s'kam pas rastin me ndjek trajnime enkas për detyrat e shtëpisë, po as edhe ndonjë trajnim tjetër nuk është që janë përmend nëpër trajnime kryesisht detyrat e shtëpisë, si m'i formulu ose pse me i dhënë detyrat ose edhe bash kish me qenë ide e mirë për me pas trajnime të tilla, m'u fokusu pikërisht te detyrat e shtëpisë (Mësuesja, 12).

Trajnim t' veçantë për detyrat e shtëpisë jo, por po e marrë ni shembull, trajnimi i fundit "Korniza kurrikulare" që ka qenë, m'ka ndihmu në përpilimin e detyrave t'shtëpisë sesi duhet t'përshtaten detyrat të grupmoshave të nxënësve, që detyrat duhet të jenë sa më atraktive për nxënësit, gjithashtu t'u përshtaten kompetencave që na dëshirojmë m'i arrit. Këto kanë qenë disa, që m'kanë ndihmu për detyrat e shtëpisë (Mësuesja, 3).

Ndonjë trajnim specifik për detyra të shtëpisë nuk kam ndjek, as diçka trajnime që më kanë ndihmu në detyrat e shtëpisë (Mësuesja, 8).

Në fakt, nuk po muj me mendu ndonjë prej trajnimeve që mu m'ka ndihmu me i mendu ose me i apliku detyrat e shtëpisë, po zakonisht unë prej të gjitha trajnimeve që i kom ndjek jam mundu me kriju një "miks trajnimi" që unë me përdor, me iu përshtat nxanësve të mi t'klasës. Se na e dimë që asnjëherë trajnime ose aktivitete ose çkado qoftë që na e kemi mësu në trajnime, na nuk mundemi me e përdor në klasa tona ashtu siç na është thënë (Mësuesja, 16).

Shumica e këtyre mësimeve tregojnë interesim dhe shprehin dëshirën për t'u zhvilluar profesionalisht lidhur me detyrat e shtëpisë dhe mëposht është një nga mendimet e mësueses për t'u zhvilluar profesionalisht lidhur me detyrat e shtëpisë:

"Kish me qenë ide e mirë për me pas trajnime të tilla, m'u fokusu pikërisht te detyrat e shtëpisë. Kështu që për fat të keq, s'kam ndjek asnjëherë, asnjë lloj trajnimi (Mësuesja, 15).

Sipas Landing - Corretjer (2009), ekziston një nevojë kritike për zhvillimin profesional të mësimeve për hartimin e detyrave të shtëpisë. Sipas studimit të autorit, 50% e pjesëmarrësve nga studimi i realizuar janë trajnuar për detyra të shtëpisë, ndërsa 50 % të tjerë nuk janë trajnuar për detyra të shtëpisë. Pjesa e trajnuar e mësimeve nuk i ngarkojnë shumë nxënësit me detyra të shtëpisë, më shumë japin detyra të shtëpisë në formë të projekteve të cilat i preferojnë edhe nxënësit. Një tjetër studim e sheh si shumë të nevojshëm që mësimeve të trajnohen lidhur me mënyrën se si duhet të komunikojnë me prindërit lidhur me ndihmën që ata duhet të ua ofrojnë fëmijëve të tyre gjatë punimit të detyrave të shtëpisë (Merritt et al., 2015).

Edhe Hoeke (2017) mbështet zhvillimin profesional të mësimeve. Ajo këshillon se shkollat përveç politikës që duhet ta kenë për detyra të shtëpisë, mësimeve duhet t'u ofrohet mundësia për zhvillim profesional lidhur me detyrat e shtëpisë.

Derisa mungon një standard në shkolla dhe zhvillimi profesional lidhur me detyrat e shtëpisë, sigurisht që edhe mësimeve por edhe nxënësit e prindërit e tyre do të kenë sfida dhe dilema të shumta lidhur me detyrat e shtëpisë.

4.9.3. Ngarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë

Një temë mjaft shqetësuese që doli nga intervistat me mësues është edhe ngarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë. Shumica e mësimitdhënësve shprehen se nxënësit janë shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë. Sipas tyre, nxënësit janë shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë pasi kanë shumë detyra të shtëpisë. Kjo ngarkesë me detyra të tepërta, ua merr edhe kohën e lirë nxënësve. Përveç kësaj, shumë mësimitdhënës japin detyra të shtëpisë edhe vikendeve dhe ditëve të festave, të cilat nuk sjellin shumë kënaqësi por stres te fëmijët.

Ja disa nga mendimet e mësueseve lidhur me detyrat e shtëpisë:

“Detyrat e shpisë... a din sa herë e diskutojmë me koleget se kem disa që thojnë nuk duhet me jep detyra t’shpisë e unë jom mes ktyne që duhet po jo shumë, mos m’i ngarku” (Mësuesja, 7).

“Tash krejt varet prej rastiit, çfarë detyra jipen edhe kur jipen detyrat e shtëpisë. Në qoftëse dikur i jep në vikend atëherë për mu është ngarkesë, lodhje, angazhim shtesë. Në qoftëse jipen gjatë ditëve të javës, për mu është kënaqësi edhe përforcim i njohurive që janë marrë paraprakisht në klasë. Gjithmonë tu u mundu që fmitë mos me qenë shumë të ngarkum sepse e dimë që planprogramin e kemi tejet të ngarkum që ka raste që për fëmijët është shumë ngarkesë edhe natyrisht që nuk ndjen kënaqësi. Në momentin që fëmija punon edhe nuk kënaqet gjatë përfundimit të detyrave të shtëpisë, atëherë për mu është vetëm ngarkesë psikologjike edhe nuk ka kurrfarë cilësie me arritë te fëmija” (Mësuesja, 11).

“Po, unë në fillim e kam diskutu, nuk më ka pëlqy mënyra se në fillim unë kam shku me një aktiv ku jon kanë shumë tradicionale edhe mu nuk më ka pëlqy mënyra qysh japin detyra edhe gjithmonë e kam vërejt që japin shumë detyra, ekstrem shumë, edhe japin ma shumë detyra përshkruese, p.sh: përshkruje tregimin, mu nuk më ka pëlqy qajo. Edhe e kom pa në fillim që po më shikojnë ashtu sikur diçka krejt ndryshe edhe e kom pa se ato kanë rutinën e tyne. Nuk bashkëpunojmë hiç për detyra” (Mësuesja, 7).

Kjo temë nuk është edhe për t’u befasuar derisa në shkolla nuk ekziston një standard për kohën që nxënësit duhet të ngarkohen me detyra të shtëpisë dhe mësimitdhënësve u mungon zhvillimi profesional lidhur me detyra të shtëpisë, padyshim që edhe nxënësit janë të ngarkuar me detyra të shtëpisë. Sipas Epstein & Voorhis (2001), politika e shkollës duhet të bashkëveprojë edhe me prindërit për të shikuar kohën që prindërit kanë mundësi të ndihmojnë fëmijët e tyre në detyra të shtëpisë. Ka shkolla që caktojnë detyra të shtëpisë vetëm gjatë ditëve të javës për të zvogëluar mundësitë e ndërveprimit prindër – fëmijë.

Është shumë e rëndësishme edhe bashkëpunimi me kolegët e shkollës për të diskutuar dhe shkëmbyer përvojat e tyre lidhur me detyrat e shtëpisë, gjë e cila nga intervistat me prindër nuk shkon ashtu si

duhet. Bashkëpunimi i mirëfilltë me kolegë është shumë i dobishëm pasi edhe në rastin e ngarkesës së nxënësve me detyra të shtëpisë do të lehtësonte punën e nxënësve në detyra të shtëpisë.

4.9.4. Krijimi i shprehisë së punës dhe zhvillimi i njohurive

Nga përgjigjet e mësimdhënësve dalin shumë tema interesante për qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë. Gjetjet e këtij studimi për qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë janë të ngjashme me literaturën ekzistuese. Mësimdhënësit japin detyra të shtëpisë për shumë arsye. Sipas shumicës së mësimdhënësve arsyeja që japin detyra të shtëpisë është që fëmija të angazhohet në detyra të shtëpisë për të fituar shprehi të punës si dhe për t'u bërë i pavarur. Krijimi i shprehisë së punës dhe pavarësisë ka një rëndësi shumë të madhe për çdo fëmijë. Një arsye tjetër që mësimdhënësit japin detyra të shtëpisë është për të krijuar përgjegjësi për detyrën e dhënë. Sigurisht që nxënësit derisa kanë detyra të shtëpisë kanë edhe përgjegjësi për t'i punuar ato. Krijimi i përgjegjësisë në këtë moshë e përgatit mjaft shumë nxënësin edhe për të ardhmen. Kur një person ka përgjegjësi për detyrat që i takojnë padyshim që edhe suksesi nuk do të mungojë. Arsyeja tjetër që disa mësimdhënës japin detyra të shtëpisë është për të vlerësuar njohuritë e nxënësve përmes detyrave të shtëpisë.

Ja disa nga mendimet e mësimdhënësve lidhur me arsyet që japin detyra të shtëpisë:

Qëllimi kryesor është që fëmija me fitu shprehi pune, me kon i pavarur gjatë kohës që i punon ato. (Mësuesja, 18).

Zakonisht detyrat e shtëpisë i jap me ditë që fëmija do të thotë ka një përgjegjësi, do të thotë me ditë që ai duhet me kry një detyrë, dhe me kriju një shprehi të punës. Zakonisht kjo është arsyeja se pse jap detyra të shtëpisë. (Mësuesja, 7).

Qëllimi i detyrave të shtëpisë duhet të jetë lehtësim i mëtejshëm i mësimin, zhvillim i aftësive organizative, nxënësit të bëhen të disiplinuar dhe të pavarur (Hancock, 2001; Voorhis, 2004). Sipas mësuesve, një tjetër arsye që ata japin detyra të shtëpisë është që nxënësit të ushtrojnë më shumë për një rezultat më të mirë si dhe për verifikuar përparimin e nxënësve. Përsëritja e mësimave dhe vlerësimi i nxënësve është përmendur nga shumica e mësuesve si qëllim për dhënien e detyrave të shtëpisë.

Sigurisht që arsyeja e parë është edhe përforsimi. Ky është një ndër faktorët, ndërsa pos edhe përforsimit të asaj, shpeshherë ne edhe përmes detyrës së shtëpisë vërejmë nëse është arrit, nëse kemi arrit t'jemi t'qartë gjatë procesit mësimor, d.m.th. duke i mar rezultatet e detyrave t'shtëpisë ne vetëm e vërejmë nëse kemi arrit t'jemi t'qartë me shpjegimet që i kemi dhënë n'klasë. Kjo është d.m.th. edhe një feedback ta quj për veten, për vetë punën tonë (Mësuesja, 2).

Zakonisht ju jap detyra t'shtëpisë se janë të dobishme për nxënësit. Ato, zakonisht mendoj që e rrisin të nxënit dhe të mësuarit. Zhvillojnë aftësitë që mësohen në klasë edhe zakonisht i përdori për verifikimin e përparimit t'nxënësve në mësim (Mësuesja, 11).

Një pjesë e mësimeve theksojnë se japin detyra të shtëpisë me qëllim të zgjerimit të njohurive dhe zhvillimit të kreativitetit. Sipas tyre, përmes detyrave atraktive që kanë bazë lojën, nxënësit të kënaqen duke punuar detyrat e të njëjtën kohë të nxiten për hulumtim.

Asnjëherë ngarkesë, asnjëherë detyra të cilat nuk janë atraktive për fëmijë. Mundohem që detyrat e shtëpisë me u dhanë në atë mënyrë që fëmija me u argëtu gjatë kohës kur ai bon detyra ose ajo i bon detyrat. Edhe mëson po edhe argëtohet, asnjëherë ngarkesë për ta. (Mësuesja, 6).

Mundona me dhanë detyra që janë motivuese ose tërheqëse për fmitë ose detyrat t'cilat fmitë i bon kureshtarë me mësu diçka për me e arrit qat rezultat edhe ma shumë me qenë "Learning by doing" dmth varet krejt prej njësisë po mundohem me dhanë detyra atraktive për fmi edhe shumë të vogla, të thjeshta ose ndonjë detyrë hulumtuese për me motivu fminë edhe me mbajt kureshtar, përndryshe detyra riprodhuese që janë ose që japin mësueset vetëm shkruje këtë ose shkruje atë, që riprodhojnë vazhdimisht, ato për mu s'janë detyra (Mësuesja, 13).

Rreth 7 mësimeve pohojnë për qëllimin e detyrave të shtëpisë si arsye për të plotësuar më shumë atë që kanë mësuar në shkollë, por gjithmonë në formë të lojës dhe detyrave sa më kreative. Qëllimi i detyrave të shtëpisë duhet të jetë sa më shumë praktik që nxënësit i zbatojnë në jetën e përditshme pasi në të kundërtën ata nuk do të kenë motiv për t'i punuar ato. Nëse detyrat e shtëpisë nuk janë interesante për nxënës dhe nuk nxisin hulumtim, nxënësit do të punojnë detyrat vetëm sa për të thënë se kanë punuar detyrat. Po ashtu detyrat të cilat nxisin hulumtim, zhvillojnë kreativitetin dhe imagjinatën i bëjnë edhe më efektive ato detyra.

4.9.5. Informata kthyesë si ndihmë për të përfunduar njohuritë

Bazuar në mendimet e mësimeve, informatën kthyesë në detyra të shtëpisë e japin me qëllim të përfundimit të njohurive. Sipas tyre, fokusi më i madh i tyre është në korrigjimin e gabimeve, në drejtshkrim, përmbajtje si dhe në fushat ku duhet zhvilluar. Përveç kësaj ata fokusohen edhe në pika më të forta si dhe në punën kreative.

Tash varësisht prej lëndëve, n'gjuhë shqipe fokusohem n'drejtskrim, d.m.th. gramatika e kto që hyjnë, varësisht se çka kanë mësuar edhe u kthej informata kthyesë se në çka kanë nevojë ose si do të mund ta përmirësonin atë që është e nevojshme për ta (Mësuesja, 3). Te nxënësit që kanë nevojë për korrigjim, jap informatë kthyesë se në cilat vende kanë nevojë për përmirësim ata, por gjithashtu edhe te nxënësit e mirë jap ndonjë koment për motivim t'mëtejme të tyre (Mësuesja, 14).

Derisa mësimeve caktojnë detyra të shtëpisë, ata duhet edhe të vlerësojnë punën e nxënësve. Sipas Costa et al. (2017), detyrat e shtëpisë gjithmonë duhet të korrigjohen, pasi kjo përfundon rëndësinë dhe dobinë e perceptuar të detyrave të shtëpisë nga nxënësit.

Pavarësisht që mësuesit japin detyra të shtëpisë, shumica e tyre theksojnë se e kanë të pamundur të japin informatë kthyese me kohë. Për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasë dhe orarit të shkurtër, ata detyrohen të japin informatë kthyese me gojë ose të marrin detyrat në shtëpi për t'i kontrolluar. Ja disa nga mendimet e mësuesve për përdorimin e informatës kthyese në detyrat e shtëpisë: *Nëse nuk na premtan koha krejt varet tashti n'publik, n'shkolla publike sa e kemi kohën. Nëse e kom kohën n'dispozicion me shkrim gjithsesi, nëse e shoh vetën që nuk kam kohë, ju thom leni përmbi, gjithë përmbi bank, i marr edhe i kontrolloj domethanë kur kanë pauza ose në shtëpi (Mësuesja, 8). Po tash numri i madh i nxënësve ta vështirëson atë që ti me ja përshtat taman fmisë çka ka nevojë ai. Normal, na thamë që secili fmi osht i veçantë edhe mson ndryshe, detyrat i bon ndryshe, ti normal që ke qef pikat e dohta me ua përmirësu ose me ua përforcu t'mirat, varësisht prej nxënësit, e qekjo osht ma e keqja që ty nuk ta lejon me ju ndihmu çka kanë nevojë ata, po diqysh si shabllon, si tanë perniherë. Qekjo ma e keqja (Mësuesja, 19).*

Kur nxënësit marrin informatë kthyese konstruktive, do të mësojnë edhe më shumë dhe do të ndihen më të rëndësishëm, prandaj derisa mësuesit japin detyra të shtëpisë duhet të gjejnë kohën dhe mundësinë për të dhënë informata kthyese me gojë ose me shkrim.

4.9.6. Llojet e detyrave të shtëpisë

Një tjetër temë mjaft interesante që doli nga intervistat me mësuesit është *llojet e detyrave të shtëpisë*. Sipas përgjigjeve të shumicës së mësuesve ata japin detyra adekuate që nxënësit të punojnë në shtëpi. Detyra të shtëpisë për t'u kënaqur e argëtuar, detyra nga të gjitha fushat, detyra problemore e të integruara, projekte të ndryshme si dhe detyra që zhvillojnë të menduarit kritik. Ja disa nga mendimet e mësuesve për stilin e detyrave të shtëpisë: *“Varet, varet edhe prej njësisë, çka kem njësi msimore gjatë javës, qysh lidhen ato njana me tjetrën. Po kombinim, shpesh ju jap edhe vetë, domethanë që i boj vetë detyrat. Shpesh edhe nga libri, domethanë varet qysh përshtaten mbrenda qasaj jave. Domethanë nuk e kom gjithmonë ni mnyrë t' detyrave po kombinim tyre” (Mësuesja, 18). “Tash krejt varet prej rastit, çfarë detyra jipen edhe kur jipen detyrat e shtëpisë. Në qoftëse dikur i jep në vikend atëherë për mu është ngarkesë, lodhje, angazhim shtesë. Në qoftëse jipen gjatë ditëve të javës, për mu është kënaqësi edhe përforcim i njohurive që janë marrë paraprakisht në klasë. Gjithmonë tu u mundu që fmitë mos me qenë shumë të ngarkum sepse e dimë që planprogramin e kemi tejet të ngarkum që ka raste që për fëmijët është shumë ngarkesë edhe natyrisht që nuk ndjen kënaqësi. Zakonisht jap detyra problemore ose detyra të integruara” (Mësuesja, 4). “Gjithmonë mundona që t'jenë detyrat e shtëpisë sa ma t'kapshme, sa mat, t'jenë, domethanë sa ma zbavitse që të zhvillohet kreativiteti edhe t'jenë sa mat dashne, që ato detyra kur t'përfundohen prej fëmijës, t'jenë t'lehta, t'jenë t'kapshme dhe t'jenë zbavitse.” (Mësuesja, 9).*

Mënyra apo llojet e detyrave të shtëpisë që japin mësimdhënësit ka një rol shumë të rëndësishëm për motivimin e nxënësve për t'i punuar ato detyra. Nëse vërtet mësimdhënësit japin detyra që sjellin kënaqësi, zhvillojnë kreativitetin apo edhe projekte hulumtuese atëherë padyshim që edhe nxënësit do t'i punojnë ato. Në të kundërtën, përshkrimi i një faqeje libri, vazhdimi i detyrave të klasës apo memorizimi i vjershave të ndryshme vërtet do të jenë shumë irituese për nxënësit që t'i punojnë me dëshirë.

4.9.7. Nevoja e përshtatjes së detyrave të shtëpisë sipas nivelit të nxënësve

Mësimdhënësit u pyetën lidhur me vështirësitë që ata kanë gjatë caktimit të detyrave të shtëpisë për nxënësit, shumica e tyre u përgjigj se caktimi i detyrave të shtëpisë për të gjithë nxënësit njësoj vazhdon të jetë një sfidë e tyre pasi jo të gjithë nxënësit në klasë posedojnë njohuri të njëjta.

“Po vështirësitë më të mëdha të formulimi i detyrave të shtëpisë apo hartimi i detyrave të shtëpisë është fakti se si me i përmbledh të gjitha stilet e të nxënësve. D.m.th. në duke e ditë që kemi nxënës të ndryshëm, të niveleve të ndryshme apo me stile të ndryshme të të nxënësve, në shpeshherë mundohemi që kërkesat tona t'i përfshijnë të gjithë nxënësit” (Mësuesja, 19).

“ Zakonisht, vështirësi për detyrat e shtëpisë është se unë nuk mundem me i përgatit një palë detyra për krejt klasën. Duhet me iu përshtat nxënësve se disa janë më mbrapa në mësim edhe nuk janë n'gjendje me i bë detyrat që i bëjnë edhe të tjerët e në këtë rast osht edhe numri i madh i nxënësve edhe n'klasë nevojat e tyre janë të ndryshme edhe n'këtë rast vështirësohet pak puna e detyrave të shtëpisë, përpilimi i tyre” (Mësuesja, 13).

“Nganjëherë kam vështirësi për t'iu përshtatur nivelit të moshës së nxënësve. Vetëm kjo më duket vështirësi “ (Mësuesja, 5).

Përveç vështirësive në përpilim të detyrave, një tjetër sfidë që e shohin mësimdhënësit është numri i detyrave, pra sa detyra të caktohen për një ditë që fëmijët të mos ngarkohen me detyra. Nga 20 mësimdhënësit, 15 prej tyre e pohojnë se caktimi i numrit të detyrave është sfidë për ta pasi nuk janë të sigurt sa detyra janë të mjaftueshme për nivelin e nxënësve që ata japin mësim.

“Ndonjëherë të numri i detyrave, p.sh.: sa detyra me iu dhënë fëmijëve, sa janë të mjaftueshme ose mos janë të tepërta. Ndonjëherë edhe të niveli i fëmijëve, sepse jo krejt klasa është nivel i barabartë të nxënësve, kështu që po duhet me i balancu detyrat, me qenë të përshtatshme edhe për ata që kanë vështirësi në të nxënë edhe për të tjerët që janë në një nivel më të theksun, më të mirë në mësim. Kështu që ndonjëherë aty mund të kem vështirësi të kombinimi i detyrave, me i përshtat për nivelin e klasës” (Mësuesja, 20).

Një sfidë tjetër që e shohin 7 nga 20 mësimdhënësit e intervistuar janë kushtet ekonomike. Sipas tyre shpesh herë mungesa e teknologjisë pamundëson që nxënësit të angazhohen në ndonjë projekt

hulumtues apo ndonjë detyrë ku nevojitet qasja në internet pasi jo të gjithë nxënësit posedojnë kushte të mira ekonomike duke filluar nga mungesa e kompjuterit e deri të qasja në internet. Në këto raste, mësimdhënësit nuk kanë mundësi që të angazhojnë nxënësit në detyra me karakter hulumtues. Ja edhe disa nga mendimet e mësimdhënësve për mungesën e teknologjisë:

“Po ma shumë teknologjia, si vështirësi që mungon në shkollë sidomos edhe printeri, qeto senet elementare që po jon që t’gjitha po duhet vet, domethanë m’i bo se jo që kem ndonjë mbështetje prej shkollës ose diçka” (Mësuesja, 11).

“Nëse u jep për shembull n’internet me hulumtu diçka, e di që disa i preku sepse nuk e kanë noshta as ndihmën e prindërve, ndoshta edhe as kushtet ekonomike, me pas kompjuter ose qasje në internet” (Mësuesja, 18).

“Kom pas vështirësi sesa i përshtatet kushteve, a mundet punë hulumtuese ose qoftë edhe punë dore nëse iu kom dhanë me punu diçka, a ka mundësi kushtesh” (Mësuesja, 3).

4.9.8. Pikëpamje kundërthënëse të mësimdhënësve për bashkëpunimin me prindër

Në pyetjen e mësimdhënësve lidhur me bashkëpunimin me prindër, përgjigjet e tyre i gjejmë të ndara, 11 mësimdhënës pohojnë se kanë bashkëpunim shumë të mirë me prindër, bashkëpunim të vazhdueshëm dhe janë shumë të lirë të diskutojnë detyrat e shtëpisë me ata, ndërsa 9 mësimdhënës deklarojnë se janë të shqetësuar për mbështetjen e prindërve lidhur me detyrat e shtëpisë pasi prindërit nuk ndajnë shumë kohë për fëmijët e tyre. Sipas këtyre mësimdhënësve, prindërit ankohen për detyrat e shtëpisë. Ata i shohin detyrat e shtëpisë si ngarkesë për fëmijët.

Ja disa nga mendimet e mësimdhënësve që kanë mendime të kundërta për bashkëpunimin me prindër: *“Në vendin ku punoj unë shumë pak, sepse nuk jam në qytet kështu që nëpër fshatra bashkëpunimi me prindër është më i pakët se në qytet ose shkollat në qendër. Kështu që të paktë janë ata prindër që kërkojnë më tepër prej mësueses edhe pyesin për ndonjë sqarim më tepër rreth detyrave, do me thënë me prindër shumë pak, edhe pse gjithë kohën insistoje me bashkëpunu kryesisht për mësimet në shtëpi, por të paktë janë ata që më përgjigjen (Mësuesja, 4). “Disa prind janë mjaft aktiv në detyrat e shtëpisë po disa t’jtjerë ka edhe që ankohen për detyrat e shtëpisë që pasi ata nuk kanë kohë t’mirren me fëmijët e tyre” (Mësuesja, 19).*

“Po, unë personalisht, mendoj që pak prindërit n’përgjithësi nuk ndajnë shumë kohë me fmitë. Ndoshta arsytet janë t’shumta, mund t’jenë ngarkesat ditore, mund t’jenë fakti shumë prind iu duhet t’punojnë edhe jashtë orarit t’punës edhe energjia e tyre për t’nda fokusin drejt përkushtimit t’fmiut është ma e vogël, mos t’them edhe goxha-goxha shqetësuese (Mësuesja, 12).

Një tjetër çështje që doli nga intervistat e që lidhet me bashkëpunimin me prindër është edhe vështirësia që e hasin prindërit gjatë ndihmës që u ofrojnë fëmijëve në detyra të shtëpisë. Sipas përgjigjeve të shumicës së mësimitdhënësve, prindërve u duhet dhënë sqarime shtesë pasi nuk i kuptojnë detyrat. Ndoshta niveli i shkollimit të prindërve është pengesë për t'i kuptuar detyrat ashtu si duhet. Ja një nga mendimet e mësimitdhënësve për vështirësitë që kanë prindërit për të kuptuar detyrat e shtëpisë:

“Ne gjithmonë edhe n’shkollë t’u bisedu me kolegët se problemin kryesor e kemi tek familjet, domethanë që, ku mungon domethanë shkollimi i prindve është gjithmonë pengesë e jona. Edhe na duhet sqarime shtesë gjithmonë” (Mësuesja, 17).

4.10. Përmbledhje nga intervistat me mësimitdhënës

Bazuar nga intervistat me mësimitdhënës rezultuan tetë tema mjaftë interesante dhe shumë të rëndësishme për kontekstin e studimit.

Mungesa e një standardi në shkolla për planifikimin e detyrave të shtëpisë është tema e parë, që nga përgjigjet e mësimitdhënësve na bëri të kuptojmë se në shkollat tona nuk ka asnjë plan apo standard që shkollat posedojnë për caktimin e detyrave të shtëpisë në nivelin fillor.

Përveç mungesës së një standardi në shkolla edhe *mësimitdhënësit nuk janë të zhvilluar profesionalisht* për të menaxhuar detyrat e shtëpisë. Ata pohojnë se nuk kanë ndjekur asnjë trajnim specifik që lidhet me detyrat e shtëpisë. Një temë tjetër që kërkon vëmendje nga të gjithë është *ngarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë*, ku sipas përgjigjeve të mësimitdhënësve, nxënësit janë të ngarkuar me detyra të shtëpisë duke mos i përjashtuar as vikendet dhe festat.

Krijimi i shprehisë së punës dhe zhvillimi i njohurive është një temë që ngërthen në vete shumë tema që tregojnë qëllimin e dhënies së detyrave të shtëpisë nga mësimitdhënësit, si: krijimin e shprehisë së punës dhe përgjegjësisë, përforcimin e njësive të mësuara si dhe nxitjen për hulumtim dhe kreativitet. Një tjetër temë është *informata kthyesë si ndihmë për të përforcuar njohuritë*, mësimitdhënësit pohuan që japin informatë kthyesë për të përforcuar njohuritë dhe për të motivuar nxënësit që të punojnë detyrat e shtëpisë. Megjithatë, një pjesë e mësimitdhënësve deklaruan se shpeshherë nuk kanë mundësi të japin informatë kthyesë me shkrim, në kohën e duhur, për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasë dhe orarit të shkurtër mësimit.

Mësimitdhënësit pohojnë se japin lloje të ndryshme të detyrave të shtëpisë, si detyra të integruara, detyra problemore, projekte të cilat u sjellin nxënësve kënaqësi dhe argëtohen duke i punuar ato. Pra, *stili i detyrave të shtëpisë* na bëri të kuptojmë se mësimitdhënësit japin detyra adekuate. Sa i përket vështirësive që kanë mësimitdhënësit gjatë përgatitjes së detyrave të shtëpisë rezultoi tema për *përshatjen e detyrave të shtëpisë sipas nivelit të të gjithë nxënësve*. Duke marr parasysh që në klasë jo të gjithë nxënësit kanë njohuri të barabarta edhe mësimitdhënësit e shohin si sfidë krijimin e detyrave

për gjithë klasën. Dhe, tema e fundit që doli nga mësimdhënësit ishin mendimet e kundërta lidhur me bashkëpunimin me prindër për detyrat e shtëpisë. Edhe për këtë çështje kishte mendime të ndara pasi disa i konsideronin prindërit shumë bashkëpunues lidhur me detyrat e shtëpisë e disa të tjerë ishin të shqetësuar për formën e bashkëpunimit me prindër.

4.11. Gjetjet nga intervistat me prindër

Tabela 34 paraqet një përmbledhje të temave që rrjedhin nga intervistat me prindër lidhur me pikëpamjet e tyre për detyrat e shtëpisë që punojnë fëmijët e tyre. Nga intervista e realizuar kanë dalë katër tema të rëndësishme për t'i elaboruar në vazhdim. Prindërit janë të pajtimit që fëmijët e tyre të kenë detyra të shtëpisë, por jo të ngarkohen shumë me detyra të shtëpisë. Prindërit e shohin shumë të nevojshme bashkëpunimin mësues – prindër – nxënës. Në fund, prindërit tregojnë për mënyrën e përdorimit të informatës kthyesë të mësuesve.

Tabela 34. Kodet dhe temat që rrjedhin nga analiza tematike e të dhënave të intervistës me prindër

Kodet	Temat
Patjetër duhet me pas detyra të shtëpisë. Detyrat e shtëpisë i mbajnë fëmijët aktivë. Detyrat e shtëpisë ndikojnë që me qenë i përgatitun për shkollë. Shumë e nevojshme të kenë detyra të shtëpisë. E vërej kur fëmija im i ka kuptu njësitë mësimore apo edhe vështirësitë që i ka. Jam e kënaqur me detyrat e shtëpisë që punon fëmija im. Jam pro detyrave të shtëpisë. Detyrat e shtëpisë ndikojnë në përmirësimin e mësimin të fëmijëve. Detyrat e shtëpisë janë në nivel.	Pro detyrave të shtëpisë
Mësuesit japin shumë detyra. 3 – 4 orë detyra që u shkakton lodhje dhe ngarkesë. Detyra të panevojshme që përsëritet disa herë e njëjta gjë. 7 ditë në javë janë me detyra të shtëpisë. Fëmijët duhet të jenë të lirë gjatë vikendit. Jashtëzakonisht të ngarkuar me detyra. Vazhdimisht kanë detyra të shtëpisë. Shumë të angazhuar në detyra të shtëpisë.	Ngarkesa me detyra të shtëpisë

Edhe vikendeve ka detyra të shtëpisë.
Gjatë festave ngarkohen me detyra të shtëpisë.

Biseda të vazhdueshme me mësuesen për detyra të shtëpisë.

Kur fëmija ka ngecje i diskutoj.

Çdo paqartësi e diskutojmë me mësuesen. Trekëndësh shumë i mirë.

Nevoja e bashkëpunimit mësues – prind – nxënës

Teknologjia na mundëson me qenë më afër me mësuesin.

Mjaft shpesh diskutojmë për detyrat e shtëpisë.

I kontrollon vetëm me një nënshkrim.

Nuk ka info kthyesë pasi janë 40 nxënës në klasë.

Mungesë e informatës kthyesë me shkrim

Vlerëson me notë dhe *smile*.

Koha e limituar në raport me numrin e nxënësve në klasë.

Nuk ka koment, por vetëm nënvizim ku ka gabuar.

Fytyra të lumtura, zemra.

4.11.1. Pro detyrave të shtëpisë

Sipas përgjigjeve të prindërve në intervista, detyrat e shtëpisë janë shumë të nevojshme për fëmijët e tyre t'i punojnë. Detyrat e shtëpisë i mbajnë më të përgatitur dhe më aktivë nxënësit. Disa prindër pohojnë se përmes detyrave të shtëpisë e vërejnë nëse nxënësi i ka kuptuar mësimet në klasë apo jo. Po ashtu ndikon që të përmirësohen në mësim, kur nxënësit punojnë detyra të shtëpisë.

Ja disa nga mendimet e prindërve që i shohin si të nevojshme detyrat e shtëpisë:

Kur ulemi me i punu detyrat, aty, duke i punu detyrat faktikisht unë e shoh se sa kanë mbërri ata me kuptu njësinë, njësitë e reja mësimore që i kanë mësu, ose ku kanë pasë pak më tepër vështirësi, ku mendojnë pak me ndryshe ose varet tash prej njërive që i kanë shtjellu n'shollë. D.m.th. përmes detyrave unë mendoj që mu m'ndihmojnë për me ditë pak a shumë çka me punu ma tepër me ta, në cilin drejtim me punu pak më tepër andaj jam që pro që fëmijët të kenë detyra të shtëpisë (Prindi, 5).

Detyrat e shtëpisë janë të domosdoshme, sepse nëse nuk kanë detyra, atëherë fëmijët e humbin interesimin për mësimin (Prindi, 12).

Detyrat e shtëpisë mund t'u japin prindërve mundësinë që të shohin se çfarë po ndodh në shkollë dhe që të shprehin qëndrime pozitive drejt arritjes. Përveç kësaj prindërit duhet të përfshihen në detyrat e shtëpisë kur është e përshtatshme. Ata duhet t'i ndihmojnë nxënësit të përmbledhin informacionin që

ata kanë mësuar, por nuk duhet të ndihen sikur kanë nevojë të veprojnë si mësues ose si policë për t'u siguruar që ata të kryejnë detyrat e shtëpisë (Bembenutty, 2009; Marzano 2003).

4.11.2. Ngarkesa me detyra të shtëpisë

Shumica e prindërve theksojnë se fëmijët e tyre janë shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë. Pavarësisht që ata janë pro detyrave të shtëpisë, nuk janë të pajtimit që fëmijët të punojnë shumë detyra të shtëpisë. Fëmijët kanë detyra çdo ditë të javës, pra edhe vikendeve por edhe ditëve që janë festa. Sipas tyre, fëmijët janë shumë të ngarkuar me detyra. Tetë nga njëzet prindërit e intervistuar theksojnë se fëmijët e tyre punojnë 3 – 4 orë detyra të shtëpisë gjë që fëmijëve u shkakton ngarkesë dhe lodhje. Disa nga detyrat janë të panevojshme pasi përsëriten detyrat e njëjta disa herë. Më poshtë kemi dhënë disa nga mendimet e prindërve për ngarkesën e fëmijëve të tyre në detyra të shtëpisë:

Unë i kam tre fëmijë, një në shkollë të mesme. Detyra japin shumë, pra detyra të shtëpisë. Nganjëherë për mu nuk osht shumë e nevojshme, sepse kanë shumë obligime në shkollë, e pastaj në shtëpi ju duhen edhe 3- 4 orë me punu prap detyra e kjo shkakton lodhje dhe ngarkesë (Prindi, 11).

Është ngarkesë e madhe që nxënësit e vegjël të ngarkohen 7 ditë të javës me detyra. Edhe të rriturit që punojnë, duhet të kenë pushim, e lërë më fëmijët e kësaj moshe. Po secili sot i ka kriteret e veta andaj po duhet t'i zbatojmë (Prindi, 20).

Prindërit që ndihmuan fëmijët e tyre me detyrat e shtëpisë, besonin se vëllimi i detyrave të shtëpisë ishte shumë i madh dhe se fëmijët nuk kanë kohë të mjaftueshme për aktivitete gjatë kohës së lirë. Shumica e autorëve dhe prindërve besojnë se detyrat e shtëpisë janë të dobishme dhe të domosdoshme (Kukk et al., 2015).

4.11.3. Nevoja e bashkëpunimit mësues – prind – nxënës

Bazuar në përgjigjet e prindërve, bashkëpunimi me prindër është më se i nevojshëm. Shumica e prindërve pohojnë se vazhdimisht komunikojnë më mesimdhënës për detyrat e shtëpisë që punojnë fëmijët e tyre. Për çdo paqartësi dhe ngecje të fëmijëve të tyre në detyra të shtëpisë, prindërit i diskutojnë me mesimdhënësit e fëmijevë të tyre.

I diskutojmë, i diskutojmë mjaft shpesh edhe është e gatshme gjithmonë t'na jep përgjigje për detyrat e fëmijëve, aty ku has në vështirsi fëmija t'na jep sqarime edhe t' thotë se ktu është pak ... ka ngecje pak ma shumë ose diçka t'tillë që me mujt edhe me bashkëpunu prindi, msusja dhe fëmija që me mujt me realizu diçka t'mirë me msime (Prindi, 17).

Nga përfshirja e familjes përfiton edhe mësuesi. Ata krijojnë ndjenja pozitive rreth mësimit në shkollat e tyre kur ka më shumë përfshirje të prindërve në shkollë (Epstein & Dauber, 1991; Hoover-Dempsey et al., 1987). Mësuesit që komunikojnë me prindërit kanë tendencë të rrisin pritshmërinë dhe vlerësimin për të gjithë prindërit dhe vazhdojnë t'i shtojnë aktivitetet për përfshirjen e familjes (Epstein & Voorhis, 2001).

4.11.4. Mungesë e informatës kthyesë me shkrim

Edhe pse mësuesit japin informata kthyesë, bazuar në përgjigjet e shumicës së mësuesve, vërehet mungesë e informatës kthyesë me shkrim. Një ndër arsytet që theksohet pothuajse nga shumica e mësuesve është koha e limituar në raport me numrin e madh të nxënësve në klasë.

Më poshtë janë disa nga komentet e mësuesve që dëshmojnë se nuk japin informata kthyesë me shkrim:

Faktikisht na ndodh me pa si t'nenvizume ku e ka gabimin, është e nënvizume (Prindi, 9).

Shumicën e rasteve fëmija ka koment me gojë pasi numri i madh nxënësve në klasë nuk arrin mësuesja që çdo nxënës ta informojë me shkrim (Prindi, 15).

Kur nxënësit kanë informata kthyesë të qarta tregohet se puna e tyre është respektuar derisa ata marrin këshilla dhe kanë mundësi të zvogëlojnë boshllëqet aty ku kanë nevojë (Fawzy, 2012; Hattie, 2011).

4.12. Përmbledhje nga intervistat me prindër

Bazuar nga përgjigjet e prindërve na dolën 4 tema të rëndësishme për kontekstin e këtij studimi. Prindërit janë *pro detyrave të shtëpisë* pasi fëmijët janë më të përgatitur kur punojnë detyra të shtëpisë, janë më aktivë dhe prindërit vërejnë kur fëmijët kanë ndonjë vështirësi në mësim ose nuk kanë kuptuar ndonjë detyrë në klasë. Pavarësisht që prindërit janë *pro detyrave*, ata vazhdimisht e theksojnë që fëmijët janë shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë. Andaj, *ngarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë* është një temë që kërkon trajtim shumë serioz nga politikbërësit e arsimit e me theks të veçantë mësuesit.

Nevoja e bashkëpunimit mësues – prind – nxënës është tema e tretë që doli nga intervista me prindër. Sipas prindërve, bashkëpunim me mësues dhe nxënës është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Tema e fundit që doli nga përgjigjet me mësues ishte *mungesa e informatës kthyesë me shkrim*. Prindërit pohuan se mësuesit nuk japin informata kthyesë me shkrim për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasë dhe orarit të shkurtër.

4.13. Gjetjet nga intervista me nxënës

Tabela 35 paraqet një përmbledhje të temave që rrjedhin nga intervistat me nxënës lidhur me mendimet e tyre për detyrat e shtëpisë.

Nga intervista e realizuar kanë dalë tri tema të rëndësishme për këtë studim. Nxënësit i shohin detyrat e shtëpisë si shumë të nevojshme. Informata kthyese si nxitje për të përforcuar njohuritë, por jo gjithmonë mësimdhënësit kanë mundësi të japin informatë kthyese me shkrim.

Tabela 35. Kodet dhe temat që rrjedhin nga analiza tematike e të dhënave të intervistës me nxënës

Kodet	Temat
Detyra e shtëpisë janë të mira. Detyra e shtëpisë na mësojnë më shumë. Nevojë për përsëritje të mësimëve. Përforcim për detyra. Ushtrim në qetësi. Lehtësojnë kuptimin e mësimëve. Përgatitje për të nesërmen/ për të ardhmen. Përgatitje për test. Obligim për punë. Ndihmojmë në përmirësim të gabimeve. Zhvillojnë memorien tonë.	Detyrat e shtëpisë si nevojë për nxënësit
Ndihmon në përmirësim të detyrave. Stimulim për të mësuar. Informon për ushtrime të detyrave. Të këshillon për herën tjetër. Mësimet nuk të grumbullohen. Motivon për punë. Kujdes për detyra. Nxitje për të ushtruar.	Informata kthyese si nxitje për përforcim të njohurive
Bisedë individuale me nxënësin. Komunikimi direkt i informatës kthyese. Mungesë e kohës. Numri i madh i nxënësve në klasë. Kontrollim i detyrave bashkë më gjithë klasën. Tri herë gjatë javës. Ndonjëherë i kontrollon detyrat e shtëpisë. Jo shumë shpesh.	Mungesë e informatës kthyese me shkrim

4.13.1. Detyrat e shtëpisë si nevojë për nxënësit

Viteve të fundit, detyrat e shtëpisë kanë qenë temë e diskutimit për ndikimin e tyre në të nxënëit e nxënësve (Cooper, 2001; Hoeke, 2017). Me gjithë debatet shumë të ashpra në këto diskutime, nxënësit tregojnë përvoja shumë të rëndësishme për punimin e detyrave të shtëpisë. Ata theksojnë se detyrat e shtëpisë janë të mira, i mësojnë shumë duke përforcuar mësimet e mësuara në klasë. Sipas tyre, detyrat e shtëpisë janë nevojë për përsëritjen e mësimet të mësuara në klasë dhe përgatitjen për të nesërmen. *Detyrat e shtëpisë na ndihmojnë për mësim që të jemi më të përgatitur për të nesërmen. (Nxënësi 4); Detyrat e shtëpisë e luajnë një rol shumë të rëndësishëm për mua, sidomos edhe për nxënësit e tjerë, ato janë një përsëritje e detyrave të klasës që mësuësja na jep që në të ardhmen t'i kemi dhe të jemi më të zhvilluar në memorjen tonë (Nxënësi 10).*

Detyra e shtëpisë janë një mjet fuqishëm që mund të kontribuojë në përgatitjen dhe përparimin e nxënësve nëse mësimdhënësit i japin në mënyrën e duhur.

4.13.2. Informata kthyesë si nxitje për përforsim të njohurive

Sipas shumicës së nxënësve me të cilët është realizuar intervista, përdorimi i informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë nxitë ata për t'u përmirësuar. *“Informata kthyesë unë mendoj shumë mirë se mësuësja na informon dhe na këshillon se çfarë kemi bërë ne. A e kemi bërë gabim apo saktë dhe kjo na ndihmon shumë?!” (Nxënësi 6).*

“Po mësuësja na jep informatë kthyesë, na tregon nëse e kemi bërë mirë ose nëse e kam bërë keq na ndihmon me i përmirësu.” (Nxënësi 9).

Sipas përvojës së tyre, informata kthyesë në detyrat e shtëpisë ndihmojnë ata për të përmirësuar detyrat e shtëpisë, motivojnë nxënësit për të mësuar më shumë, këshillojnë për herën tjetër si dhe mësimet e tyre nuk grumbullohen për shkak të përcjellës dhe informimit të vazhdueshëm të tyre me anë të komenteve me gojë dhe shkrim. Informata kthyesë është një nga ndikimet më të fuqishme në të mësuar dhe në arritjen e nxënësve (Hattie & Timperlay, 2007).

4.13.3. Mungesë e informatës kthyesë me shkrim

Bazuar në intervistat e realizuara me nxënës, dhënia e informatës kthyesë me gojë përdoret më shumë se sa dhënia e informatës kthyesë me shkrim. Nga 20 nxënës me të cilët është realizuar intervista vetëm 3 nxënës pohojnë se marrin informata kthyesë me shkrim, ndërsa 17 nxënës të tjerë marrin informata kthyesë me gojë.

“Informatë kthyese me gojë. Ajo na ndihmon shumë në kthimin e informacioneve. (Nxënësi 5. Po me gojë, me shkrim më rrallë, (Nxënësi 2); Marr gati te trijat. Në gjuhë shqipe na kontrollon na tregon veq nëse koment nese ke bo najsen që sështë dasht ose nëse është shumë mirë. Nota ndodh shumë rrallë. (Nxënësi 6); Neve na konfirmon që e kemi punu e tani bënë me tik (✓) edhe nëse i kemi gabim e përmirësojmë më vonë më klasën.” (Nxënësi 1).

Informatat kthyese me gojë përdoren për korrigjimin e gabimeve, lavdërim, vlerësim, parashtrimin e një sfide, sqarim plotësues, nxitje për reflektim e shumë çështje të tjera që ndihmojnë nxënësit për të mësuar më shumë (Bep, 2013).

4.14. Përmbledhje nga intervistat me nxënës

Intervistat me nxënës, nxënësit i shohin si të nevojshme detyrat e shtëpisë pasi i ndihmojnë të mësojnë më shumë dhe të përmirësojnë gabimet. Përdorimi i informatës kthyese në detyrat e shtëpisë ndihmon në përforcimin e njësive mësimore pavarësisht që mësime të tilla nuk kanë mundësi të japin informatë kthyese me shkrim.

KAPITULLI 5

DISKUTIME DHE PËRFUNDIME

Ky kapitull paraqet përmbledhjen dhe diskutimin e mbështetur në informacionin e mbledhur nga respondentët e këtij studimi që ishin mësimitdhënësit, prindërit dhe nxënësit.

Ashtu siç është potencuar edhe në kapitullin e Metodologjisë, natyra e studimit të këtij disertacioni është mikse duke përfshirë metoda sasiore dhe cilësore, andaj diskutimi është bërë duke u bazuar në këto metoda. Diskutimi është mbështetur në dy teoritë kryesore: teoria e konstruktivizmit dhe teoria e aktivitetit të sistemeve, të cilat teori kanë luajtur një rol të rëndësishëm për studimin tonë.

Hulumtimi ka synuar t'i përgjigjet pyetjes kryesore, si në vijim:

Cilët faktorë përcaktojnë efektivitetin e zbatimit të detyrave të shtëpisë në procesin mësimor?

Për t'iu përgjigjur pyetjes kryesore jemi mbështetur në teorinë e sistemeve të aktivitetit siç po shihet edhe në figurën 6. Figura e mëposhtme paraqet një përshkrim të sistemeve të veprimtarisë – me mësimitdhënësit, nxënësit dhe prindërit në mënyrë që të kuptohet menaxhimi efektiv i detyrave të shtëpisë duke u bazuar në veprimtarinë e këtyre subjekteve.

Ky hulumtim ka identifikuar faktorët më të rëndësishëm të cilët përcaktojnë efektivitetin e praktikimit të detyrave të shtëpisë në procesin mësimor.

Mungesa e një standardi në shkolla për caktimin e detyrave të shtëpisë është faktori më i rëndësishëm në këtë studim që mund të themi se vërehet edhe si një pikë kritike e këtij hulumtimi.

Sipas intervistave të realizuara me mësimitdhënësit, ata nuk posedojnë asnjë standard ose plan nga shkolla apo nga komuna për mënyrën e menaxhimit të detyrave të shtëpisë. Kjo dëshmon se problemi i adresuar nga mësimitdhënësit është më i thellë pasi në asnjë dokument zyrtar nuk theksohet për rolin e detyrave të shtëpisë e aq më pak për një standard të mirëfilltë rreth këtyre detyrave. Mungesën e një standardi për caktimin e detyrave të shtëpisë mësimitdhënësit e shohin si një sfidë të madhe gjatë praktikimit të këtyre detyrave pasi si mungesë e një standardi të tillë edhe mësimitdhënësit hasin në shumë dilema kur caktojnë detyrat e shtëpisë.

Studime të shumta tregojnë për politikën që duhet të ketë secila shkollë për caktimin e detyrave të shtëpisë (Cooper, 1994; Epstein & Voorhis, 2001; Skaggs, 2007). Sipas autorëve, kur shkollat caktojnë një standard për detyrat e shtëpisë ato do të merren me seriozisht nga të gjithë. Një tjetër studim nga një ekip me katër studiues të cilët hulumtuan për politikën e detyrave të shtëpisë nëpër shkolla identifikuan se shumë shkolla kanë politika shumë të qarta rreth caktimit të detyrave të shtëpisë, por ka edhe shkolla të cilat nuk kanë politika të qarta ose iu mungojnë fare (Merritt et al., 2015). Gjetjet e një hulumtimi tjetër korrelojnë edhe me hulumtimin tonë pasi në shkolla mungon një politikë për detyrat e shtëpisë si dhe ka njohuri të gabuara nga prindërit dhe mësuesit rreth politikave të detyrave

të shtëpisë (Holland et al., 2021). Në anën tjetër, Volley (2017) thekson se sfida për praktikimin e detyrave të shtëpisë nuk duhet domosdoshmërisht t'u drejtohet mësuesve, por fillimisht duhet të sfidohen politikëbërësit e arsimit siç është Ministria e Arsimit bashkë me udhëheqësit apo pronarët e shkollave.




Figura 6. Të kuptuarit e zhvillimit të veprimtarisë së faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë

Zhvillimi personal dhe profesional i mësimdhënësve është një faktor tjetër që ndikon në menaxhimin e detyrave efektive.

Rezultatet e analizave treguan se nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm sinjifikant në mes të përvojës së mësimdhënësve dhe opinionit të tyre në raport me detyrat e shtëpisë (Shih te analiza e rezultateve). Këto rezultate theksojnë se nuk ka dallime të rëndësishme sinjifikante në mes të përvojës së punës së mësimdhënësve dhe opinionit të tyre mbi sfidat e përgjithshme gjatë implementimit të detyrave të

shtëpisë. Në fund është analizuar dallimi në mes të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe opinionit të tyre e sfidave të përgjithshme për detyrat e shtëpisë. Pra, këtu është bërë dallimi në mes të mësimitdhënësve që janë shprehur se zhvillimi profesional i ka ndihmuar për detyrat e shtëpisë dhe atyre që kanë shprehur të kundërtën. Edhe këtu, rezultatet tregojnë se në asnjërin prej rasteve nuk është gjetur dallim i rëndësishëm sinjifikant. Ky rezultat është në përputhje me gjetjet e Hoeke (2017), ku rezultatet tregojnë se përvoja e punës nuk paraqet ndonjë dallim të rëndësishëm në mes mësimitdhënësve me nivele të ndryshme të përvojës që lidhet me efektivitetin e detyrave të shtëpisë. Mirëpo intervistat me mësimitdhënës tregojnë se ata nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim të veçantë lidhur me detyrat e shtëpisë. Sipas mësimitdhënësve, ata nuk janë të përgatitur profesionalisht sa duhet për praktikimin e detyrave të shtëpisë andaj edhe shpeshherë ndodh që ata të kenë dilema rreth ngarkesës së nxënësve me detyra të shtëpisë. Nga 20 mësimitdhënës sa janë intervistuar, vetem 5 prej tyre pohojnë se trajnimet e tjera si: Të menduarit kritik gjatë shkrim –leximit (MKLSH), trajnimi i Kurrikulës dhe trajnimi i Vlerësimit i ka ndihmuar ata që të krijojnë detyra të shtëpisë. Edhe gjatë intervistave ata e konsideronin shumë të nevojshme zhvillimin e tyre profesional për të ndjekur trajnime për praktikimin e detyrave të shtëpisë.

Gjetjet e studimit tonë janë në një vijë me studimin e Cooper (1994), ku studiuesi tregon se mësimitdhënësit nuk janë trajnuar shumë për detyra të shtëpisë e në veçanti për mënyrën se si të krijojnë detyrat e shtëpisë dhe si të përfshihen prindërit në detyra. Edhe Skaggs (2007), potencon se ka mungesë të trajnimeve për detyra të shtëpisë. Sipas autorit nëpër trajnime përmenden detyrat e shtëpisë por megjithatë nuk ka ndonjë trajnim specifik që lidhet vetëm për detyrat e shtëpisë. Përveç trajnimit për të krijuar detyra të shtëpisë, autori e sheh të nevojshme që mësimitdhënësit të trajnohen se çfarë duhet të bëjnë me detyrat e shtëpisë pasi të kthehen në klasë.

Sipas Landing - Corretjer (2009), zhvillimi profesional i mësimitdhënësve për të hartuar detyra të shtëpisë është shumë i nevojshëm. Këtë gjë mund ta arrijnë duke ndjekur trajnime për krijimin e detyrave të shtëpisë. Në studimin e realizuar me mësimitdhënës, mësimitdhënësit të cilët kishin ndjekur trajnime për detyra të shtëpisë për dallim nga mësimitdhënësit që nuk kishin ndjekur fare trajnime nuk i ngarkonin nxënësit me detyra të shtëpisë. Përveç trajnimit për krijimin e detyrave të shtëpisë, në një studim tjetër autorët rekomandojnë që mësimitdhënësit e kanë të nevojshme për t'u trajnuar lidhur me mënyrën se si komunikojnë ata me prindërit për detyrat e shtëpisë (Merritt et al., 2015). Edhe në studimin që shqyrton praktikimin dhe qëndrimet e mësimitdhënësve për detyra të shtëpisë, autorët bëjnë thirrje për integrimin e mësimitdhënësve për t'u trajnuar lidhur me detyrat e shtëpisë (Trautwein et al., 2009). Duke marrë parasysh faktin për nevojën e trajnimeve për detyra të shtëpisë, studime të mëtejme janë të nevojshme për të eksploruar më thellë këtë problematikë.

Qasja e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë është një pikë e fortë që vërehet në studim. Kjo qasje është klasifikuar në dy komponentë kryesorë. Nga komponenti i parë mund të konkludojmë se *inkurajimi i nxënësve për të zhvilluar aftësitë e mësuara në jetën e përditshme* vërehet si qasje e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë, ndërsa si komponent e dytë është *zhvillimi personal i nxënësve* si qasje e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë.

Po ashtu intervistat me mësimdhënës tregojnë arsye të shumta lidhur me qasjen e tyre ndaj detyrave të shtëpisë të cilat janë pothuajse të përafërta me analizat e mësipërme që janë realizuar për këtë qëllim. Sipas mësimdhënësve janë shumë arsye pse ata japin detyra të shtëpisë, të cilat i kemi emërtuar si krijim i shprehisë së punës dhe zhvillimi i njohurive. Arsyeja që ata japin detyra të shtëpisë është që nxënësi të angazhohet në detyra të shtëpisë për të fituar shprehi të punës dhe përgjegjësisë, për të përfocuar njësitë e mësuara, për të nxitur hulumtimin dhe kreativitetin si dhe për të vlerësuar njohuritë e nxënësve. Qasja e tillë e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë mbështetet në teorinë e konstruktivizmit me theks të veçantë në parimin "*autonomia dhe përgjegjësia për të nxënë*".

Si konkludim i të gjitha analizave të realizuara, qasja e mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë është që nxënësit të angazhohen në detyra të shtëpisë për të inkurajuar që të zhvillojnë aftësitë e mësuara në jetën e përditshme. Edhe zhvillimi personal theksohet si një qëllim i rëndësishëm në detyrat e shtëpisë nga mësimdhënësit. Përmes këtij zhvillimi, nxënësit duhet të vetëdijesohen se ata duhet të jenë të përgjegjshëm për të përfunduar detyrat e shtëpisë dhe në këtë mënyrë krijojnë edhe shprehi të punës. Rezultatet e ofruara nga ky studim janë në përputhje me shumë studime të tjera (Carr, 2013; Costa et al., 2016, Epstein & Voorhis, 2001; Hoeke, 2017; Marcum, 2018) të zhvilluara në vende të ndryshme, të cilat mund të jenë interesante dhe specifike për kontekstin ku është zhvilluar hulumtimi. Holland et al., (2015) treguan se qëllimi i detyrave të shtëpisë sipas mësimdhënësve paraqitet si një laramani qëllimesh për detyrat e shtëpisë. Si qëllime kryesore që dalin nga studimi i tij është aftësimi i nxënësve për punë praktike, zhvillimi i etikës për punë si dhe nxënësit të bëhen të pavarur dhe të përgjegjshëm. Në anën tjetër, Fawzy (2012), paraqet rezultate të rëndësishme ku disa prej të cilave lidhen edhe me studimin tonë si, përgatitja për orën e ardhshme si dhe rishikimi i materialit të mësuar në klasë.

Edhe në studime të tjera gjejmë përputhje të qëllimeve të detyrave të shtëpisë me rezultatet tona të studimit. Studiuesit Epstein dhe Voorhis (2001) përmendin 10 qëllime të detyrave të shtëpisë si: praktikë, përgatitje, pjesëmarrje, zhvillim personal, marrëdhënie prind – fëmijë, komunikim prind – mësues, bashkëpunimin me kolegë, politika, marrëdhëniet me publikun dhe dënimin. Pothuajse shumicën nga këto qëllime i gjejmë edhe në rezultatet e studimit tonë, por më e theksuara është zhvillimi personal që edhe në studim doli si temë pasi mësimdhënësit pohuan se japin detyra të shtëpisë për të krijuar shprehi si vetëdisiplinimi, pavarësia, përgjegjësia personale, vetëdrejtimi dhe të zhvillojnë shprehi të mira të punës. Po ashtu, të njëjtat qëllime i gjejmë edhe në studimin e realizuar

nga Baş et al. (2017), ku autorët shpjegojnë se detyrat e shtëpisë mund të caktohen për qëllime udhëzuese, si: praktikimi, rishikimi, përforcimi dhe hulumtimi. Të gjitha këto qëllime janë në një vijë me rezultatet e studimit tonë. Përveç qëllimeve udhëzuese, autorët tregojnë se detyrat e shtëpisë mund të jepen edhe për qëllime jo – udhëzuese, si: bashkëpunimi me prindër, komunikimi i asaj që mësohet në shkollë, zhvillimi i aftësive të përgjegjësive, besimit dhe vetëdisiplinës.

Nga të gjitha rezultatet për qëllimin e detyrave të shtëpisë pothuajse më shumë i theksuar është zhvillimi personal si një qëllim i rëndësishëm për detyrat e shtëpisë.

Siç vërehet nga rezultatet e studimit tonë dhe autorëve të ndryshëm, mësimitdhënësit kanë shumë qëllime për dhënien e detyrave të shtëpisë, gjë e cila varet nga mësimitdhënësit për qëllimin që ata japin detyrat e shtëpisë. Ndodh që mësimitdhënësit pavarësisht që e kanë të qartë qëllimin të cilin duan ta arrijnë, për shkak të mungesës së kohës dhe si rrjedhojë pamundësisë për të dhënë vlerësimet e nevojshme për secilin nxënës pamundësojnë arritjen e qëllimit të plotë të dhënies së detyrave.

Një tjetër pikë e fortë që doli nga intervistat me mësimitdhënës ishin edhe llojet e detyrave të shtëpisë. Sipas mësimitdhënësve, fokusi më i madh i tyre është në detyra me karakter hulumtues, detyra problemore, detyra kreative si dhe detyra në formë të lojës. Mësimitdhënësi në këtë proces ka një rol shumë të rëndësishëm pasi orientimi i tij në detyra të tilla përmbush edhe dy nga parimet e teorisë së konstruktivizmit në të cilën teori mbështetet edhe ky studim. Derisa nxënësit kanë detyra të tilla, ata janë pjesëmarrës aktivë në mësim duke përmbushur parimin “pjesëmarrja aktive e nxënësit dhe qasja me në qendër nxënësin”. Përveç këtij parimi edhe parimi i të nxënësit autentik përmbushet nga qasja e tillë e mësimitdhënësve.

Edhe pse qasja e mësimitdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë vërehet se është e mirë, ata përballën me shumë sfida gjatë implementimit të detyrave të shtëpisë të cilat vështirësojnë që zbatimi i detyrave të shtëpisë të realizohet në mënyrë efektive. Sfidat që kanë mësimitdhënësit për integrimin e detyrave të shtëpisë si pjesë e praktikës së zakonshme u analizuan nga perceptimet e mësimitdhënësve që kanë plotësuar pyetësorin për mësimitdhënës si dhe nga intervistat e realizuara me mësimitdhënës, nxënës dhe prindër. Numri i madh i nxënësve në klasë dhe orari i shkurtër pamundëson dhënien e informatës kthyesë me shkrim në detyrat e shtëpisë sipas rezultateve të dala nga ky studim. Pra, numri i madh i nxënësve në klasë dhe orari i shkurtër nuk ua lejon mësimitdhënësve të kontrollojnë detyrat e shtëpisë ashtu siç dëshirojnë ata. Sipas mësimitdhënësve, ata detyrohen që detyrat t’i kontrollojnë në kohën e pauzës ose në shtëpi. Kjo pamundëson që informata kthyesë të bëhet në kohën e duhur, gjë e cila është shumë e rëndësishme për të arriturat e nxënësve.

Krahas intervistave me mësimitdhënës edhe intervistat me nxënës dhe prindër na japin të kuptojmë se përdorimi i informatës kthyesë në detyrat e shtëpisë është një sfidë për mësimitdhënësin pasi nxënësit marrin më shumë informatë kthyesë me gojë se sa me shkrim ose informatën kthyesë e marrin jo në

momentin e duhur. Gjetjet tona janë në vijë me rezultatet e studimit të Forster (2011), ku sipas intervistave të realizuara me mësues, përdorimi i informatës kthye në detyra të shtëpisë u shkaktonte vështirësi dhe ngarkesë ta praktikonin ashtu si duhet. Një ndër faktorët që vështirësonte ose pengonte që mësime të përdornin ashtu si duhet informatën kthye ishte përdorimi i informatës kthye për shkak të numrit të madh të nxënësve, gjë e cila korrelohet edhe me studimin tonë.

Në këtë studim, edhe intervistat me nxënës dhe prindër tregojnë që detyrat e shtëpisë vetëm dorëzohen mbi bankën e mësuesit dhe kaq. Përshtatja e detyrave të shtëpisë për të gjithë nxënësit paraqitet si vështirësi nga ana e mësime të cilët shpeshherë kanë edhe dilema për numrin e detyrave që duhet të caktojnë në shtëpi. Sipas shumë studiuesve caktimi i detyrave të shumta nuk është produktiv (Carr, 2013; Hoeke, 2017).

Në një tjetër studim që lidhet me studimin tonë (Heffernan, 2019), pohon se mësime të duhet të gjejnë kohën dhe mënyrën për të dhënë informatën kthye në detyra të shtëpisë, derisa në studimin tonë mësime të nuk japin informatë kthye me kohë. Sipas Heffernan (2019), dhënia e informatës kthye nga mësime të me kohë ose aty për aty, për detyrat e shtëpisë është shumë e rëndësishme dhe ka ndikim të fuqishëm që nxënësit t'i punojnë me rregull detyrat e shtëpisë. Kështu, sipas një studimi nga autorët (Huisman 2016; Stogner, 2014), mësime të japin informatë kthye në kohën e duhur gjë e cila motivon nxënësit për të përfunduar detyrat e shtëpisë dhe i bën ato detyra më efektive. Ndërsa, studiuesi Skaggs (2007) pohon se përdorimi i informatës kthye ndryshon nga mësuesi në mësues pasi disa prej tyre u kërkohet nxënësve t'ua dorëzojnë detyrat e shtëpisë, i vlerësojnë ato, u japin informatë kthye, ndërsa pjesa tjetër duke e bërë një kontrollim vetëm nëse i kanë plotësuar ato, por jo edhe të japin informatë kthye.

Një tjetër sfidë e mësime të është përpilimi i detyrave të shtëpisë bazuar jo vetëm në mesataren e klasës, por në mënyrë individuale përshtatur aftësive psiko-fizike të secilit nxënës. Mësime të shprehin se ka mungesë të kohës për përpilimin e detyrave të shtëpisë. Përshtatja e detyrave të shtëpisë sipas nivelit të nxënësve nuk përmbush edhe aq shumë njërin nga parimet e teorisë së konstruktivizmit "*ndërtimi i dijes mbi dijen paraprake*". Për të përmbushur qëllimin e dhënies së detyrave, mësime të duhet të bëjnë menaxhimin më të mirë të kohës brenda orëve të parapara sipas kontratës së punës duke ndarë kohën e mjaftueshme për përpilimin e saktë të detyrave për gjithë klasën dhe sipas aftësive psiko-fizike të nxënësve.

Sfida e tjetër që mësime të e shohin në këtë studim është *mungesa e mbështetjes së familjes në detyra të shtëpisë*. Sipas mësime të, prindërit nuk tregojnë interesim që nxënësit të kenë detyra të shtëpisë.

Edhe *kushtet ekonomike*, qoftë kompjuteri apo interneti vështirëson punën e mësime të gjatë përpilimit të detyrave të shtëpisë. Sipas mësime të, jo gjithmonë mund të planifikojnë projekte

apo detyra me karakter hulamtues që nxënësit të punojnë në shtëpi pasi nxënësit nuk kanë mundësi të punojnë detyra të tilla si pasojë e mungesës së internetit. Jo vetëm nxënësit por edhe mësimitdhënësit kanë vështirësi të njëjta sa i përket mungesës së teknologjisë pasi mësimitdhënësi nuk mund të planifikojë të përgatit detyra të cilat duhet të printohen pasi në shkolla ka mungesë të printerit.

Si konkludim për të gjitha analizat e bëra, sfidat që kanë mësimitdhënësit gjatë praktikimit të detyrave të shtëpisë janë të shumta, si: mungesa e standardi në shkolla për planifikimin e detyrave të shtëpisë, numri i madh i nxënësve në klasë dhe orari i shkurtër që pamundësojnë që mësimitdhënësi të japë informatë kthyesë në mënyrë të duhur; koha që ka mësimitdhënësi për të krijuar detyra të shtëpisë nuk është e mjaftueshme; përshtatja e detyrave të shtëpisë sipas nivelit të nxënësve duke e ditur se jo të gjithë nxënësit kanë nivel të njëjtë të njohurive; koha që nxënësit duhet të kalojnë në detyra të shtëpisë. Sfida tjera janë edhe mungesa e bashkëpunimit me prindër e në veçanti prindërit me nivel më të ulët shkollimi dhe në fund kushtet ekonomike (mungesa e kompjuterit), mungesa e internetit dhe mungesa e materialeve (fjalor ose burime tjera) në shtëpi por edhe mungesa e printerit nëpër shkolla. Të gjitha këto sfida ndikojnë që mësimitdhënësi të mos praktikojë detyrat e shtëpisë ashtu siç duhet.

Lidhur me sfidat e sipërpërmendura që kanë mësimitdhënësit gjatë zbatimit të detyrave të shtëpisë gjejmë shumë hulamttime të cilat janë në pajtueshmëri me rezultatet tona, por kemi edhe studime të cilat janë në kundërshtim me studimin tonë.

Gjetjet e hulamttimeve në këtë fushë (Ozer & Keskin, 2015), janë në pajtueshmëri me rezultatet e studimit tonë. Në këtë studim si vështirësi për punimin e detyrave të shtëpisë theksohet mungesa e bashkëpunimit me prindër. Ashtu si në rastin tonë, prindërit nuk kanë kohë të mjaftueshme të punojnë detyra të shtëpisë e në disa raste edhe të kenë vështirësi në ndihmën që duhet ofruar fëmijëve të tyre pasi nuk kuptojnë detyrat e shtëpisë. Edhe këtu, kushtet ekonomike paraqiten si sfida në punimin e detyrave të shtëpisë, duke filluar nga mungesa e internetit e kompjuterit e deri te sigurimi i librave shtesë.

Sa i përket rolit të prindërve në asistimin e tyre në detyrat e shtëpisë, shumica e prindërve i shohin si shumë të rëndësishme, andaj edhe janë pro detyrave të shtëpisë. Sipas shumicës së prindërve, detyrat e shtëpisë i mbajnë nxënësit aktivë dhe më të përgatitur lidhur me mësimet që kanë mësuar në shkollë. Përveç kësaj detyrat e shtëpisë i mbajnë prindërit të informuar se si qëndron fëmija me mësimet. Përmes detyrave të shtëpisë, prindërit vërejnë pikat e forta dhe pikat ku duhet punuar më shumë me fëmijët e tyre. Ata janë pro detyrave të shtëpisë, por jo nxënësit të jenë të ngarkuar me detyra të shtëpisë, duke punuar 2 – 3 orë detyra të shtëpisë pasi fëmijët kanë nevojë edhe për kohë të lirë.

Studimet që kanë shqyrtuar përfshirjen e prindërve në detyra dhe rolin e tyre në këtë proces janë në përputhje me rezultatet e studimit tonë. Studiues të kësaj fushe, vënë në pah se lidhja në mes të shkollës

dhe familjes duhet të forcohet pasi ndikimi i familjes është thelbësor për të inkurajuar fëmijët e tyre dhe të mbështesin ata në organizimin e detyrave të shtëpisë (Costa et al., 2017).

Në studimin Kukk et al. (2015), prindërit ndihmojnë fëmijët e tyre në detyra të shtëpisë dhe i konsiderojnë detyrat e shtëpisë si shumë të rëndësishme. Komunikimi pozitiv i prindërve pothuajse gjithmonë jep rezultate pozitive për prindërit dhe mësuesit. Komunikimi negativ, sipërfaqësor ose i pamjaftueshëm pothuajse gjithmonë çon në probleme gjatë gjithë vitit shkollor (Sylaj dhe Sylaj, 2020). Edhe pse prindërit i mbështesin fëmijët për detyrat e shtëpisë, ata vazhdimisht theksojnë se fëmijët e tyre janë shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë. Bazuar në opinionet e prindërve, fëmijët kalojnë shumë orë në detyra të shtëpisë dhe si pasojë e kësaj ata nuk kanë kohë të lirë për të luajtur, andaj kjo është edhe një sfidë që prindërit e shohin si ngarkesë për fëmijët e tyre.

Sipas tyre, fëmijët janë aq shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë saqë nuk përjashtohen as ditët e vikendit e as ditët e festave. Ata vazhdimisht potencojnë që janë për detyra të shtëpisë, por jo shumë të ngarkuar. Madje edhe studimi i realizuar nga autorët (Kukk et al., 2015), dëshmon që prindërit tregojnë se vëllimi i detyrave që punojnë fëmijët e tyre është shumë i madh dhe ata nuk kanë kohë të mjaftueshme për të shfrytëzuar kohën e lirë.

Përveç kohës që kalojnë në detyra të shtëpisë, që prindërit e shohin si ngarkesë edhe disa nga llojet e detyrave të shtëpisë i shohin si të panevojshme dhe me ngarkesë për fëmijët.

Mësimi i vjershave me disa strofa përmendsh, vazhdimi i detyrave të klasës në shtëpi, përshkrimi i komplet faqes së librit në fletore sipas prindërve krijon monotoni dhe lodhje të fëmijët.

Prindërit e shohin si shumë të nevojshme bashkëpunimin mësues-prind dhe nxënës. Për çdo paqartësi dhe ngecje të fëmijëve në detyra të shtëpisë e shohin shumë të rëndësishëm komunikimin e vazhdueshëm me mësimmhënësin. Sipas Cooper (2001), kur prindërit përfshihen në detyra të shtëpisë, ata rrisin vlerësimin për shkollimin e fëmijëve të tyre dhe shprehin qëndrime pozitive për ata. Një sfidë tjetër që e paraqesin prindërit gjatë përfshirjes në detyra të shtëpisë janë udhëzimet në detyra. Ata deklarojnë se shpeshherë ndodh që të mos kuptojnë detyrat se çfarë është kërkuar nga mësimmhënësi të punojë fëmija i tyre, andaj edhe detyrohen që të kërkojnë ndihmën e mësimmhënësve për të qartësuar më mirë detyrën e shtëpisë.

Sipas Huisman (2016), mësimmhënësit duhet ta kenë parasysh se prindërit mund të mos kenë njohuri për të ndihmuar fëmijët e tyre në detyra.

Prindërit pohojnë se si pasojë e paqartësisë në detyra shpeshherë shkaktohet edhe një situatë e pakëndshme në familje. Edhe studiuesit (Kralovec & Buell, 2000, Voorhis, 2011), kishin vënë në pah se detyrat e shtëpisë shkatërrojnë familjen pasi prindërit ndihen të papërgatitur për ndihmë dhe nuk ofrojnë ndihmën e duhur. Sipas Stogner (2014), prindërit të cilët punojnë me orar të gjatë ose nuk kanë

mundësi të ndihmojnë fëmijët e tyre varen nga anëtarët e tjerë të familjes si vëllezërit apo motrat e fëmijëve që kanë detyra.

Në fund, prindërit deklarohen se kontrollimi apo vlerësimi i detyrave të shtëpisë nuk bëhet në mënyrë të duhur pasi mungon informata kthyesë me shkrim. Prindërit mendojnë se për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasë dhe orarit të shkurtër detyrat e shtëpisë nuk kontrollohen ashtu siç duhet, andaj edhe nxënësit nuk janë të inkurajuar të punojnë detyrat e shtëpisë.

Sipas një studimi tjetër lidhur me këtë çështje, prindërit e shohin si një “barrë të madhe” kontrollimin e detyrave të shtëpisë. Ata konsiderojnë se është një përgjegjësi e mësuesit për të kontrolluar detyrat e shtëpisë (Fitzmaurice et al., 2020). Pavarësisht sfidave që shohin prindërit gjatë zbatimit të detyrave të shtëpisë, ata janë mbështetës të detyrave dhe gjithmonë të gatshëm për të ndihmuar fëmijët e tyre në detyra të shtëpisë.

Është shumë më rëndësi të theksohet se studimet për përfshirjen e prindërve në detyra të shtëpisë, prindërit i shohin detyrat e shtëpisë si të domosdoshme dhe të rëndësishme për të mbështetur të mësuarit, përvetësimin e njohurive dhe është jetike në ndërtimin e besimit dhe përgjegjësisë (Cooper, 2001; Epstein & Voorhis, 2001; Iflazoğlu, 2014; Marzano, 2003; Schumm, 2005; Skaggs, 2007).

Megjithatë ka studime të cilat kanë praktikuar edhe trajnimin e prindërve për detyra të shtëpisë dhe rezultatet e tyre treguan se prindërit kanë përfituar nga trajnimi për detyra të shtëpisë (Voorhis, 2011, siç është në Hoeke, 2017).

Në studimin e tyre (Ozer & Keskin, 2015), paraqesin si problem kohën që prindërit nuk kanë mundësi ta kursejnë për të ndihmuar fëmijët e tyre në detyra të shtëpisë, andaj ata japin këshilla që mësuesit të japin detyra të shtëpisë në mënyrë që fëmijët t’i punojnë në mënyrë të pavarur dhe të mos kenë nevojë për mbështetjen e prindërve. Të njëjtën problematikë e paraqet në studimin e tij Dudley-Marling (2003), i cili pohon se detyrat e shtëpisë marrin kohën e lirë të familjes, me një fjalë prishin marrëdhëniet në familje duke privuar ata nga kënaqësitë e jetës familjare. Ndërsa, Costa et al., 2016, thekson se prindërit vazhdimisht duhet të inkurajojnë dhe të ndihmojnë fëmijët e tyre të punojnë detyrat e shtëpisë pasi ndikon në krijimin e shprehisë së tyre për punë dhe paraqesin performancë të mirë në shkollë.

Pavarësisht të gjitha sfidave që kanë prindërit për të mbështetur fëmijët e tyre, ata luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e nevojave individuale të fëmijëve të tyre për përfundimin e suksesshëm të detyrave të shtëpisë (McNulty, 2018).

Sa u përket rezultateve me nxënës, shohim se ata i shohin shumë të nevojshme detyrat e shtëpisë. Pjesa më e pëlqyer e detyrave sipas nxënësve është kur posedojnë detyra me karakter hulumtues dhe bashkëpunojnë edhe me shokët e shoqet e klasës. Ky bashkëpunim përmbush edhe një nga parimet e teorisë së konstruktivizmit “*të nxënësit në ndërveprim*”.

Ata tregojnë se për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasë dhe orarit të shkurtër jo gjithmonë mësuesit japin informatë kthyesë për detyra të shtëpisë, gjë e cila korrelohet edhe me përgjigjet e mësuesve. Megjithatë kur mësuesit kanë mundësi t'u japin informatë kthyesë në detyra të shtëpisë, nxënësit përfitojnë nga komentet e tyre për t'u përmirësuar aty ku kanë më shumë nevojë. Nxënësit theksojnë që edhe prindërit janë të ngarkuar me punë dhe shpesh nuk kanë mundësi të ndihmojnë në detyra të shtëpisë.

Përfundimisht mund të themi se rezultatet e fituara nga pyetësi dhe intervistat tregojnë se faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë janë të shumtë duke filluar nga qasja e mësuesit ndaj detyrave të shtëpisë, standardi i detyrave të shtëpisë, koha që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë, dhënia e udhëzimeve të qarta në detyra të shtëpisë, numri i nxënësve në klasë, orari ditor në shkollë, dhënia e informatës kthyesë e deri të bashkëpunimi i mirëfilltë me prindër. Të gjithë këta faktorë janë të ndërlidhur ngushtë me njëri-tjetrin, andaj mungesa e njërit faktor pamundëson menaxhimin efektiv të detyrave të shtëpisë, rrjedhimisht, kjo çështje nxjerrë në pah po ashtu nevojën për koordinim dhe bashkëpunim të të gjithë akterëve që janë pjesë integrale e këtij dimensionit kaq të rëndësishëm në sistemin e edukimit, siç janë detyrat e shtëpisë dhe përpjekjet për të nxitur efektivitetin e tyre. Në këtë drejtim, gjetjet e studimit në fjalë do konsideroheshin vlerë e shtuar jo vetëm për praktikën dhe strategjitë efektive të mësuesve brenda klasës, mirëpo edhe për tekstet shkollore dhe reflektimin e përmbajtjeve të këtyre teksteve dhe në kërkesat adekuate të kurrikulës që nxitë dhe përkrahë shkathtësitë për jetë.

5.1. Përfundime

Studimi për faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë në shkollën fillore, konsiderohet vlerë e shtuar dhe më një rëndësi të veçantë për kontekstin e studimit dhe më gjerë. Ky është hulumtimi i parë në Kosovë që trajtoi faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë në arsimin fillor dhe synoi të sigurojë njohuri se si mësuesit dhe prindërit duhet t'i qasen detyrave të shtëpisë së nxënësve. Praktikën aktuale të menaxhimit të detyrave të shtëpisë duhet të vlerësohen nga një këndvështrim më i gjerë i kontekstit të sistemit arsimor. Kjo është një çështje kritike dhe përfshin disa variabla thelbësore të cilat ky hulumtim i ka elaboruar sipas mënyrës se si janë paraqitur në kontekstin e Kosovës.

Mungesa e bashkëpunimit më prindër paraqet një sfidë të theksuar në raport me komunikimin prind – mësues, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në mbështetjen e nxënësve në detyra të shtëpisë. Orari i shkurtër i mësuesve në shkollë implikon edhe faktorë të tjerë që vështirësojnë punën e tyre në praktikimin e mirëfilltë të detyrave të shtëpisë. Pamundësia për të krijuar detyrat e shtëpisë në shkollë për shkak të orarit të shkurtër që mësuesi ka në shkollë, vështirëson që krijimi i detyrave të shtëpisë të jetë në nivelin e duhur e me theks të veçantë përshtatja e detyrave të shtëpisë sipas nivelit të njohurive të nxënësve dhe sipas interesave që kanë ata. Përveç orarit të shkurtër, numri i madh i nxënësve në klasë pamundëson dhënien e informatës kthyesë me kohë. Një çështje kritike që vërehet në studim është që dhënia e informatës kthyesë me shkrim në masë më të madhe fokusohet vetëm në korrigjimin e gabimeve të cilat mund të konsiderohen më shumë si çështje teknike, ndërsa në një masë më të vogël dhënia e informatës kthyesë fokusohet në pika e forta të nxënësve dhe fushat ku duhen zhvilluar ata që janë shumë të rëndësishme për të nxënësit e suksesshëm të nxënësve. Mungesa e informatës kthyesë me shkrim theksohet edhe nga prindërit e nxënësve që morën pjesë në studim.

Një faktor tjetër i rëndësishëm për studimin është qasja e mësuesve lidhur me praktikimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesit kanë shumë qëllime për dhënien e detyrave të shtëpisë. Me theks të veçantë fokusohen në zhvillimin personal ku rol të madh i kushtojnë krijimit të përgjegjësive dhe shprehive të punës.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që vërehet te qasja e mësuesve dhe që kërkon studim më të thellë në të ardhmen janë fushat ku fokusohen mësuesit të japin detyra të shtëpisë. Lëndët bazë si Gjuha shqipe dhe Matematika praktikohen më shumë gjatë angazhimit të nxënësve në shtëpi ndërsa fushat e shkathtësive janë më pak të prekura në këtë drejtim gjë e cila do të duhej të kishte të njëjtën rëndësi. Në anën tjetër, mësuesit më shumë angazhojnë nxënësit në lexim dhe detyra

problemore. Leximi dhe detyrat problemore dominojnë nga përgjigjet e mësimdhënësve gjë e cila bie në kundërshtim me pohimet e prindërve pasi përgjigjet e tyre dëshmojnë të kundërtën.

Sipas prindërve, llojet e detyrave të shtëpisë që nxënësit kanë më së shumti janë mësimi i vjershave përmendsh, përshkrimi i komplet faqeve të librit si dhe memorizimi i fakteve të panevojshme andaj kjo çështje kërkon studim më të detajuar në të ardhmen.

Ajo që vërehet në studim është se funksionet e detyrave të shtëpisë po përmbushen duke theksuar sasinë e tyre dhe jo cilësinë. Këtë e dëshmon koha që nxënësit kalojnë në detyra të shtëpisë. Nxënësit kanë nevojë edhe për kohë të lirë, prandaj angazhimi i nxënësve 4 deri në 5 herë në javë në detyra të shtëpisë si dhe koha që kalojnë në detyra gjatë një dite tejkalon kohën që është paraparë nga hulumtuesit që e kanë studiuar këtë problematikë. Për këtë problematikë, prindërit shprehen të shqetësuar pasi ngarkesa e tepërt është vështirë e përballueshme për moshën e fëmijëve të tyre. Sipas prindërve, fëmijët nuk kanë detyra të shtëpisë vetëm gjatë ditëve të punës por edhe vikendeve e në festa.

Dhënia e udhëzimeve në detyra të shtëpisë theksohet si sfidë nga prindërit dhe nxënësit ku si pasojë e kësaj shpesh herë në familje shkaktohen konflikte të padëshiruara, qoftë nga ngarkesa e madhe e punës së prindërve apo edhe niveli i shkollimit të tyre. Megjithatë prindërit i pranojnë detyrat e shtëpisë si praktikë shumë të nevojshme për të mësuar më mirë fëmijët e tyre por vazhdimisht kërkojnë që qasja e mësimdhënësit ndaj detyrave të shtëpisë të jetë më e lehtë dhe më e pranueshme duke marrë parasysh moshën e fëmijëve të tyre. Gjetjet nga ky studim tregojnë se mësimdhënësit nuk janë të përgatitur mjaftueshëm për praktikimin e detyrave të shtëpisë ose trajnimet që kanë kryer ata nuk kanë qenë të duhura pasi sfidat që përmendin ata janë mjaft komplekse dhe dallojnë nga mësimdhënësi në mësimdhënës. Në këtë studim, mësimdhënësit dhe prindërit inkurajohen që vazhdimisht të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin duke forcuar lidhjen shkollë – shtëpi pasi në këtë mënyrë arrihen edhe më shumë qëndrime pozitive ndaj shkollës, ku padyshim përfituesit më të mëdhenj janë nxënësit.

Bazuar në gjetjet e lartpërmendura, hulumtimi konkludon se qasja e mësimdhënësve për detyrat e shtëpisë duhet të përqendrohet më shumë në çështjen e konceptimit të detyrave të shtëpisë, të menduarit dhe të kuptuarit e detyrave që lidhen me realitetin, sesa në memorizimin e fakteve të panevojshme. Gjatë hartimit të detyrave të shtëpisë, rëndësi të madhe duhet t'i kushtohet dijeve paraprake dhe praktike të nxënësve dhe ndër lidhjes së këtyre dijeve mes fushave të tjera, pasi vetëm në këtë mënyrë përshtatja e detyrave të shtëpisë do të ketë parasysh nevojat, interesat dhe potencialet e nxënësve, gjë kjo që duhet të jetë pjesë e pandarë e praktikës së mësimdhënësve.

Po ashtu, mësimdhënësi, përmes detyrave të shtëpisë, duhet të promovojë ndërveprimin social mes fëmijës dhe prindërve apo dhe bashkëmoshatarëve, duke zgjeruar kështu konceptet e nxëna në klasë dhe duke i bërë të kuptueshme dhe të zbatueshme edhe për kontekstet e tjera më gjerë, në mënyrë që

diskutimi për detyra të vazhdojë edhe në klasë. Përveç kësaj, mësimdhënësi gjithmonë duhet të kontrollojë detyrat e shtëpisë, duke dhënë informatë kthyesë për angazhimin që nxënësit kanë realizuar në shtëpi, duke pas parasysh që kjo informatë kthyesë përkrahë shumë dimensione të tjera të zhvillimit të fëmijëve.

Në fund, hulumtimi konkludon dhe rekomandon se detyrat e shtëpisë duhet të udhëhiqen nga një politikë e qartë, e formuar nga politikbërësit, mësimdhënësit dhe prindërit.

Sistemi arsimor duhet t'i vendos detyrat e shtëpisë brenda kornizës së një politike për detyrat e shtëpisë, e cila artikulon qartë pritshmëritë, udhëzimet dhe këshillat e dobishme. Vendosja e një standardi të tillë duhet të përbëhet nga elemente mëposhtme: qëllimi i caktimit të detyrave të shtëpisë, hartimi i detyrave të shtëpisë, koha që nxënësi duhet të kalojë në detyra të shtëpisë, dhënia e informatës kthyesë në kohë të duhur, përgjegjësitë e mësuesve dhe nxënësve dhe roli i prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes që mbështesin fëmijët në detyrat e tyre të shtëpisë.

Megjithatë, ideja e vendosjes së një standardi dhe politike nuk duhet të përdoret gabimisht në drejtim të krijimit të realitetit në të cilin mësimdhënësve iu zvogëlohet autonomia por edhe sfida për të definuar qasjen e tyre për zhvillim të praktikave efektive të detyrave të shtëpisë të cilat bëhen pjesë integrale dhe domethënëse e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky standard dhe politika nuk duhet të shpiejnë pra në vendosjen e uniformitetit dhe veprimeve të përcaktuara që mësuesit duhet të ndjekin në menaxhimin e detyrave të shtëpisë së nxënësve në mënyrë shabllonike. Në vend të kësaj, ai është një udhëzues për zhvillimin e teorisë dhe të menduarit të praktikës profesionale të mësuesve në përputhje me nevojën për të kaluar nga realiteti aktual në situatën e dëshiruar. Integrimi i detyrave të shtëpisë si pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon një qasje gjithëpërfshirëse të përgatitjes së mësimdhënësve dhe praktikës së tyre profesionale duke përcaktuar politikat dhe dimensionet e zbatueshmërisë së një intervenimi të tillë. Për më shumë implementimi i ndryshimit nga gjendja e aktuale në gjendjen e dëshiruar nënkupton edhe nevojën që menaxhimi efektiv i detyrave të shtëpisë të trajtohet nga perspektiva e ndërveprimit me aspektet e të qenit mësimdhënës dhe aspekteve të funksionimit të shkollës dhe sistemit të arsimit. Procesimi dhe filtrimi i realitetit aktual të menaxhimit të detyrave të shtëpisë krahas realitetit të dimensioneve individuale, organizative dhe sistimore të punës së mësimdhënësit definojnë qartë se cila është rruga që duhet ndjekur zhvillimi i praktikave të dhënies dhe menaxhimit të detyrave të shtëpisë nga ana e mësimdhënësve. Në këto rrethana të menaxhimit të ndryshimit nga gjendja aktuale është ngritur nevoja e perceptimit të këtij ndryshimi si projekt në vete e që në fakt është aspak më shumë se menaxhimi i ndryshimit të praktikës së mësimdhënies në një nën-sektor e që në parim nuk dallon nga perceptimi i orientimit të mësimdhënësve në detyrë. Andaj, politika dhe standardi mbi detyrat e shtëpisë shihet vetëm si tranzicion drejt fuqizimit të qasjes së re të mësimdhënësve ndaj detyrave të shtëpisë dhe integritit të

praktikave efektive si pjesë e identitetit profesional të mësimit dhe realitetit rutinor. Vetëm atëherë mësuesit do të vazhdojnë të analizojnë praktikën e tyre në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm në fushën e detyrave të shtëpisë por një model i tillë do të mund të përdoret si model gjenerik për të kuptuar dhe menaxhuar transformimin e praktikës profesionale të mësimit.

KAPITULLI 6

KUFIZIMET E STUDIMIT DHE MUNDËSITË E SË ARDHMES

Kapitulli paraqet kufizimet e studimit të cilat janë identifikuar gjatë studimit dhe mundësitë për të hulumtuar në të ardhmen lidhur me çështjen e detyrave të shtëpisë.

6.1. Kufizimet e studimit

Ky studim përveç shumë përparësive që ka për kontekstin në vendin tonë, padyshim që ka edhe kufizimet e tij.

Një nga kufizimet e këtij studimi mund të jetë fakti se ndarja e mostrës në aspektin gjinor nuk ishte proporcionale pasi dominonte gjinia femërore duke ditur që në sistemin tonë të edukimit gjinia femërore dominon në raport me gjininë mashkullore.

Një tjetër kufizim mund të jetë edhe modifikimi i pyetësorëve, ngase instrumentet origjinale janë modifikuar për çështje të studimit.

Kufizimi i fundit për këtë studim është pjesëmarrja e nxënësve pasi mosha e tyre ishte 9 – 10 vjeç. Perceptimet e tyre mund të kenë kuptime të ndryshme me pyetjet e intervistës edhe pse studiuesi u mundua të japë udhëzime të qarta dhe shpjegime të thjeshta për të gjithë pjesëmarrësit pa dallim moshe apo gjinie.

6.2. Mundësitë e së ardhmes

Bazuar në gjetjet e studimit lidhur me faktorët që ndikojnë në efektivitetin e detyrave të shtëpisë, hulumtimi për efektivitetin e detyrave të shtëpisë, konsideroj se duhet të zgjerohet, andaj rekomandoj tri hulumtime specifike që studimi të zgjerohet në të ardhmen.

Së pari, do të ishte i dobishëm një studim rasti më i thellë ku fokus kryesor do të ishte mësimdhënësi për të shikuar më detajisht llojet e detyrave të shtëpisë që ata aplikojnë në ciklin fillor. Së dyti, një hulumtim cilësor me nxënësit për të analizuar përdorimin e informatës kthyesë në detyra të shtëpisë me theks të veçantë se sa janë të fokusuara informatat kthyesë për secilin nxënësit në mënyrë individuale. Në fund, një hulumtim me prindërit për të hulumtuar mënyrën se si i ndihmojnë prindërit fëmijët e tyre për të punuar detyrat e shtëpisë.

REFERENCAT

- Almalki, S. (2016). Integrating quantitative and qualitative data in mixed methods research--challenges and benefits. *Journal of education and learning*, 5(3), 288-296. <https://doi.org/10.5539/jel.v5n3p288>
- Alsharif, K. (2014). How do teachers interpret the term 'constructivism' as a teaching approach in the riyadh primary schools context? *Procedia-Social and Behavioral Sciences*, 141, 1009-1018. <https://doi.org/10.1016/j.sbspro.2014.05.170>
- Asghar, M. (2013). Exploring formative assessment using cultural historical activity theory. *Online Submission*, 4(2), 18-32. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED541932.pdf>
- Bada, S. O., & Olusegun, S. (2015). Constructivism learning theory: A paradigm for teaching and learning. *Journal of Research & Method in Education*, 5(6), 66-70. . . . <https://doi.org/10.9790/7388-05616670>
- Baher, H. (2017). *The homework problem and what teachers can do about it*. MA TESOL Collection.
- Baş, G., Senturk, C., & Ciğerci, F. M. (2017). Homework and academic achievement: A meta-analytic review of research. *Issues in Educational Research*, 27(1), 31–50. <https://iier.org.au/iier27/bas.pdf>
- Basic Education Program. (2013). *Vlerësimi formativ*. USAID
- Bembenutty, H. (2009). The last word: An interview with Lyn Corno - The ingredients for making a self-regulated scholar. *Journal of Advanced Academics*, 21(1), 142-156. <https://doi.org/10.1177/1932202X0902100107>
- Bembenutty, H. (2011). The last word: An interview with Harris Cooper-Research, policies, tips, and current perspectives on homework. *Journal of Advanced Academics*, 22(2), 340-350.
- Beutlich, J. T. (2008). Enhancing homework's effectiveness through student motivation and parental involvement. *Digital Collections @ Dordt*, 10 - 35. https://digitalcollections.dordt.edu/med_theses/31/
- Bonett, D. G., & Wright, T. A. (2015). Cronbach's alpha reliability: Interval estimation, hypothesis testing, and sample size planning. *Journal of organizational behavior*, 36(1), 3-15. <https://doi.org/10.1002/job.1960>
- Brewster, C., & Fager, J. (2000). *Increasing student engagement and motivation: From time-on-task to homework*. Portland, OR: Northwest Regional Educational Laboratory.
- Carr, N. S. (2013). Increasing the effectiveness of homework for all learners in the inclusive classroom. *School Community Journal*, 23(1), 169-182. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1004337.pdf>

- Chraif, M., & Anitei, M. (2012). Overload learning, attachment and coping styles predictors of mental and physical health of teenage high school students in Romania. *Procedia-Social and Behavioral Sciences*, 69, 1842-1846. <https://doi.org/10.1016/j.sbspro.2012.12.135>
- Clarke, V., & Braun, V. (2017). Thematic analysis. *The Journal of Positive Psychology*, 12(3), 297-298. <https://doi.org/10.1080/17439760.2016.1262613>
- Cohen, L., Manion, L., & Morrison, K. (2007). *Research methods in education* (6th ed.). Routledge.
- Cooper, H. (1989). *Homework*. Longman. <https://doi.org/10.1037/11578-000>
- Cooper, H. (1994). Homework research and policy: A review of the literature. *Research/Practice*, 2(2), 1-10.
- Cooper, H. (2001). Homework for all - in moderation. *Educational Leadership*, 58(7), 34-38. <https://www.ascd.org/el/articles/homework-for-all-in-moderation>
- Cooper, H., Robinson, J. C., & Patall, E. A. (2006). Does homework improve academic achievement? A synthesis of research, 1987-2003. *Review of educational research*, 76(1), 1-62. <https://doi.org/10.3102/00346543076001001>
- Costa, M., Cardoso, A. P., Lacerda, C., Lopes, A., & Gomes, C. (2016). Homework in primary education from the perspective of teachers and pupils. *Procedia-Social and Behavioral Sciences*, 217, 139-148. <https://doi.org/10.1016/j.sbspro.2016.02.047>
- Creswell, J. W. (2007). *An introduction to mixed methods research*. University of Nebraska.
- Creswell, J. W., Plano Clark, V. L., Gutmann, M. L., & Hanson, W. E. (2003). Advanced mixed methods research designs. *Handbook of mixed methods in social and behavioral research*. Sage Publication.
- Cunha, J., Rosário, P., Núñez, J. C., Nunes, A. R., Moreira, T., & Nunes, T. (2018). "Homework feedback is...": Elementary and middle school teachers' conceptions of homework feedback. *Frontiers in Psychology*, 9, 32. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2018.00032>
- Dale, S. H. (2012). *Learning theories an educational perspective sixth edition*. Pearson.
- D'antoni, L., Kini, D., Alur, R., Gulëani, S., Viswanathan, M., & Hartmann, B. (2015). How can automatic feedback help students construct automata?. *ACM Transactions on Computer-Human Interaction (TOCHI)*, 22(2), 1-24. <https://doi.org/10.1145/2723163>
- Dudley-Marling, C. (2003). How school troubles come home: The impact of homework on families of struggling learners. *Current issues in Education*, 6.
- Epstein, J. L., & Dauber, S. L. (1991). School programs and teacher practices of parent involvement in inner-city elementary and middle schools. *The elementary school journal*, 91(3), 289-305. <https://doi.org/10.1086/461656>

- Epstein, J. L., & Van Voorhis, F. L. (2001). More than minutes: Teachers' roles in designing homework. *Educational psychologist*, 36(3), 181-193. https://doi.org/10.1207/S15326985EP3603_4
- European Commission (2013). Supporting teacher competence development for better learning Outcomes. http://ec.europa.eu/education/policy/school/doc/teachercomp_en.pdf
- Fawzy, N. (2012). *School teachers' perspectives on homework: A comparative study* [Unpublished Med thesis]. The American University in Cairo.
- Fitzmaurice, H., Flynn, M., & Hanafin, J. (2020). Primary teachers' homework practices: Identity, expectations, policies and cultural values. *Issues in Educational Research*, 30(3), 897-919. <https://doi.org/10.1080/03004279.2019.1674897>
- Foot, K. A. (2014). Cultural-historical activity theory: Exploring a theory to inform practice and research. *Journal of Human Behavior in the Social Environment*, 24(3), 329-347. <http://dx.doi.org/10.1080/10911359.2013.831011>
